



ZVICRA, REFERENDUM KUNDËR SHQIPTARËVE?!

Në Zvicër Islami është feja e dytë më e përhapur pas krishterimit, por ai nuk është edhe aq i dukshëm. Atje ka gjithsej katër minare, një nga ato është e improvizuar nga një oxhak fabrike ndërsa tani shërben si minare. Në Zvicër jetojnë afër gjysmë milioni muslimanë, prej të cilëve mbi 50% janë shqiptarë nga vendet ballkanike. Me këtë lirisht mund të themi se shqiptarët janë bartës të Islamit në Zvicër, ata bëjnë organizimin e jetës fetare dhe ata mundohen të sigurojnë kushte modeste për besimtarët për të ushtruar adhurimet ditore, javore apo më të rralla. Në Zvicër, shqiptarët janë ata që më së shumti parashtrojnë kërkesat për të ndërtuar xhami, normalisht me minare.

Mirëpo, minaret si duket i pengojnë dikujt, prandaj Partia Popullore Zvicerane (SVP), forca e djathtë që e paraqiti propozimin për ndalimin e ndërtimit të minareve, thotë se ato janë simbole të forcimit të islamit militant. Ky propozim u përkrah nga votuesit me 57.5 %, numër ky i cili na bën të dyshojmë në drejtësinë e supozuar zvicerane për të cilën na rrëfenin bashkëkombësit tanë që jetojnë atje. A thua çfarë fshihet pas këtij referendumi? A duhet të supozojmë se mirëseardhja zvicerane vlen vetëm atëherë kur je punëtor i palodhur, pastrues apo shofer autobusi? Subhanalla, ashtu ishim të mirë edhe për sllavët në përgjithësi, a thua s'ka dallim mes tyre?

Ambasadori zviceran në Egjipt mundohet të arsyetojë këtë referendum duke thënë se “Qeveria e vendit të tij respekton demokracinë, ndaj edhe votimi i referendumit për ndalesën e ndërtimit të minareve është në sajë të demokracisë së vendit, pra, rezulton nga vetë populli, sepse fjala e fundit është e tij”. Por të gjithë e dimë se populli shpeshherë bëhet viktimë e medias, që në këtë rast u manifestua – ndër të tjerash – me pllakatet trishtuese që ftonin zviceranët në referendum, ndërsa aty dukeshin ca minare të zeza dhe një grua me mbulesë që ishte edhe më e madhe sesa minaret, dhe ashtu bënë të ndihesh sikurse dikush do ta pushtojë, ndërsa vota jote do ta shpëtojë Zvicrën.

Shkelja e të drejtave elementare nuk duket ndryshe përveçse kështu, por padituria bën që njeriu të armiqësojë gjithçka që nuk njeh. Padyshim, minaret luajnë një rol shembullor pasi janë një simbol i dukshëm për xhamitë dhe këndimi i ezanit përhapet më lehtë, më gjerë dhe më shumë. Minaret pra, kanë një qëllim të lëvdur dhe të mirë. Minaret do t'i mundësonin zviceranëve shumë shpejt të kuptojnë mirësitë e kësaj Feje dhe do të mbushnin shpirtrat e tyre me lumturinë, kënaqësinë dhe rehatinë që ndjejnë shpirtrat e atyre që e falin namazin me përlësi.

Ai është qëllimi i minareve, ndërsa namazi i besimtarit mbetet fuqiplotë dhe i saktë pavarësisht falet në xhami ku ka apo s'ka minare. Mungesa e minareve do t'i dëmtojë vetëm zviceranët dhe askënd tjetër.

Në emër të redaksisë: Omer BERISHA

AKTUALE

Muri i Berlinit ra por ka mbetur muri i mosrespektimit **3-6**

KËNDI IM

Nuk jemi kundër islamit, por... **7-9**

Modernizmi dhe prejardhja e kësaj rryme **10-14**

Natën kur hëna mungoi **15-18**

Udhëzime për shfrytëzuesit e internetit **18-19**

Lumturia shpirtërore **20-23**

AKIDE

Mbështetja tek Allahu sa nevojë kemi për të? **24-27**

FIKH

Pastërtia, gjysma e besimit **28-31**

AVANCIMI PERSONAL

Fuqia e vullnetit **32-33**

PREZANTIM I LIBRIT

“Forma e namazit e të dërguarit **34-37**

FAMILJA

“Çështja e gruas” problem që nuk ekziston **38-43**

Përse e zgjodha mbulesën?!... **44-45**

TEFSIR

Me të vërtetë, pas vështirësisë – vjen lehtësimi! **46-47**

HADITH

Kur të flasin mendjelehtët për çështje madhore prite kiametin **48-52**

FETVA DHE KONSULTIME

Kremtet e fundvitit **53-56**

HISTORI

Rebi Ibën Huthejmi – një burrë që peshon sa malet (I) **57-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,

Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhirologjaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com



MURI I BERLINIT RA POR KA MBETUR MURI I MOSRESPEKTIMIT

Me rastin e përkujtimit të rënies së murit të Berlinit po ndërtohen mure kundër muslimanëve evropianë në Shqipëri, Bosnjë dhe Kosovë, sepse serbëve, malazezëve dhe maqedonasve do t'u lejohet hyrja në Evropë pa viza, kurse përballë muslimanëve do të ketë vetëm mure.

ABDULBAKI HALIFE

Më 9 Nëntor 1989 pas plot 28 viteve të ndarjes midis Berlinit lindor dhe perëndimor u hapën kufijtë midis dy Gjermanive atëbotë, duke lajmëruar kështu një periudhë të re për Gjermaninë në veçanti dhe për Evropën në përgjithësi. Ajo periudhë u shënua me veprime të përbashkëta pavarësisht se disa shtete kundërshtonin, në krye të të cilëve ishte Franca. Rënia e murit

personifikonte shkëlqimin e agimit të një periudhe të re, mirëpo efektet e saj pozitive nuk e kapërcyen Perëndimin për të përfshirë kështu edhe shtetet tjera të botës, sidomos në Afrikë dhe Azi. Madje, as muslimanët e Gjermanisë nuk arritën t'i prekin ato efekte ashtu si i prekën qytetarët e Gjermanisë lindore. Ndërkohë kur qytetarët e Gjermanisë lindore po merrnin në dorë dosjet sekrete të tyre të përgatitura nga ish-shërbimet inteligjente, filluan të përgatiten dosje të tjera për muslimanët në Gjermani

dhe përndim në përgjithësi. Ajo që dihet, nuk është vetëm periudha fatkeqe e komunizmit, por edhe inkuizicioni, të cilin shtiren sikur e harrojnë ndërsa në anën tjetër nxorën në pah viktimat çifute në nazizmit, sikur ata të ishin viktimat e vetme të Luftës së Dytë Botërore, ku gjetën vdekjen 60 milionë njerëz dhe vajtojnë vetëm për 6 milionë çifutë?! Plus kësaj, çifutët nuk ishin viktimat e vetme të Hitlerit, sepse me të gjitha përmasat ata ishin më pak se viktimat e Stalinit për shembull, që arrijnë numrin 20 milionë. Me plot bindje, ata ishin më pak se viktimat e kryqëzatave në Andaluzi, numrin e të cilëve nuk e di askush përveç Allahut. Madje ka një tendencë serioze që masakra e supozuar naziste kundër çifutëve të paraqitet si masakra e parë¹, që u ka ndodhur jokrishterëve në kontinentin plak. Nuk dihet saktësisht sa do të presin muslimanët në Gjermani, Britani, Francë, Itali, Spanjë, Belgjikë dhe Ballkan për t'i hapur dosjet e tyre të sigurisë, të cilat u përgatitën në periudhën e demokracisë.

Siç duket, racistët e përndimit nuk e panë Islamin vetëm si një armik alternativ, por gjetën muslimanët si viktimat të reja për ta, sepse si duket nuk mund të jetojnë pa viktimat. Prandaj, sakrifikojnë njerëzimin me qëllim që të shpëtojnë, meqë besimi i hyjnizimit të njeriut tashmë ka përparuar dhe kështu secili i krishterë të bëhet zot në vete – i Lartësuar është Allahu nga ajo që të tjerët bëjnë – . Mirëpo, sakrifikimi i vetë “zotit” me qëllim që të shpëtojnë të tjerët (sipas besimit të tyre) tashti është shndërruar në sakrifikimin e të tjerëve me qëllim që ata vetë të shpëtojnë me pasuritë e të tjerëve. Luftërat që u bënë mes tyre dhe pastaj kthimi drejt okupimit të tjetrit, marrjes së pasurisë dhe në fund sakrifikimi i tyre sikur këta të mos ishin njerëz e dëshmon

“...Ai ka botuar një libër me titull “Islamizimi i Evropës inshalla”, ku Islamin e përshkruan si të dhunshëm dhe agresiv, kurse islamistët po nxituakan ta islamizojnë Evropën dhe t’i japin emrin “Urabija”...”

këtë realitet.

Këtë e ka shprehur ndoshta më me qartësi shkrimtari britanik **Robert Fisk** me fjalët: “Muslimanët që para qindra vitesh janë në gjendje mbrojtje të vazhdueshme... Përndimi duke përfutur nga forca e tij ushtarake ka qenë shkak i eksplodimit të situatës në botën islame dhe nuk i ka lënë asnjë shans që ta rishikojë veten”, si dhe “numri i trupave amerikanë në Lindjen e Mesme është 22 herë më i madh se numri i ushtarëve të kryqëzatave”.

Pyetja që parashtrihet është: Prishja e murit të Berlinit mori 28 vjet kohë, por kur do të prishen muret që përndimi po vendos brenda tij, mure politike, ekonomike, kulturore dhe mediatike që nga projekti i njohur **Sykes-Picot**. Mure të shumtë dhe të shpeshtë, aq shumë, sa kufijtë që na ndajnë neve në botën arabe dhe islame. Kufijtë e evropianëve po hapen për njëri-tjetrin, por për neve po mbyllen. Ato janë mure të atilla si iu intereson të dhathtëve ekstremistë në Përndim, siç ishte thirrja e politikanit belg, kryetari i partisë “Interesat flamande” **Filip De Vinter**, i cili kërkoi që Evropa t’i mbyllë dyert e saja për emigrantët muslimanë. Ai ka

¹ Pogromet cariste ndaj hebrenjve rusë janë arkivuar dhe nuk përmenden pothuajse fare (shën. R.H.).

botuar një libër me titull “Islamizimi i Evropës inshalla”, ku Islamin e përshkruan si të dhunshëm dhe agresiv, kurse islamistët po nxituakan ta islamizojnë Evropën dhe t’i japin emrin “Urabiya”. Nejse, të dobëtin çdoherë e fajësojnë, por në realitet duhet të shohim kush-kë po sulmon, kush-kë po pushton, kush-kujt po i imponon ideologji të caktuara dhe kush-kë po përçan?

Përderisa ekstremistët e djathtë akuzojnë Islamin dhe muslimanët me ekstremizëm nga ana tjetër mbyllin sytë, madje nxisin veprime ekstremiste dhe terroriste kundër Islamit dhe muslimanëve, sikurse djegia e xhamisë në Athinë, pasi u përdhos Kurani nga ana e policisë, kur një numër njerëzish me maska më 22 Maj të këtij viti hodhën në xhami koktej molotov dhe ndezën zjarrin që shkaktoi shpërthimin dhe prishjen e një pjese të xhamisë dhe plagosjen e pesë besimtarëve.

Në Danimarkë, partia popullore djathtiste hapi fushatë kundër ndërtimit të xhamive duke thirrur kandidatët që të shprehen kundër ndërtimit të tyre. Në Spanjë dhe në vende të tjera po burgosen të pafajshëm me akuzën, se janë anëtarë të **Al Kaedës**, pastaj lirohen me një kaucion prej 6,000 eurosh. Me të vërtetë ky është një operacion i ndyrë, që kur të akuzuarit për terrorizëm paskan filluar të lirohen me kaucion?!

Ndërkaq vazhdon ndërhyrja perëndimore në çështjet e shteteve muslimane dhe ndërtimi i mureve midis muslimanëve dhe besimit të tyre, midis muslimanëve dhe sheriatit, midis muslimanëve si shtete dhe rajone... këtë gjë na e përcjell gazeta “**Times**” në numrin e botuar më 23 Prill të këtij viti, nga ish-kryeministri britanik **Toni Bler**: “Qeverisja e sheriatit në botën arabe, ngritja e një kalifati për të gjithë muslimanët dhe largimi i prezencës perëndimore atje janë të patolerueshme dhe nuk mund të lejohen asnjëherë”. Madje një film dokumentar

amerikan ia tërhoqi vërejtjen shteteve evropiane nga ngritja e një shteti musliman në Evropë në vitin 2016. Ky film nxit urrejtjen evropiane kundër Islamit dhe muslimanëve me fjalët: “Islami po shtrihet me shpejtësi nëpërmjet emigrimit, ndërkohë që përqindja e natalitetit në Evropë vazhdimisht po bie, çështje kjo, e cila e bën triumfues Islamin në botë brenda pesë viteve”. Një gazetë tjetër shkon edhe më larg: “Dominimi Islam më pas do të luftojë Shtetet e Bashkuara pas Evropës, sepse ata janë synimi kryesor i muslimanëve”. Duart e çifutëve duken qartë brenda këtyre fushatave. Muri i ndarjes raciste po vazhdon të qëndrojë si një thikë në Palestinën e pushtuar. Shkrimtari amerikano-izraelit **Herb Deninberg** bën një ndërlidhje të ndyrë mes entitetit izraelit dhe Perëndimit: “Synimi i muslimanëve momentalisht ndoshta përkufizohet me Izraelin, mirëpo synimi kryesor i tyre është dominimi mbi Evropën”.

Jo vetëm arabët dhe muslimanët janë ata për të cilët përgatiten dosje nëpër ministritë e brendshme dhe shërbimet inteligjente në Perëndim, por kjo po përfshin edhe perëndimorët që mendojnë në mënyrë të pavarur. Gazeta franceze “**Le Monde**” pak më herët zbuloi se studiuesi **Fansua Gejsar** akuzohet se admiron Islamin, prandaj “do të mbikëqyret nga ana e aparatit policor, nën vellon e luftimit të terrorizmit”. Kjo e përforcon realitetin, që disa në Perëndim e mohojnë. Lufta kundër asaj që quhet terrorizëm në realitet, jo me metaforë është luftë kundër Islamit si fe dhe kundër muslimanëve si bashkësi, pavarësisht sa janë praktikantë të Islamit. Gejsari, më herët ka botuar librin “Islamofobia e re” dhe ai është një studiues që refuzon idetë dhe paragjykimet mbi Islamin. Kur muslimanët po përgatiteshin të prisnin muajin e bekuar të Ramazanit, disa ekstremistë kishin venduar një kokë thiu në një xhami të qyteti

francez Tuluz dhe aty pranë kishin shkruar “mos e prek thiun tim”.

Franca zyrtare, e cila po ndërton muret kundër Islamit nëpërmjet ndalimit të shamisë dhe nikabit, i dha çmimin **Simon De Bovuar** shkrimtares që lufton Islamit **Tesnime Nesrin**. Ky është një mur tjetër që po ndërton Franca midis saj dhe muslimanëve. Çështja nuk mbaron këtu, sepse edhe kisha është thelluar shumë në këtë luftë kundër Islamit dhe muslimanëve. Kardinali italian **Anxhelo Baniasko** kundërshtoi mësim-besimin islam nëpër shkolla duke thënë: “nuk është pjesë e kulturës tonë”, që nënkupton mohimin e tjetrit dhe ndërtimin e murit përballë tij. Kjo shpreh mungesën e vetëbesimit dhe frikën nga përhapja e të vërtetave islame në Itali. Kështu synohet të parandalojnë Islamit te njerëzit duke ndërtuar mure psikike, mediatike etj. Në Itali gjithashtu po bëhen përgatitjet për të hartuar një ligj që do të kushtëzojë organizimin e referendumeve popullore përpara se të ndërtohet një xhami.

Çështja ka arritur deri aty që të ndërtohen mure midis zemrave, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të peshkopëve italiane, **Monsenior Mariano Kruçata** kërkon të ndalojë martesën e muslimanëve me gra italiane: “martesa mes muslimanëve dhe femrave të krishtera nuk duhet të inkurajohet”. Nuk më lejon vendi të flas për muret e ndërtuara nga karikaturat lënduese të Danimarkës, të cilat e shpërblyen kryeministrin e Danimarkës, duke e bërë Sekretar të Përgjithshëm të NATO-s. Asnjë nga vendet anëtare nuk e kundërshtoi këtë përveç Turqisë.

Me rastin e përkujtimit të rënies së murit të Berlinit po ndërtohen mure kundër muslimanëve evropianë në Shqipëri, Bosnjë dhe Kosovë, sepse serbëve, malazezëve dhe maqedonasve do t'u lejohet hyrja në Evropë pa viza, kurse përballë muslimanëve do të

“...Kur muslimanët po përgatiteshin të prisnin muajin e bekuar të Ramazanit, disa ekstremistë kishin venduar një kokë thiun në një xhami të qyteti francez Tuluz dhe aty pranë kishin shkruar “mos e prek thiun tim”...”


ketë vetëm mure.

Në Amerikë muslimanët dëbohen nga puna, kur punëdhënësi apo drejtori kupton se punëtori i tij është musliman. Gazeta **“America in arabic”** publikoi një ngjarje të tillë të ndodhur më 26 Shtator të këtij viti në korporatën **Sprint**. Në Amerikë veprimet raciste kundër muslimanëve vazhdojnë edhe kundër xhamive. Një gjë të tillë ka përmendur burimi i sipërshtënuar, sesi disa njerëz kishin shkruar “vdekje për muslimanët” brenda një qendre dhe xhamie amerikane në bulevardin Meridian në Karolinën Veriore. Një prift amerikan i njohur si **Terri Xhons** kishte shkruar me germa të mëdha fjalinë “Islami është i djallit”. Të njëjtën gjë kanë shkruar edhe disa qarqe mbi bluzat dhe veshjet e tyre për të dy gjinitë dhe për moshat e ndryshme. Kush është pra, ai që po përhap mosrespektim dhe po ndërton mure?!

Shumica e gjermanëve nëpër sondazhet e ndryshme ndajnë mendimin, se shkaqet që i shtojnë në armiqësimin me muslimanët dhe ndërtimin e mureve ndarës midis tyre dhe muslimanëve, pas vrasjes së “martires së mbulesës” **Merva Sherbini** qëndrojnë paragjykimet. ■

nga arabishtja: Omer BERISHA

DIALOG ME NJË PERËNDIMOR



NUK JEMI KUNDËR ISLAMIT, POR...

Kështu ne nuk ia lejojmë muslimanit për shembull, që të martohet me më shumë se një grua, edhe pse ia lejojmë —sipas ligjeve dhe traditave tona— që të bashkëjetojë me cilëndo grua apo burrë që dëshiron dhe të bëjë me to atë që ju e quani “paturpësi”

PROF. DR. XHAHER SHEJH IDRIZ

Politikani perëndimor i drejtohet thirrësit musliman me fjalët: Ne kemi rezervat tona karshi jush, për faktin se ju nuk jeni besnikë në përcjelljen e imazhit tonë para publikut tuaj, duke na përshkruar si njerëz që jemi kundër Islamit, ndërkohë që e vërteta është se nuk jemi kundër tij.

Thirrësi: Kundrejt cilit Islam nuk jeni kundër? Thelbi i Islamit është dëshmia: La ilahe il-lallah, Muhamedun resulullah (Nuk ka Zot të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Tij) dhe se Kurani është fjala e Allahut. A jeni kundër diçkaje prej këtyre parimeve?

Perëndimori: Sikur t'i besonim të gjitha këto do të ishim muslimanë. Unë nuk thashë: “Ne nuk jemi muslimanë”, por thashë: “Ne nuk jemi kundër Islamit”, që

do të thotë se ne nuk jemi kundër atij që i beson ato që përmende, sepse ne si liberalë besojmë se është e drejta e çdo njeriu, që të besojë në atë fe që ai dëshiron, që ta propagandojë atë dhe ta zbatojë atë.

Thirrësi musliman: A mund të kuptoj prej kësaj fjale, se ju ia lejoni të gjitha këto muslimanëve që jetojnë në mesin tuaj?

Perëndimori: Po, për aq kohë sa ajo nuk bie në kundërshtim me ligjet dhe vlerat tona. Kështu ne nuk ia lejojmë muslimanit për shembull, që të martohet me më shumë se një grua, edhe pse ia lejojmë –sipas ligjeve dhe traditave tona– që të bashkëjetojë me cilëndo grua apo burrë që dëshiron dhe të bëjë me to atë që ju e quani “paturpësi”, përderisa kjo realizohet me pajtimin e tyre. Ndoshta tani kemi shkuar edhe më larg duke i konsideruar disa gjëra, si shembulli i shamisë, si gjëra që bien ndesh me vlerat tona.

Thirrësi: Pra, Islami ndaj të cilit ju nuk jeni kundër është ai Islam, që sillet brenda kufijve tuaj shekullarë dhe nëse ai i tejkalon ato ju e harroni liberalizmin tuaj. Cili është qëndrimi juaj karshi muslimanëve që nuk janë qytetarë të vendit tuaj, të cilët dëshirojnë ta organizojnë jetën e tyre sipas parimeve të fesë së tyre?

Perëndimori: Duke marrë në konsideratë faktin që ne jemi liberalë, besojmë se çdo popull gëzon të drejtën që ta organizojë jetën e tij sipas parimeve të veta, por ne besojmë se parimet tona liberale dhe vlerat tona, siç është demokracia dhe të drejtat e njeriut, nuk janë vetëm vlera perëndimore, por janë edhe vlera njerëzore. Për këtë arsye ne përpiqemi me të gjitha rrugët paqësore, që vlerat tona të jenë ato mbizotëruese në botë, duke përfshirë këtu edhe botën islame.

Thirrësi musliman: Pra, në botën islame

“...Ai përdor fjalë të ëmbla, por ne nuk mashtrohem vetëm me fjalë të ëmbla...”

ju jeni kundër gjithçkaje, që bie ndesh me atë që e quani “vlerat tuaja liberale”, edhe nëse janë çështje, të cilat i urdhëron Islami dhe përpiqeni që t’i ndryshoni.

Perëndimori: Po, por ne këtë e realizojmë me rrugë paqësore, ku bëjnë pjesë presionet politike, ekonomike dhe mediatike, sepse mendojmë që është në interes të popujve muslimanë, që të përqafojnë parimet liberale, të cilat janë kthyer –siç ju thashë– në parime njerëzore, jo perëndimore.

Thirrësi musliman: Por realiteti tregon që ju nuk i përmbaheni këtyre kufijve –pavarësisht dhunës që demonstrohet në to– por i tejkaloni ato deri në përdorimin e armëve.

Perëndimori: Po. Ne e bëjmë këtë për të ndihmuar popullin në një shtet të dobët, që nuk i ka mundësitë për të mbrojtur vetveten kundër agresorëve pushtetarë, ashtu siç vepruam në Irak.

Thirrësi musliman: Ke si qëllim të thuash, se të gjitha vendet perëndimore si: Kanadaja, Evropa, Australia, Zelanda e Re etj., u bashkuan për të luftuar Irakun, për të vlarë me mijëra banorë të tij, për ta prishur dhe për ta rrënuar, me qëllimin e vetëm për ta shpëtuar atë nga pushteti i një njeriu të vetëm?!...

Perëndimori: Ju po e teproni në këtë pikë. Tani Iraku është një vend demokratik, që drejtohet nga një president i zgjedhur dhe gëzon shumë liri, të cilat nuk mund t’i gëzonte në periudhën e pushtetit diktatorial.

Thirrësi musliman: Atëherë le të lejmë mënjane pretendimet tona dhe le të

dëgjojmë dëshmitë e institucioneve perëndimore.

Perëndimori: Cilat janë ato dhe çfarë thonë?

Thirrësi musliman: Kjo është revista e politikave të jashtme **Foreign Policy**, e cila në numrin e saj elektronik, që është botuar në muajin Qershor të këtij viti thotë:

“Iraku ishte një vend me popullsi të përbërë nga shtresa e mesme, të cilat zotëronin shtëpi, makina dhe shkolla private, por ai u shkatërrua. Në këtë luftë kanë vdekur 4300 forca aleate, 20,000 ushtarë dhe forca të sigurisë irakiane, 90,000 qytetarë kanë vdekur nga luftimet, 50,000 vetë nga shkaqe indirekte, janë vrarë 163 gazetarë dhe kanë humbur rreth 1500 sende me vlerë nga muzetë e grabitur.”

Këto fakte i ka përmendur kjo gazetë në numrin e saj më datë 22 Qershor të vitit 2009, por shkatërrimi dhe vdekjet vazhdojnë ende. A do të më thuash, se e gjithë kjo vdekje dhe shkatërrim u bë për të shpëtuar një vend musliman nga një diktator që mbiu nga i njëjti popull? A mund ta pranojë këtë fjalë dikush, që ka qoftë edhe një grimcë mendje?

Perëndimori: Mos harro! Edhe pse hedhja e një diktatori ishte një nga elementët që na nxiti për të hyrë në luftë, përsëri ekzistonin shtysa të tjera edhe më të fuqishme për ta bërë diçka të tillë, siç ishte mbrojtja e interesave tona nga kërcënimi i armëve të shkatërrimit në masë, që kishte në dispozicion Sadami.

Thirrësi musliman: Më lejo të them, se kjo nuk ishte një shtysë, edhe pse mund të jetë një alibi për të justifikuar agresionin. Argument për këtë është fakti se lufta vazhdoi, edhe pse një pjesë e madhe e shkatërrimit dhe vrasjeve ndodhi pasi e gjitha bota mësoi dhe pasi qeveria amerikane e pranoi, se Sadami nuk

zotëronte armë të shkatërrimit në masë.

Perëndimori: Përse të mos e pranojmë se presidenti i ri i SHBA-së fitoi nga slogani i ri për ndryshim dhe se premtoi hapjen e një faqeje të re me botën islame?


Thirrësi musliman: Po! Presidenti i ri e premtoi këtë, por u vërtetua se ndryshimi i tij ishte vetëm me ligjërimin me të cilin i drejtohej muslimanëve dhe të tjerëve. Ai përdor fjalë të ëmbla, por ne nuk mashtrohemi vetëm me fjalë të ëmbla.

Po! Ai premtoi tërheqjen nga Iraku, por këtë e premtoi edhe presidenti i mëparshëm, sepse mendonte që misioni i tyre atje mbaroi, por presidenti i ri doli nga Iraku për t’u përqendruar në një vend tjetër musliman, që ishte Afganistani, madje edhe Pakistani. Në të njëjtin numër, gazeta që sapo të përmenda përmend se **Karzai**, presidenti i vendosur nga amerikanët, si i pari i vendit ka thënë: “Nëse jam kukull për faktin se i njoh meritat e Amerikës, atëherë le të jetë ky emri im.” Gazeta gjithashtu përmend se në luftë kanë vdekur 1,160 forca të aleancës, të paktën 10,000 forca të sigurisë afgane, 11,000 qytetarë për shkak të luftës, 20,000 vetë nga shkaqe indirekte, 6 gazetarë dhe janë grabitur aq shumë sende të trashëgimisë kulturore, sa ministri i kulturës është shprehur: “Afganistani është një muze i madh, që po grabitet pak e nga pak.”

Them se kjo ka ndodhur që kur është publikuar ai numër, por lufta vazhdon dhe vetëm Zoti e di sesa do të jenë humbjet e saja përfundimtare. ■

MODERNIZMI DHE PREJARDHJA E KËSAJ RRYME

Për të shmangur zbatimin se çfarë thotë Kurani dhe Suneti, modernistët thonë se ne duhet të ndjekim “shpirtin” e Islamit. Por është shumë e qartë nga Kurani dhe Suneti, se ne duhet t’i marrim të dyja



XHEMALUDIN ZARABOZO

Idelogjikisht lëvizja moderniste e përhapur në ditët e sotme rrjedh nga një sekt që i përket të kaluarës. Ky sekt i quajtur Mutezile u shfaq në shekullin e tretë hixhri. Edhe pse këta njerëz pranuan Kuranin dhe Sunetin, ata kanë bërë **tevil** (interpretimin e tyre të Kuranit) dhe thanë: **akli (logjika) ka përparësi mbi naklin (tekstet fetare)**. Megjithatë kjo shkollë u shua. Lëvizja moderniste nuk u zhvillua prej tyre, por ata janë shumë të ngjashëm me ta.

Lëvizja moderniste në të vërtetë origjinën e saj e ka në Evropë (në kohën e Mesjetës). Në

kohën kur *metoda shkencore* u zbulua në Spanjë, prej aty është parë se atë që kishte predikuar kisha nuk ishte e vërtetë. Kjo çoi në një revoltë të ngadaltë. Pikëpamja themelore e modernizmit është se: feja duhet të ndryshojë, sipas rrethanave dhe se ajo nuk është statike.

Një gjë e tillë nuk mund të merret si e vërtetë absolute. Modernistët hebrenj dhe të krishterë i përgjigjeshin kohës në Evropë duke u përpjekur që t’i shpjegojnë njerëzve, se si feja është ende e rëndësishme për popullin. Ata sajuan risi të ndryshme vetëm e vetëm për t’i mbajtur njerëzit të interesuar për fenë (të tilla si të kënduarit në kishë, vetëm në vitet 1900).

Ata u përpoqën t'i thonë njerëzve, se hyjnorja dhe njerëzorja janë përzier në Bibël dhe që disa pjesë të cilat janë të vërteta, duhet të jenë ato që kanë dalë jashtë mode. Gjithashtu, feja është duke u përmirësuar me kalimin e kohës dhe nuk ka të vërtetë absolute në Bibël.

Kjo ishte koha, kur shumë muslimanë kërkonin Evropën. Kjo çoi në tre zgjedhje për ata muslimanë: të pranojnë Perëndimin, të refuzojnë Perëndimin, ose të përzihen me Perëndimin. Ata që pasuan këtë të tretën (modernistët) u edukuan, dhe u fokusuan në: Turqi - sepse ishte nën ndikimin britanik dhe në Egjipt - Al Az'har, sepse ishte vend i dijes islame.

Njerëzit nga kjo lëvizje moderniste e gjykonin Islamin sipas logjikës të tyre.

Disa nga gabimet e tyre në lidhje me të janë:

e përdorin atë për gjëra të cilat nuk mund t'i përfshijnë (kuptojnë);

i referohen çdo gjëje me të: e pranojnë atë që pajtohet me të, e refuzojnë atë që nuk pajtohet me të;

e gjykojnë shpalljen hyjnore nga ajo pikënisje (logjika). Megjithatë Ehli Suneti beson se shfrytëzimi i shëndoshë i aklit (logjikës) duhet të çojë në konkluzionin, se Kurani dhe Profeti janë të vërtetë dhe se mësimet e tyre duhet të kenë përparësi mbi aklin.

Ndikimi i modernizmit në Amerikë

Modernistët thonë se Perëndimi dhe bota ka ndryshuar dhe se Islami duhet të bëhet më "i civilizuar". Modernizmi është përhapur më shumë në SHBA, sepse:

nuk ka studiues në dispozicion për t'i hedhur poshtë pretendimet e tyre, sepse njerëzit nuk duan t'i kritikojnë ata;

i lejon muslimanët nga jashtë për t'u bërë pjesë e shoqërisë amerikane dhe ata mund të mos njihen se janë muslimanë. Gjithashtu

“...Pikëpamja themelore e modernizmit është se: feja duhet të ndryshojë, sipas rrethanave dhe se ajo nuk është statike...”

muslimani i ri amerikan nuk është i detyruar të ndryshojë stilin e jetesës së tyre të vjetër;

shumë letrarë, studiues dhe institucione në SHBA reflektojnë të menduarit modernist.

Për shembull, në një libër që flet për jetëshkrimin e Pejgamberit është thënë se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* është si çdo njeri tjetër. Një tjetër përpiket të thotë se Suneti nuk është në favor të Sheriatit dhe se ndonjëherë duhet ta hedhim larg hadithin, ngase Allahu nuk i ka korrigjuar gabimet e Profetit kur ai ka dhënë mendimin e tij. Nga lëmi i fikhut, modernistët thonë se interesi (kamata) është i lejuar, gratë gjatë menstruacioneve mund të falen dhe gratë muslimane mund të martohen me burra jobesimtarë. Ata thonë se fytyra e grave nuk ka qenë e mbuluar deri 150 vjet pas kohës së Profetit, edhe pse ajo ka ekzistuar në kohën e tij, dhe se gratë duhet të falen gjithmonë në xhami, edhe pse hadithi tregon që gratë në xhami duhet të paraqiten në jaci dhe në kohën e sabahut, ngaqë ashtu nuk mund të njihen në errësirë. Ata gjithashtu për hadithin “*një popull me një sundimtar grua nuk do të ketë sukses*”, thonë se nuk është i vërtetë sot dhe se poligamia është e ndaluar me përjashtim kur ka kushte të caktuara.

Duhet theksuar se kjo lëvizje është e organizuar dhe ka burime të saja, si revista, televizione, konventa dhe literaturë.

Disa nga pikëpamjet e tyre

Modernistët ndikojnë në të menduarit e njerëzve dhe njerëzit i përhapin pikëpamjet

e tyre pa e kuptuar. Mënyra e tyre e të menduarit është gjëja më e rrezikshme për ta. Ata përpiqen gjithashtu për të hequr Sunetin dhe thonë se sistemi i shkencëtarëve të hadithit është i pamjaftueshëm. Shumica e tyre thonë se ne kemi nevojë për një kritikë “të lartë” të hadithit dhe se konkluzionet (ixhma) e para të dijetarëve nuk janë të mjaftueshme. Megjithatë ne si muslimanë kuptojmë se Profeti ishte i udhëzuar nga Allahu dhe se neve nuk na lejohet të kundërshtojmë diçka në hadithet e tij nëse ato nuk i kupton logjika e ndonjërit prej nesh.

Është diçka e zakonshme që modernistët të vënë në pikëpyetje rolin e Sunetit në Sheriat. Njëri prej tyre tha se i gjithë Suneti është i kësaj bote dhe jo nga feja. Një tjetër thotë se ndryshimet e kohës dhe të vendit tek Suneti krijojnë vështirësi për t’u përdorur. E gjithë kjo që thuhet bëhet vetëm për të dobësuar Sunetin. Modernistët përpiqen të nxjerrin në pah dallimet në mes të Dërguarit tonë, si njeri dhe si peygamber. Ata gjithashtu iu shmangen pasimit të Sunetit, duke e ndarë jetën e Profetit, paqja qoftë për të, në disa pjesë (imam, gjykatës, udhëheqës ushtarak, profet etj), duke thënë se disa nuk janë mësim hyjnore e as ligj që duhet ndjekur. Disa thonë se gjithkush është i lirë të bëjë ixhtihad. Një tjetër tha se një vendim i sheriatit mund të ndryshojë, edhe në qoftë se është nga Kurani dhe Suneti.

Si devijojnë modernistët

Vëzhguesit mund të nxjerrin shumë lehtë në pah pikat e mëposhtme si forcë lëvizëse për këtë prirje:

premisat dhe supozimet e tyre janë të padrejta. Modernistët përpiqen që të riinterpretojnë fenë “e vjetër” me shkencën moderne dhe kohët moderne. Ata supozojnë se:

gjendja e tanishme është më e përparuar

“...Ata mendojnë se Perëndimi është i bazuar në shkencë, por ata dështojnë të vërejnë se jo e gjithë shkenca është e bazuar në fakte dhe jo çdo gjë zbulohet me shkencë...”

apo e ndryshme. Megjithatë ideja e progresit dhe se gjërat janë më të mira tani është ide marksiste dhe hegeliane. Kjo është kundër hadithit, që Profeti tha se *çdo brez vjen duke u përkeqësuar*. Shoqëri e përparuar sipas Islamit është ajo që shkon më afër Allahut; e kupton dhe e zbaton Islamin më mirë. Në fakt, shoqëritë e sotme kanë probleme nga ato të shoqërive të vjetra (të tilla si homoseksualizmi, alkooli etj) dhe që përmenden në Kuran;

feja është në lidhje me kohën dhe vendin. Modernistët janë “njerëz të shkencës” dhe e gjykojnë Islamin sipas shkencës moderne. Ata mendojnë se Perëndimi është i bazuar në shkencë, por ata dështojnë të vërejnë se jo e gjithë shkenca është e bazuar në fakte dhe jo çdo gjë zbulohet me shkencë. Në realitet, shumë nga shkencat janë vetëm hipotezë (jo fakte).

mënyra e të menduarit të një shoqërie është një produkt i mjedisit të saj. Modernistët thonë se pjesa më e madhe e fesë është nga njerëzit, dhe nga mjedisi i tyre, dhe kjo mund të rigjykohej nga kohët e mëvonshme, ndërsa hadithi është i lidhur vetëm për atë kohë. Megjithatë, nuk ka ndonjë dëshmi për hipotezat e modernistëve, se e vërteta fetare është relative.

Metodologjia që përdorin është e gabuar. Metodologjia e modernistëve është rrugë që po i çon njerëzit drejt konkluzioneve të

gabuar. Ata pretendojnë se janë shkencorë, por zakonisht ata janë në kundërshtim, ose nuk kanë asnjë provë për besimet e tyre. Disa nga mjetet dhe parimet që ata përdorin përfshijnë:

Suneti dhe Hadithi. Ata pretendojnë se Kurani është autentik dhe se ata ndjekin vetëm hadithet “autentike”. Kjo nënkupton se ata kanë një mënyrë për të gjykuar hadithin (e ndryshme nga ajo e dijetarëve tradicionalë), por akoma nuk japin asnjë mënyrë të re për të gjykuar hadithin, dhe përdorin logjikën e tyre për ta përcaktuar atë.

Modernistëve veçanërisht nuk iu pëlqejnë hadithet që kanë kuptime të veçanta dhe preferojnë vetëm ato që kanë parime të përgjithshme.

Përdorimi i hadithit të dobët për të ndihmuar pikat e tyre dhe argumentet. Për shembull, në çështjet e gruas në Islam, ata pëlqejnë t'i citojnë dy tregimet nga koha e Omerit: 1) kur Omeri ishte duke mbajtur një hutbe ai u përpoq të kufizojë sasinë e dhuntisë (pajës për bashkëshorten), një grua e kundërshtoi, dhe Omeri e korrigjoi veten dhe e falënderoi gruan; 2) Omeri emëroi nënën Shifa si një rregulluese të tregut (kjo e përdorur nga modernistët të thonë se gratë mund të punojnë në qeveri). Megjithatë të dyja këto histori nuk janë autentike.

c) Përdorin terma të paqarta, pa përkufizimin e tyre. Modernistët i përdorin termet si demokraci, liri dhe barazi, por ata nuk e kanë të përcaktuar, se çfarë nënkuptojnë ato sipas tyre. Rreziku në përdorimin e termave të paqarta është që një person i ditur do të kalojë mbi ndonjë fjalë ose koncept, duke menduar se ata e kuptojnë përkufizimin islam apo të pranueshëm, kurse në fakt ata nuk e kuptojnë, ndërsa të tjerët mund të besojnë se çfarë ata thonë është e vërtetë.

Nuk e paraqesin të gjithë informacionin

përkatës, që është në dispozicion për ndonjë temë. Kjo është nga Kurani, Suneti etj. Ata paraqesin vetëm atë që do të mbështesë pikëpamjet e tyre.

Forca e tyre mbi interpretimin e tekstit. Kjo është ajo që i bëri Mutezilet, kur ata thanë: mendja merr përparësi mbi atë që është nga Profeti. Ata theksojnë se Islami është një fe “racionale”, por ne u themi: kjo është e vërtetë përderisa thoni se çdo gjë që është prej Allahut nuk ka asnjë kundërshtim, por të thoni se ne duhet të studiojmë çdo gjë në Islam, për ta gjykuar vetëm me logjikën tonë është krejtësisht e papranueshme.

Për të shmangur zbatimin se çfarë thotë Kurani dhe Suneti, modernistët thonë se ne duhet të ndjekim “shpirtin” e Islamit. Por është shumë e qartë nga Kurani dhe Suneti, se ne duhet t'i marrim të dyja. Ata argumentojnë se teksti i Kuranit thotë për gratë vetëm se duhet të vishen në mënyrë modeste, ndaj nuk preferojnë të flasin për detajet e veçanta për hixhabin, dhe thonë se ne vetëm duhet të ndjekim “shpirtin” e ligjit.

Ata e kanë si tendencë për të kundërshtuar dijetarët, duke thënë se ata nënkuptojnë diçka tjetër. Ata thonë se dera është e hapur për ixhtihad, që është diçka e pranuar nga Ehli Suneti. Megjithatë kjo derë nuk është e hapur për të gjithë. Modernistët pretendojnë se çdokush mund të bëjë ixhtihad derisa ka bërë Imam Shafiu me kualifikime të vogla (jo e vërtetë), dhe kushdo sot mund ta bëjë këtë. Në një revistë, në pyetjen e poligamisë dhe divorcin, disa thanë se këto dy gjëra mund të kufizohen me ixhtihad. Ata shpesh i citojnë gabim dijetarët dhe japin kuptimet e tyre për atë që thonë ata.

Shpesh pasojnë mendime të çuditshme dhe të refuzuara.

Ata përpiqen të ringjallin disa nga mendimet e vjetra, sepse ata i pëlqejnë ato. Modernistët përpiqen për të hapur derën për

këto mendime dhe të zgjedhin atë që është më e përshtatshme dhe më e lehtë për t'u ndjekur. Ata zakonisht sjellin hadithe të dobëta të tilla si *"dallimet në Umetin tim janë një mëshirë"*, ose refuzojnë hadithin autentik si ai rreth shpërbërjes së Umetit në 73 grupe.

pasojnë dëshirat e tyre. Ata shpesh marrin vendime dhe fetva pa argument. Njëri tha se muzika është e lejuar, sepse ai nuk kishte parë diçka të keqe në të, kështu që tha se është hallall. Por ai nuk e shikoi se çfarë thonë Kurani dhe Suneti në lidhje me këtë temë.

Islami dhe modernizmi

Ehli Suneti dhe Xhemati besojnë se ka vetëm një Islam të vërtetë. Kjo është e vërtetuar në Kuran dhe Hadith. Në një hadith që përcjell Ibën Mesudi, radijallahu anhu, thotë: *"Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem bëri një vijë e pastaj tha: "Kjo është rruga e drejtë e Allahut";- pastaj bëri disa të tjera në të djathtë dhe në të majtë e pastaj tha: "Nuk ka asnjë prej këtyre rrugëve përveç se në të është nga një shejtan, i cili thërret në te."*, pastaj lexoi fjalën e Allahut: ***"Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë pra, përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni."*** (Enam, 153) .

Modernistët ndryshojnë nga Ehli Suneti në këto pika:

çdo gjë që është në përputhje me Kuranin dhe Sunetin është Hak (e vërtetë) dhe ajo me të cilën ata nuk pajtohen është e gabuar (disa modernistë nuk pajtohen me këtë);

ixhmaja (konsensusi) i sahabëve (dhe i gjeneratave të hershme) është një dëshmi për të gjithë muslimanët. Modernistët thonë se sahabët janë njerëz, edhe ne jemi njerëz, madje edhe për çështjet që kanë qenë unanimë thonë se mbesin të hapura për debat;

Çdo gjë në Kuran dhe Sunet nuk mund të

“Ehli Suneti dhe Xhemati besojnë se ka vetëm një Islam të vërtetë. Kjo është e vërtetuar në Kuran dhe Hadith...”

kundërshtohet nga logjika, arsyeja, mendimi, apo analogjia. Kjo është e mbështetur në Kuran dhe nuk është e hapur për diskutim dhe votim. Një modernist tha se prerja e dorës së hajdutit është një “Islam i prapambetur” dhe nuk është etike;

Në Islam ka pandryshueshmëri në lidhje me adhurimin, besimin etj., dhe këto janë të mira, të shëndosha, të sigurt dhe të sakta për të gjitha vendet dhe kohët.

Ky mendim është i pranuar nga Ehli Suneti, por jo edhe nga shumë modernistë, që thonë se e gjithë e vërteta është relative dhe nuk ka pandryshueshmëri. Megjithatë këto parime themelore konstante janë pikëpamje të Ehli Sunetit dhe janë në Kuran, Sunet dhe te sahabët. Ato nuk janë çështje të diskutueshme ose të ndryshueshme. Në shumë nga këto gjëra modernistët thonë se ne kemi nevojë për ixhtihad dhe ripërtëritje (reforma).

Përfundime

1) Lëvizja moderniste në tërësi është nga Bidati (shpikja në fe). Ata kanë parimet dhe mënyrat e tyre, të cilat janë në kundërshtim me ato të Ehli Sunetit.

2) Ata janë shumë të gatshëm për të refuzuar dhe për të kundërshtuar ixhmain (konsensusin) e sahabëve në çështje të qarta.

3) Një nga pikat kryesore të modernizimit është që të ndryshojë rolin e grave. Ata thonë, se është e lejueshme që të përzihen burra e gra dhe të mos veshin hixhabin. ■

Përshtati nga anglishtja: Fitim NUHIU

NATËN KUR HËNA MUNGOI

XHEMILE MUHAMED XHUFAN

Shtëpia u trazua nga lëvizje të shqetësuar, telefoni nuk ndalej së cingëruari, ndërsa zëra të përzier ngriheshin në heshtje. Të gjithë po rrinim të trishtuar, të frikësuar dhe të dëshpëruar. Si të mos ishte ashtu, kur çështja kishte të bënte me atë njeri? Të gjithë ishim të trishtuar dhe të frikësuar përveç tij, ai qëndronte ashtu si çdoherë që ishim mësuar ta shohim, i buzëqeshur, i ngrohtë dhe durimtar.

Tek ulësja e tij e zakonitë afër ngrohjes pinte në heshtje çajin në gota xhami. U ulëm përreth tij dhe nëna ime e filloi bisedën duke u munduar të thyente këtë atmosferë të rëndë. Bëhej një bisedë me ndërprerje, e vijonte me pauza, ndërsa ai rrinte në heshtje. Motra ime e vogël po mendohej të nxirrte një hurmë nga kutia... ishin hurma të njoma, të ngjitura dhe me ngjyrë mjalti, tamam nga ai lloji që ai i pëlqente... ajo më thirri mua që t'i nxirrja hurmat... ndërsa unë me humor i thashë: Ti e fillove këtë, ti mbaroje.- Atëherë

ajo me zemërim më tha: -Jo, ti do ta bësh!- Jo, ti - ia ktheva unë.

Ai buzëqeshi dhe tha: -Ju jeni si Fatmiri dhe Fatmira!- Thashë më vete: oh, çfarë fatmirësie, ai sërish po flet, sërish iu kthye tregimeve të lezetshme, ai qenka mirë pra! Buzëqesha dhe thashë: -Çfarë thotë tregimi i Fatmirit dhe Fatmirës?

Të gjithë ngritën kokën me ngazëllim të madh, ai na u kthye prapë! Rrufiti edhe një herë çajin dhe ma dha gotën që t'ia mbush përsëri. Pastaj nisi:

- Fatmiri dhe Fatmira ishin burrë e grua dhe jetonin në varfëri të skajshme. Ata nuk kishin më shumë se një raft me hurma, mirëpo ato ishin të thata dhe të vjetra, ndaj ishte e vështirë nxjerrja e tyre. Ata u grindën duke i kërkuar njëri-tjetrit nxjerrjen e hurmave derisa u pajtuan që të mos flasë njeri: kush flet i pari ai detyrohet të marrë përsipër nxjerrjen e hurmave.

Filloi loja e heshtjes... vazhdimisht e shikonin njëri-tjetrin me shikim gllabërues... kaloi një udhëtar pranë tyre dhe i përshëndeti, por asnjëri nuk ia ktheu

përsëritet! O njerëz, jam një udhëtar që po vdes nga uria, çfarë keni për të më dhënë?

Prapë, nuk mori asnjë përgjigje për kërkesën e tij përveç disa shikimeve të heshtura. Fatmiri zgurdullonte sytë e tij drejt Fatmirës dhe Fatmira gjithashtu i zgurdullonte drejt Fatmiri. - Rrufiti prapë çajin dhe vazhdoi tregimin: - Kur njeriu pa hallin, zbrazti raftin me hurma dhe iku me shpejtësi. Atëherë Fatmira shikoi Fatmirin duke dashur t'i thotë t'i shpëtojë hurmat... ashtu që bërtiti: Fatmir... hurmat... kape njeriun! Fatmiri buzëqeshi dhe tha: Humbel! Tani t'i detyrohesh t'i nxjerrësh hurmat nga rafti!

Na bëri të qeshim mendjelehtësia e këtyre dy bashkëshortëve, buzëqeshëm sepse ai buzëqeshi... dhe kështu biseda ecte si një ujë i pastër dhe i kulluar. Krejt papritur ai sërish heshti dhe kapi kokën me duar. E kuptuam se ishte një tjetër dhimbje koke... dëshpërimi u kthye përsëri, por ai nuk ankohej, nuk ofshante, as nuk e shprehte dhimbjen. Gjatë gjithë kohës ai përsëriste **“Subhanallah – Vetëm Allahu është pa të meta”** dhe **“La haule ue la kuvete ila bilah – Nuk ka lëvizje dhe as forcë pa ndihmën e Allahut”** dhe i thoshte ato me zë. Atëherë e kuptonim se dhimbjet ishin rritur dhe mundimi i ishte shtuar. Në këtë hall me një dhembshuri dashamiri e pyesnim: -A je mirë? Mirë jam, mirë! – na thoshte ai me vendosmëri. -Mirë jam me lejen dhe ndihmën e Allahut, falënderimi i takon Allahut në çdo gjendje.

Në errësirën e natës, rrotullohesha në shtrat, mundohesha më kot të fle, por pa rezultat. Pastaj u ula dhe e ndeza dritën, mora një libër dhe e hapa të lexoj, por shumë shpejt m'u mërzit dhe e mbylla. U shtriva dhe shikojta tavanin e dhomës kot e kot. Pasiguria kaploi zemrën time, ndërsa dhimbja po më shtrydhte shpirtin. O Zoti im! Çfarë të bëj?!...

Ashtu në qetësi, në veshët e mi u përvodh një zë tingëllues, i ëmbël që lexonte ajete nga

Shpallja e të Urtit. Po, ai është...

E njoh këtë zë shumë mirë, që kur isha vashë e vogël e dëgjoja këtë zë çdo natë. E shikojta si qëndronte në këmbë me përlulësi duke u falur, duke u lutur dhe duke qarë, por nuk mund të paramendoja se po e dëgjoj edhe sonte! Si ka mundësi në këtë gjendje? Kur po e përcillja më kaploi një rehati e lezetshme, qetësi e çuditshme dhe shkova në gjumë të thellë.

Të nesërmen filloi udhëtimi drejt ilaçit, nga një mjek te tjetri, nga një spital në spitalin tjetër dhe filluam të dëgjojmë zëra të pasigurt që thoshin: “mjeku nuk e di sëmundjen e tij”, “i dha vetëm një bar qetësues”, “mjeku tjetër është më i mirë, pse nuk e dërgojmë tek ai”, “duhet ta dërgojmë te spitalet e kryeqytetit, janë më të mira”...

Debat që na ngulfate vazhdimisht, mendime kundërthënëse, dyshim dhe pasiguri... u ktheva nga ai dhe e pashë të qetë, symbyllur duke bërë tesbih me gishtat e tij. Nuk e di si mund ta durojë këtë? Ku e gjen ai këtë sabër?

Midis mbrëmjes dhe mëngjesit të shndërrohesh nga njeri i aftë e i mbështetur në vetvete, njeri i lirë që lëviz si të duash dhe kur të duash, njeri i shëndoshë dhe aktiv në një trup krejt dhimbje që ecën pa kontroll nëpër një botë krejt zhurmë dhe potere, duke u mbështetur në krahë të tjetrit... është një ngarkesë shumë e rëndë që nuk e bartin as malet.

Sot pasdite u vendos ta dërgojmë për mjekim në kryeqytet. Nëna filloi të përgatisë sendet e duhura me gjithçka që i nevojitej, si dhe nuk reshte duke e urdhëruar që të hante disa kafshata para udhëtimit. Ha, që dje nuk ke shtyrë asgjë në gojë përveç pak... pije këtë qumësht të përzier me mjaltë, është i lehtë për lukthin... ja një gjevrek të lezetshëm... apo dëshiron të përgatis një përsesh të lehtë me kos...?

Pas gjithë kësaj këmbëngulje, ai mori

gotën, rrufiti njëherë dhe me kaq u mjaftua. Ne vërtiteshim dhe ecnim përreth tij kot e kot, pa asnjë qëllim. Merrnim ndonjë teshë... e palosnim... pastaj e shpalosnim... futnim një këmishë në çantën e tij, pastaj e nxirrnim dhe fusnim një këmishë tjetër. E mbushnim çantën pastaj e zbraznim sërish, për të kuptuar nëse kemi harruar diçka dhe e mbushnim prapë, por pas pak çasteve e zbraznim edhe një herë...

Erdhi momenti për të ikur... u ndalëm te dera në rresht... e puthëm në ballë disa herë dhe mezi i shprehnim lutjet, që nuk i thoshim të plota dot... rrahjet në gjoks i duronim me vështirësi dhe u ndalëm të këqyrim si po hipën në veturë. Ngriti dorën dhe me një buzëqeshje të ngrohtë na përshëndeti, hipi në veturë, e mbylli derën dhe nuk shikoi mbrapa fare. Vetura humbi në horizont, ndërsa ne mbetëm koçanë te dera duke ndenjur të zbrazët.

Në mbrëmje, secili nga ne shkoi te shtrati i vet me qetësi dhe u mbështoll me plafin e vet duke u shtirë se është në gjumë të thellë, por në realitet më i lumturi do të ishte ai që do të bënte vetëm një gjumë të lehtë, por si do të ndodhte e gjitha kjo kur lumturinë e përcollëm nga shtëpia në atë çast që e përcollëm atë. Tashmë vendi i tij ishte i zbrazur dhe shtrati i tij i braktisur. Nuk e kuptuam madhështinë e pranisë së tij në jetën tonë, përveçse kur e humbëm atë. Ai ishte i pranishëm çdoherë për shkakun tonë saqë prania e tij ishte gjë e ditur, e kryer dhe realitet i domosdoshëm i jetës tonë.

Më kujtohet kur vëllai i vogël qante natën nga dhimbja e këmbës. Ai zgjohej dhe i frynte duke i lexuar suren Fatiha derisa qetësohej dhe flinte. Nëse jo, e merrte me veturë që ta qetësonte derisa të rehatohej. Vëllai im qante çdo natë dhe ai vepronte kështu çdo natë. Të gjithë e dinim, pavarësisht a ishte i lumtur, i mërzhitur, i ngushtuar, i sëmurë, i gëzuar, me nevojë apo çfarëdo gjendje... e dinim se ai

ishte pranë. Për ne çdoherë ai ishte gjoks i mbushur plot me dhembshuri, mendje me peshë, zemër e mirë, mendim i qëlluar dhe i përgatitur kurdoherë për ndihmë dhe pjesëmarrje.

Nata m'u duk e gjatë dhe pambarim, shtyllat e shtëpisë më dukeshin të dëshpëruara dhe sikur po qanin, u ngrita, ecja dhe po kërkoja por nuk e dija çfarë...

Kalova pranë dhomës së motrës, e cila ishte mbështjellë brenda plafit të saj, ndërsa një zë i dhimbshëm dilte me zor nga brenda. Si t'i jap gajret asaj, ndërsa edhe unë kam të njëjtin hall? Dhoma e vëllait kishte dritë dhe pasi trokita hyra brenda. Ai po luante me celularin, kurse unë e pyeta: Pse nuk fle? Është bërë vonë... Ai ma ktheu me një zë duke u munduar ta bëjë të fortë dhe burrëror: Nuk më flihet. Pastaj shtoi: Po ti, pse nuk ke fjetur akoma, a nuk është vonë?

Më befasoi më këtë pyetje, u ndala pak dhe i thashë: Unë... unë do të fle tani. Por desha t'ju shoh a jeni mirë të gjithë para se të fle.

Ne jemi mirë, të lutem na lër të qetë nga kontrolli policor i natës, - ma ktheu ai me një vendosmëri serioze dhe aspak i prekur nga situata. O sa zemër të fortë, sa shpirt të ngurtë! A nuk humbi edhe ai atë që ne humbëm? Kapa dorezën e derës për ta mbyllur dhe papritur dëgjova: -Mos ki frikë, do të shërohet!

E shikova vëllanë... i pashë sytë e tij të mbushur me lot, që do të rridhnin nëse ai nuk do t'i mbante me forcë. E mbylla derën me shpejtësi dhe ika drejt sallorit të madh. Aty vërejta derën e mbyllur te dhoma e nënës time, një gjë e pazakontë. U afrova dhe ja po dëgjoj një zë më të lartë... ajo ishte duke dëgjuar valët e radio Kuranit Fisnik. Domethënë edhe ajo nuk paska fjetur, desha të trokas, por preferova të tërhiqem. U ktheva te dhoma ime, u hodha në shtrat... por ndjeja zbrazëti dhe rrënim... djegie të ashpër në brendi dhe zjarr që merrte flakë, dhimbje

lodhëse, shpirt të dëshpëruar, heshtje vrasëse... dhe qetësi të gërditshme.

Menjëherë m'u duk sikur po e dëgjoja. Zë tingëllues dhe i ëmbël që lexonte ajetet e Kuranit me përlulësi. Shikova orën e varur në mur... po, ai është ai... tamam kjo orë... i njëjti zë.

Kërceva me lehtësi dhe u nisa drejt vendfaljes së tij, aty te salloni i madh pranë drurit të madh që e kishim blerë për zbukurim, aty ku falej gjithmonë... gjeta sexhaden e tij të vjetërsuar, të cilën nuk dëshironte ta ndërronte assesi. Sexhadja ende ishte e shtruar drejt kibles dhe anash kishte Kuranin Famëlartë në format të madh.

Për herë të parë, që kur kam njohur kuptimin e jetës i gjej këto dyja të vetme, pa praninë e tij. Kështu që me një përlulësi që e mësova nga ai, qëndrova mbi sexhaden e tij, ktheva fytyrën drejt Shtëpisë së Lashtë, ndërsa lotët lagnin fytyrën time dhe pikonin mbi sexhaden e tij. U luta me gjithë shpirt: O Zoti im! Ruaje babanë tim dhe bëje të na kthehet me shëndet! ■

**Përshtati nga
arabishtja: Omer Berisha**

UDHËZIME PËR SHFRYTËZUESIT E INTERNETIT

www.islamway.com

E para: Kur një musliman dëgjon thirrjen për namaz, ai duhet të ngrihet të përkujtojë Allahun dhe asgjë tjetër të mos e pengojë atë për t'iu përgjigjur kësaj ftese.

Allahu thotë në Kuranin e tij Fisnik: *“(ajo dritë) **Është në shtëpitë** (xhamitë) **që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij, t'i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje. Ata janë njerëz që nuk i pengon, as tregtia e largët, as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet”**. (24: 36-37)*

E dyta: Interneti është një mënyrë komunikimi, që konsiderohet si një thikë me dy tehe. Kur ai jep përfitime, ai bëhet një dhuratë. Dhe kur ai jep të keqen, ai bëhet një fatkeqësi. Muslimanët duhet ta përdorin anën e mirë të

kësaj vegle për t'i shërbyer fesë dhe jetës së tyre, por jo anën e keqe të saj që prish jetën dhe fenë e tyre.

E treta: Është shumë e rëndësishme për përdoruesit e internetit, që të mbrojnë sytë e tyre nga skenat e ndaluara. Skenat e ndaluara konsiderohen shigjeta të shejtanit, arma e tij që ai përdor për të prishur zemrën e muslimanëve, duke i ofruar kënaqësi të menjëhershme, të ndjekur nga ndjenja të gjata që vonojnë pendesën dhe keqardhjen. Duke shikuar skenat që Allahu i ka ndaluar shkakton errësirë në zemër, mërzi në gjoks dhe rëndesë dhe hezitim për të kryer adhurimet ndaj Allahut. I privon shpirtit të gëzuar ëmbëlsinë e thellë të besimit. Padyshim se është një mjet që djalli i mbulon me një shtresë me sheqer mëkatet dhe robi bie në këtë kurth menjëherë. Shejtani merr kontrollin e plotë të

Duke shikuar skenat që Allahu i ka ndaluar shkakton errësirë në zemër, mërzi në gjoks dhe rëndesë dhe hezitim për të kryer adhurimet ndaj Allahut. I privon shpirtit të gëzuar ëmbëlsinë e thellë të besimit



zembrës së tij dhe luan me atë, si një vogëlush, i cili luan me top. Fundi është gjithmonë një humbje fatale.

E katërta: Mos lejoni që interneti t'iu marrë kohën dhe përpjekjet e juaja për asnjë vlerë. Kjo ndodh kur ju lundroni nëpër faqe të ndryshme dhe kontaktoni grupe të ndryshme me orë të tëra. Ju shpenzoni orët e çmuara të jetës suaj, këtë kohë që duhet t'ia kushtoni njerëzve që doni, si familjes, prindërve, fëmijëve dhe të afërmve, ose profesionit tënd, me të cilin ju fitoni nga ai, duke i siguruar vetes dhe familjes suaj një jetë më të mirë.

E pesta: Vizitoni faqe islame shpesh. Vizitoni faqe të dobishme, që të shtoni informacionet e dobishme, në mënyrë që të zgjeroni fushën e njohjes tuaj. Qëndro larg nga faqet që nxisin prishjen e besimit dhe të moralit, ato grupe që të kërkojnë përhapjen e fitneve ose polemikave, edhe nëse kjo është e lidhur me çështjet fetare. Polemika është e keqe dhe pa dobi. Mos ndërhyri në biseda me kundërshtuesit e Islamit, nëse nuk keni njohuri të nevojshme dhe aftësinë që të merreni me këtë detyrë. Dhe nëse e bëni këtë, atëherë më mirë kërkonit një studiues (dijetar) që të merret me të, ose edhe t'ju ndihmojë.

E gjashta: Bëni kujdes kundër faqeve me biseda të kota. Ato janë kurthe për meshkujt dhe femrat, që i tërheqin drejt një

“...Qëndro larg nga faqet që nxisin prishjen e besimit dhe të moralit, ato grupe që të kërkojnë përhapjen e fitneve ose polemikave, edhe nëse kjo është e lidhur me çështjet fetare...”

marrëdhënie të ndaluar, që shpesh fillon me një hyrje të pafajshme dhe përfundon thjesht duke shkaktuar dhimbje dhe dëme për jetën tuaj dhe besimin.

E shtata: Ose e merrni kontrollin e tij ju, ose kontrolloheni nga kurthet e internetit. Nëse e keni vënë atë nën kontrollin tuaj, atëherë ju do të merrni përfitimet e tij dhe do t'i shmangeni dëmit të tij, kështu që interneti bëhet një dhuratë nga Allahu për mirëqenien tuaj. Ndërsa nëse bini nën kontrollin e tij do t'i mjegullojë sytë tuaj me bukuri shkëlqyese dhe kënaqësi të përkohshme, do t'iu vjedhë paratë tuaja, kohën, jetën dhe detyrat tuaja, që keni ndaj familjes dhe të dashurve të tu. Ju do të bëheni pre' pa qenë të vetëdijshëm për atë që po ndodh. Ruaje veten nga ky kurth para se të jesh i humbur dhe para se të jetë tepër vonë. ■

Përshtati nga anglishtja: Fitim NUHIU

LUMTURIA SHPIRTËRORE

nuk duhet te merret parasysh hapja e kraharorit të njërit për një shkak aksidental dhe as ngushtimi i kraharorit të tjetrit po për një shkak aksidental, por për vetinë e qëndrueshme të zemrës, e cila i sjell hapje e zgjerim ose ngushtim dhe izolim. Pikërisht ajo është kriteri i lumturisë ose i mjerimit. Allahu na ndihmoftë!

IBËN KAJIM EL XHEUZIJE

Duke folur për faktorët që sjellin hapjen e gjoksit (lumturinë shpirtërore), Ibën Kajimi i rendit kështu:

1- Faktori më i madh që sjell hapjen e gjoksit dhe lumturi shpirtërore është **teuhidi** (njëjësimi i Allahut). Lumturia shpirtërore e njeriut do të jetë në varësi të përsosjes, fuqisë dhe shtimit të teuhidit. Sa më të përsosur e të fuqishëm, që njeriu ta ketë Teuhidin, aq më të hapur do ta ketë gjoksin dhe aq më shumë do të ndjejë kënaqësi shpirtërore. Allahu i Lartësuar thotë: ***“A është njëlloj si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet,*** (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?!). ***Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të këtillë janë në humbje të qartë!*** [Zumer: 22]. Po ashtu thotë: ***“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell.”*** [Enam: 125].

Kësisoj, udhëzimi dhe teuhidi janë ndër faktorët më të mëdhenj të hapjes së kraharorit, ndërsa shirku (vënia shok Allahut) dhe devijimi nga rruga e drejtë janë ndër faktorët më të mëdhenj të shtrëngimit dhe ngushtimit të kraharorit.

2- Drita që Allahu e hedh në zemrën e

robit, pra, drita e imanit. Drita e imanit e hap dhe e zgjeron gjoksin dhe e mbush me gëzim zemrën. Nëse kjo dritë nuk gjendet në zemrën e robit, ajo ngushtohet dhe shtrëngohet, ajo bie në burgun më të ngushtë dhe më të vështirë. Tirmidhiu shënon në librin *‘Xhami’*, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: ***“Kur hyn drita në një zemër, ajo hapet dhe zgjerohet”***. Të pranishmit e pyetën: ***“Kush është shenja e këtij zgjerimi, o i Dërguari i Allahut?”*** Ai u përgjigj: ***“T’i kushtohesh vendbanimit të përjetshëm, të distancohesh nga vendbanimi i rremë dhe të përgatitesh për vdekjen para se të të bjerë”***.¹ Kështu, njeriut do t’i hapet gjoksi sipas hises së tij prej kësaj drite. Në fakt, e këtillë është edhe drita e dukshme, fizike dhe errësira e dukshme: e para ta hap kraharorin dhe të jep qetësi, kurse e dyta ta shtrëngon.

3- Faktori i tretë është dija, pasi ajo e hap gjoksin dhe e zgjeron atë, duke e bërë ndoshta, shpirtërisht, edhe më të gjerë sesa dynjaja, ndërsa padituria shkakton ngushtim, kufizim dhe izolim në zemër. Sa më e gjerë të bëhet dija e njeriut, aq më i hapur dhe më i gjerë bëhet kraharori i tij. Megjithatë këtu nuk është fjala për çdo lloj dije, por për dijen e trashëguar nga i Dërguari i Allahut, pra, për dijen e dobishme. Pikërisht, zotëruesit e kësaj dije janë njerëzit me gjoksin më të hapur, njerëzit më zemërgjerë, njerëzit me sjelljen më të mirë dhe njerëzit që bëjnë jetën më të

¹ Në fakt, hadithin nuk e shënon Tirmidhiu, siç e ka përmendur Ibën Kajim më sipër, por Taberiu, Ibën Ebi Shejbe dhe Ibën Ebi Dunja. Gjithsesi hadithi është i dobët.

mirë, më të këndshme dhe më të kënaqshme.

4- Të kthehesh tek Allahu i Lartësuar me pendim dhe duke bërë punë të mira, ta duash Allahun me gjithë zemër, t'i kushtohesh Atij dhe të prehesh duke e adhuruar Atë. Nuk ka gjë që mund ta hapë gjoksin e t'i japë kënaqësi zemrës më shumë sesa kjo. Një njeri që prek një përjetim të tillë shpirtëror ndonjëherë mund të thotë: "Nëse do të jem në xhenet në një gjendje si kjo, atëherë unë do të bëj një jetë të këndshme". Dashuria për Allahun e Lartësuar ka një ndikim të habitshëm në hapjen e gjoksit, kënaqjen e prehjen e shpirtit dhe lumturinë e zemrës, gjë të cilën e di veçse ai që ka një ndjesi të tillë. Sa më e madhe e më e zjarrtë të jetë dashuria për Allahun, aq më i gjerë e më i hapur bëhet kraharori. Ai që ka një dashuri të tillë ndjen ngushtësi në zemër veçse kur shikon njerëzit e papunë, të ngeshëm e të zbrazët nga kjo lloj dashurie: shikimi i tyre është pluhur për syrin e tij, kurse shoqërimi me ta është ethe për shpirtin e tij.

Ndër shkaqet më të mëdha të ngushtimit në kraharor është shmangia nga Allahu i Lartësuar, lidhje e zemrës me diçka tjetër

“Që dashurohet pas diçkaje tjetër veç Allahut, do të torturohet për shkak të saj, duke e pasur zemrën të burgosur në dashurinë për atë gjë. Kjo bën që të mos gjendet mbi faqen e tokës njeri më të mjerë, më të trazuar, më të trishtuar, e me zemër më të shqetësuar sesa ai ...”

veç Allahut, shkujdesja ndaj dhikrit (përmendjes) të Tij, dashuria për diçka tjetër veç Tij², pasi ai që dashurohet pas diçkaje tjetër veç Allahut, do të torturohet për shkak të saj, duke e pasur zemrën të burgosur në dashurinë për atë gjë. Kjo bën që të mos gjendet mbi faqen e tokës njeri më të mjerë, më të trazuar, më të trishtuar, e me zemër më të shqetësuar sesa ai. Kështu pra, janë dy lloje dashurie, njëra prej të cilave është xheneti i dynjasë, është kënaqësi për zemrën, është hare, lumturi,

² Dashuria për diçka tjetër veç Allahut është dy llojesh, njëra prej të cilave është shirk (idhujtari) dhe ajo është dashuria e idhujtarëve për idhujt e tyre. Idhujtarët i duan hyjnitë e tyre krahas Allahut, ashtu siç duan Allahun. Kjo është dashuri adhurimi dhe pasohet me frikë, shpresë dhe lutje nga adhuresi për hyjnitë. Lloji i dytë është dashuria e natyrshme, e cila nuk e çrrënjos teuhidin dhe nuk të nxjerr nga feja, por në ndonjë rast mund të cenojë përsosjen e sinqeritetit dhe të dashurisë ndaj Allahut. E këtillë është dashuria për gratë, për fëmijët, për arin dhe argjendin, për pasurinë etj. Njeriu mund të pasionohet pas gjërave të tilla, ashtu si pasioni i të uriturit për ushqim dhe të eturit për ujë. Njerëzit në raport me këtë dashuri ndahen në tre kategori. Kategoria e parë janë ata që i duan për hir të Allahut, duke i përdorur pra, si mjete për të arritur tek Allahu. Kështu, nëse njeriu i do këto gjëra, për t'i përdorur si mënyrë për të arritur tek Allahu dhe për t'i shfrytëzuar si mundësi për t'i bërë ibadet Allahut e për të bërë atë që pëlqen Ai, shpërblehet për to. E tillë ka qenë dashuria e njeriut më të përsosur për gratë dhe erën e mirë, gjë të cilën e ka shprehur vet në një hadith të vërtetë. Pasoni për këto dy gjëra e ndihmonte atë për të dashur më fort Allahun dhe për të përçuar sa më mirë mesazhin e Tij te njerëzit. Kategoria e dytë janë ata që pasionohen pas këtyre gjërave thjesht nga prirjet e natyrshme dhe dëshira vetjake, por gjithsesi ata nuk u japin atyre përparësi kundrejt asaj që do e që pëlqen Allahu. Në këtë rast pasioni pas këtyre gjërave nuk quhet gjynah, pasi ato konsiderohen prej gjërave të lejueshme, për të cilat njeriu nuk dënohet. Megjithatë pasioni pas tyre në këtë rast bëhet pengesë për përsosjen e dashurisë ndaj Allahut. Kategoria e tretë janë ata që pasionohen pas këtyre gjërave, duke i shndërruar ato në qëllimin dhe objektivin e jetës. Ata u japin përparësi atyre kundrejt asaj që do e që pëlqen Allahu. Në këtë rast njeriu konsiderohet i padrejtë ndaj vetvetes dhe pasues i epshit të tij. [Marrë nga libri i Ibën Kajimit “Shpirti”].

ushqim dhe ilaç për shpirtin, madje është jeta e shpirtit dhe kënaqësia e syrit, dhe ajo është dashuria me gjithë zemër vetëm për Allahun. Në këtë gjendje njeriu i kushtohet Allahut me prirjet, pasionet, dëshirën dhe tërë dashurinë. Dashuria tjetër është mundim dhe pikëllim për shpirtin, është burg për zemrën dhe ngushticë në kraharor, është shkaku i dhimbjes, i trishtimit, i brengosjes dhe i mundimit, dhe ajo është dashuria për diçka tjetër veç Allahut të Lartësuar.

5- Përmendja pandërprerë e Allahut të Lartësuar në çdo gjendje dhe në çdo vend. Dhikri ka një ndikim të çuditshëm në hapjen shpirtërore të gjoksit dhe në lumturinë e zemrës, por nga ana tjetër edhe shkujdesja ndaj dhikrit ka ndikim të çuditshëm në ngushtimin, izolimin dhe mundimin shpirtëror të gjoksit.

6- T'u bësh mirë krijesave dhe t'u bësh dobi atyre me të gjitha mënyrat e mundshme, si me pasuri, me pozitë, duke i ndihmuar me trup, e të tjera mënyra mirëbërje. Kjo, pasi bujari, mirëbërësi është njeriu me kraharorin më të hapur, bën jetën me të këndshme dhe ka zemrën më të lumtur, ndërsa koprraci, pra, ai që nuk bën mirë, është njeriu që ndjen ngushticën më të madhe në kraharor, bën jetën më të mjerueshme dhe është më i pikëlluari e më i brengosuri.

Në një hadith të saktë, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka dhënë një shembull për koprracin dhe mirëbërësin, duke thënë se *shembulli i tyre është si dy burra që janë veshur me parzmore hekuri: Sa herë që mirëbërësi bën mend të japë sadaka, parzmorja e tij hapet, shtrihet mbi trup dhe zgjerohet, aq sa ia mbulon krejt rrobat e trupin dhe i fshin edhe gjurmët që*

lë duke ecur në tokë, kurse koprraci sa herë që bën mend të japë sadaka, çdo hallkë e parzmore ngjitet dhe shtrëngohet në vend, duke mos lejuar që të hapet e t'i mbulojë trupin". Ky është shembulli i hapjes dhe i zgjerimit shpirtëror të kraharorit të besimtarit që jep sadaka dhe shembulli i ngushtimit dhe shtrëngimit të zemrës së koprracit.

7- Trimëria, pasi trimi e ka kraharorin të hapur, mendjen krejt të qetë dhe zemrën të gjerë, ndërsa e kundërta ndodh me frikacakun: ai është njeriu me kraharorin me të ngushtë dhe zemrën më të kufizuar e më të izoluar. Gëzimi, hareja dhe kënaqësia, që mund të përjetojë frikaku është njësoj si ajo e gjallesës shtazarake, pasi ai është i privuar nga gëzimi, kënaqësia, lumturia dhe hareja e shpirtit, sikurse është i privuar prej tyre çdo kurnac, madje edhe çdo njeri që i ka kthyer shpinën Allahut, që është i shkujdesur ndaj përmendjes së Tij, që nuk e njeh Atë dhe as emrat, cilësitë dhe fenë e Tij, që e ka zemrën të lidhur me diçka tjetër veç Tij. Sigurisht që kjo lumturi e hare shpirtërore në jetën e varrit shndërrohet në kopshte të gjera e të bukura, ndërsa ngushtimi dhe izolimi shpirtëror shndërrohet në vuajtje dhe burg. Kështu pra, gjendja e njeriut në varr, për sa i përket lumturisë ose mundimit, burgut ose hapjes dhe lirshmërisë do të jetë si gjendja e zemrës në kraharor. Këtu nuk duhet te merret parasysh hapja e kraharorit të njërit për një shkak aksidental dhe as ngushtimi i kraharorit të tjetrit po për një shkak aksidental, por për vetinë e qëndrueshme të zemrës, e cila i sjell hapje e zgjerim ose ngushtim dhe izolim. Pikërisht ajo është kriteri i lumturisë ose i mjerimit. Allahu na ndihmoftë!

³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi. Kuptimi i ilustrimit të mësipërm është se njeriu bujar kur bën mend të japë sadaka, i hapet kraharori dhe i priret shpirti për të bërë mirë e për të dhënë sadaka, ndërsa koprraci kur çon nëpër mend sadakanë, shpirti i tij kursehet, e për rrjedhim i ngushtohet kraharori dhe i shtrëngohen duart.

8- Ndër faktorët më të rëndësishëm është edhe nxjerrja e asaj që dëmtion shpirtërisht zemrën, domethënë eliminimi i tipareve të dëmshme e të dënueshme, të cilat i shkaktojnë zemrës ngushtim dhe mundim dhe që bëhen pengesë për shërimin e saj. Kjo për vetë faktin se pajisja me faktorët, të cilët zgjerojnë shpirtërisht kraharorin, pa nxjerrë vetitë korruptuese e të këqija prej zemrës, nuk jep efekt për hapjen dhe zgjerimin e kraharorit. Efekti maksimal që mund të japë veprimi i shkaqeve për një njeri të tillë është fakti se në zemrën e tij vërtiten dy veti, njëra e dëmshme dhe tjetra e mirë, kështu që gjendja shpirtërore e këtij njeriu do të jetë sipas vetisë që do të dominojë në zemrën e tij.

9- Lënia e shikimit të tepërt, bisedës së tepërt, dëgjimit të tepërt, shoqërimit të tepërt me njerëzit, ngrënies së tepërt dhe gjumit të tepërt, pasi këto teprica shndërrohen në dhimbje, pikëllim dhe dëshpërim për zemrën, çka bën që ajo të kufizohet, të izolohet, të ngushtohet dhe të mundohet. Madje përgjithësisht vuajtja e dynjasë dhe e ahiretit vjen prej tyre. Mendo sa i ngushtë është kraharori i atij, që i ka të gjitha të metat e mësipërme, sa e mjerueshme është jeta e tij, sa e keqe është gjendja e tij dhe sa fort e izoluar është zemra e tij. Dhe nga ana tjetër, mendo sa e lumtur është jeta e atij që i ka të gjitha ato cilësitë e lavdërueshme, që i aspiron ato dhe që prej secilës prej tyre ka bërë pjesë për vete. Ky person do të ketë pjesë të bollshme prej fjalës së Allahut të Lartësuar: **“Vërtet, të devotshmit do të jenë në lumturi”**. [Infitar: 13]. Ndërsa i pari do të ketë pjesë të bollshme prej fjalës së Allahut të Lartësuar: **“Dhe vërtet që të ligjtë, keqbërësit do të jenë në xhehim** (zjarrin flakërues)”. [Infitar: 14]. Ndërmjet këtyre të dyve ka mjaft rangje të

ndryshme lumturie e mjerimi, numrin e të cilëve e di vetëm Allahu i Lartësuar.

Qëllimi është që të bëjmë të ditur, se i Dërguari i Allahut ka qenë krijesa më e përsosur në çdo veti me të cilën arrihet hapja e kraharorit, zgjerimi i zemrës, kënaqja e syrit dhe jeta e shpirtit. Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* është krijesa më e përkryer në këtë hapje, këtë jetë dhe këtë kënaqësi, dhe kjo përveç faktit që Allahu i Lartësuar e veçoi atë edhe me hapjen fizike të kraharorit.

Sa më përpiktë që njeriu të pasojë Pejgamberin *sal-lallahu alejhi ue selem*, aq më të plotë do ta ketë hapjen shpirtërore, kënaqësinë dhe lumturinë. Në varësi të pasimit të Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, njeriu do të gjejë hapje shpirtërore, kënaqje të syrit dhe lumturinë e shpirtit. Pejgamberi ynë *sal-lallahu alejhi ue selem*, qëndron në majën e përsosmërisë së hapjes të kraharorit, ngritjes së famës, heqjes së barrës e gjynaheve, por edhe pasuesit e tij do t'i arrijnë këto gjëra në varësi të pasimit të tij *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Po kështu Allahu do t'i ruajë pasuesit e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, do t'i mbrojë nga të këqijat, do të largojë prej tyre dëmet, do t'i fuqizojë dhe do t'u japë ndihmë sipas përpikërisë së tyre në pasimin e tij *sal-lallahu alejhi ue selem*. Rrjedhimisht do të ketë njerëz, që do t'u jepen këto mirësi me pakicë dhe do të ketë të tjerë që do t'u jepen me shumicë. Kush gjen mirë le t'i shprehë lavdi dhe mirënjohje Allahut dhe kush gjen diçka ndryshe le të qortojë veçse vetveten. ■

Përktheu: Ismail Bardhoshi



MBËSHTETJA TEK ALLAHU

Sa nevojë kemi për të?

Mbështetja tek Allahu nënkupton: lidhjen dhe mbështetjen e singërtë dhe me besnikëri tek Allahu për të përfitur të mirat dhe për të larguar apo parandaluar dëmet, qofshin ato në lidhje me çështjet e kësaj bote, apo të botës tjetër

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Falënderimi i takon vetëm Allahut Zotit të gjithë botëve; nderimet, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi vulën e profetëve Muhamedin, mbi familjen e tij të nderuar, mbi shokët e tij besnikë dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Pa dyshim se mbështetja tek Allahu i Lartësuar ka një pozitë të madhe në Fenë Islame. Një gjë të tillë e vëren çdokush që mediton në tekstet që flasin për të. Çdokush ka nevojë për të, aq sa nuk mund ta zëvendësojë me diçka tjetër qoftë edhe sa hap e mbyll sytë.

Nga ana tjetër mbështetja tek Allahu konsiderohet prej adhurimeve më të larta për nga lidhja e ngushtë që ka ajo me njësimin (Teuhidin) e Allahut të Madhëruar, i Gjithëpushtetshmi thotë në Kuranin Famëlartë: **“Mbështetu në të**

Gjithëjetshmin, që nuk vdes kurrë”.¹ Ky ajet përmban një urdhër nga Allahu për Profetin e Tij², që të mbështetet në Të dhe të mos i varë shpresat tek askush tjetër veç Tij, sepse Ai është i Gjalli, që nuk vdes kurrë; është i Forti që ka mundësi për çdo gjë, ndaj dhe kush mbështetet tek Ai patjetër që do t'i mjaftojë me mbështetje dhe ndihmë. Ndërsa ai që mbështetet në dikë tjetër pos Allahut, padyshim që mbështetet te dikush, të cilit do t'i vijë vdekja dhe do të zhduket, që është i pamundur dhe dobësia e rrethon nga çdo anë. Për këtë shkak çdokush që mbështetet në të tillë, do të humbë e do të shuhet, sikurse çdokush që i var shpresat te dikush tjetër pos Allahut i gjithë mundi dhe lodhja e tij do t'i shkojë kot dhe dëm.

Në një ajet tjetër Allahu i madhëruar thotë: **“Dhe mbështetu në të Plot-fuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde”**.³

E gjitha kjo tregon për vlerën që ka

¹ Furkan: 58.

² I cili sigurisht është urdhër edhe për mbarë besimtarët.

³ Shuara: 217-219.

mbështetja tek Allahu, si dhe për rëndësinë që ka lidhja e fortë e zemrës me Të. Mbështetja tek Allahu nënkupton: lidhjen dhe mbështetjen e singertë dhe me besnikëri tek Allahu për të përfituar të mirat dhe për të larguar apo parandaluar dëmet, qofshin ato në lidhje me çështjet e kësaj bote, apo të botës tjetër. Thënë me fjalë të tjera: që robi ta lërë çështjen e tij në dorë të Allahut, si dhe të rrënjosë në zemër bindjen, se nuk jep dhe nuk ndalon, nuk dëmton dhe nuk sjell mirë, askush tjetër veç Allahut të Madhëruar. Prandaj dhe Allahu i Madhëruar i ka nxitur shpeshherë besimtarët në librin e Tij, që t'i mbështeten Atij fuqishëm dhe nga ana tjetër u ka sqaruar atyre dobitë dhe vlerat që ka mbështetja tek Ai.

Prej këtyre ajeteve mund të përmendim: **“...Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!”**⁴ **“Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai”**⁵ Ndërsa në një ajet tjetër e përmend atë si lavdërim për besimtarët, të cilët e kanë bërë mbështetjen cilësi të pandashme të tyre: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten...”**⁶

Edhe në Sunetin e pastër të shumtë janë tekstet, që flasin për mbështetjen tek Allahu i Madhëruar, prej tyre mund të përmendim hadithin e Omer ibën Hatabit, se Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Nëse do të mbështeteshit tek Allahu me një mbështetje të plotë, Ai do t’ju furnizonte ashtu sikurse furnizon zogun, i cili del nga foleja e tij i uritur dhe kthehet i ngopur”**⁷

Hafëz Ibën Rexhebi –Allahu e mëshiroftë-, ka thënë: “Ky hadith është bazë

në çështjen e mbështetjes, dhe se mbështetja tek Allahu është nga shkaqet më të mëdha për të arritur dhe për të përfituar riskun (furnizimin). Prandaj dhe Allahu thotë: **“Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje** (nga çdo vështirësi) **dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai”**⁸

Hadithi i mësipërm shpalos qartë atë, që nëse njeriu do të ndërmerre qoftë edhe shkaku më të vogël pas mbështetjes tek Allahu, ai sigurisht që do të arrinte furnizimin sikurse zogu që del nga foleja e tij i uritur dhe kthehet në mbrëmje i ngopur.

Po ashtu përcillet nga Xhabir ibën Abdullahu, se Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: **“Askush nuk do të vdesë pa e plotësuar riskun e tij, ndaj frikësojuni Allahut dhe kërkojeni atë në rrugë të mira, merreni atë që iu është lejuar dhe largohuni prej asaj që ju është ndaluar”**⁹

Këtu duhet të pohojmë diçka shumë të rëndësishme e të themi se: mbështetja e vërtetë është ajo që ngrihet mbi mbështetjen e plotë tek Allahu dhe kryerjen e shkaqeve, të cilat Allahu i ka krijuar për t’u realizuar ajo që kërkon njeriu. Allahu i Madhëruar thotë: **“Frikësojuni Allahut! Besimtarët le të mbështeten vetëm tek Allahu!”**¹⁰ Në këtë ajet Allahu e ka shoqëruar mbështetjen me devotshmërinë dhe ndrojtjen ndaj Tij, që përmban edhe kryerjen e shkaqeve, të cilat e plotësojnë atë. Kjo për faktin se mbështetja tek Allahu, duke mos kryer shkaqet e kërkuara për plotësimin e asaj që kërkon nuk është tjetër veçse paaftësi edhe nëse ajo është e veshur me një farë mbështetje, ndaj besimtari nuk duhet që ta kthejë mbështetjen tek Allahu

⁴ Maide: 23.

⁵ Talak: 3.

⁶ Enfal: 2.

⁷ Tirmidhiu, Nesai, Ibnu Maxha dhe Ahmedi.

⁸ Talak: 2-3.

⁹ Ibnu Maxha, Hakimi dhe Ibnu Hibani. Sahih Albani.

¹⁰ Maide: 11.

në paaftësi, sikurse dhe paaftësinë nuk duhet që ta konsiderojë si mbështetje tek Allahu i Madhëruar, përkundrazi ai duhet ta bëjë mbështetjen si një prej shkaqeve me të cilin ai do të arrijë qëllimet e tij. Rreth kësaj argumenton edhe hadithi, të cilin e përcjell Enesi se një burrë i tha Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*: “O i Dërguari i Allahut! A ta lidh devenë e pastaj të mbështetem tek Allahu, apo ta lëshoj e vetëm të mbështetem? Ai tha: *“Lidhe dhe më pas mbështetu”*.¹¹

Në këtë çështje kanë gabuar shumë njerëz, duke ia varur paaftësinë e tyre mbështetjes e kështu humbën shumë të drejta dhe detyra ndaj vetes dhe familjeve të tyre, ndërkohë që Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Mjafton si mëkat për dikë, nëse dëmton ata që duhet t'i ushqejë”*.¹² Për të tillë persona Profeti, bekimi dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Muslimani i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu, se muslimani i dobët, por tek të dy ka mirësi. Kujdesu për atë që të bën dobi, mbështetu tek Allahu dhe mos u trego i paaftë. Nëse të godet diçka, mos thuaj: sikur të kisha bërë kështu do të ndodhte kështu, por thuaj: Caktimi i Allahut, çfarë deshi bëri, sepse (shprehja) sikur i hap portën shejtanit”*.¹³

Duhet të vëmë theksin këtu, se mbështetja e dobët tek njeriu rrjedh si shkak i besimit të dobët që ai ka në caktimin e Allahut, kjo sepse ai që ia lë çështjet e tij Allahut, patjetër që duhet të kënaqet me

“...Mbështetja e vërtetë është ajo që ngrihet mbi mbështetjen e plotë tek Allahu dhe kryerjen e shkaqeve...”

ç’ka zgjedhur dhe përcaktuar Allahu për të. Ndërsa ai që ia dorëzon çështjet e tij dikujt tjetër veç Allahut dhe e lidh zemrën e tij me të, padyshim që ai është i mashtruar, i poshtëruar dhe i pakujdesshëm ndaj Zotit të tij Fuqiplotë. Ibën Mesudi përcjell, se Profeti bekimi dhe nderimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Çdo kënd që e godet vështirësia (fukarallëku) dhe ai ia paraqet atë njerëzve (duke u mbështetur tek ata), nuk do të mund ta largojë vështirësinë që i ka rënë, ndërsa ai që ia paraqet Allahut (duke u mbështetur tek Ai), gati sa nuk i është përgjigjur Allahu me furnizim...”*.¹⁴

Shejhul Islam Ibën Tejmije –Allahu e mëshiroftë-, ka thënë¹⁵: *“Çdokush që shpreson prej krijesës dhe mbështetet tek ajo do të zhgënjehet për atë që mendonte rreth saj, sepse ai është idhujtar. Allahu i Lartësuar thotë: “Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur”*.¹⁶

Ndërsa dijetari Abdurrahman ibën Hasen Alu Shejh –Allahu e mëshiroftë- ka thënë: *“Mbështetja është dy llojesh”*.¹⁷

¹¹ Tirmidhu, Ibën Huzejme dhe Taberani. Hasen Albani.

¹² Ebu Daudi. Këtu qëllimi është dëmtimi i familjes duke mos u kujdesur si duhet për ta, ose për shkak të paaftësisë, ose për shkak të keqmenaxhimit të pasurisë.

¹³ Ibnu Maxha. Sahih Albani.

¹⁴ Ebu Daudi, Tirmidhiu. Sahih Albani.

¹⁵ Mexhmuatul Fetava, 10/275.

¹⁶ Haxh: 31.

¹⁷ Ky dijetar këtu shpjegon fjalën e Shejhul Islam Ibën Tejmijes në lidhje me mbështetjen e njeriut tek krijesat duke sqaruar se një gjë e tillë është shirk i madh, që e nxjerr njeriun nga feja, ose shirk i vogël, i cili edhe ky është shumë i rrezikshëm. Kështu që njeriu duhet që ta vari shpresën e tij vetëm tek Allahu i Madhëruar dhe vetëm Atij t’i mbështetet.

Një: Mbështetja për gjëra të cilat mund t'i realizojë vetëm Allahu i Madhëruar, si rasti i atyre që i mbështeten të vdekurve dhe tagutëve, duke shpresuar për realizimin e kërkesave të tyre, siç është: fitorja, ruajtja e riskut (pasurisë) apo kërkimi i ndërmjetësimit. Kjo lloj mbështetje është shirk (idhujtari) i madh.

Dy: Mbështetja në shkaqet e prekshme, si rasti i atij që i mbështetet një princi apo pushtetari, për gjëra të cilat Allahu i ka dhënë fuqi dhe mundësi prej furnizimit apo largimin e ndonjë lëndimi prej tij. Ky është shirk i vogël.

Mbështetja e lejuar është ngarkimi i një njeriu për të bërë diçka të mundshme për të në vend të tij, por jo t'i mbështetet atij për gjërat me të cilat e ka ngarkuar, por t'i mbështetet Allahut që t'ia lehtësojë çështjen, të cilën ai apo i ngarkuari kërkon të realizojë. Kjo bën pjesë në grupin e shkaqeve, të cilat lejohen të kryhen e të shfrytëzohen, por jo që të mbështetet në to, përkundrazi duhet të mbështetesh në Krijuesin e shkaqeve dhe të pasojave.¹⁸ Ajo që e sqaron më qartë realizimin e mbështetjes tek Allahu, duke marrë parasysh dhe shkaqet dhe lidhjen e zemrës me Allahun e vetëm, është ajo që tregon Ebu Bekri në hixhretin e Profetit për në Medine ku thotë: Pashë këmbët e idhujtarëve, të cilët ishin mbi kokat tona, ndërkohë që ne ishim fshehur në shpellë. Thashë: O i Dërguari i Allahut! Nëse ndonjëri prej tyre do të hedhë sytë poshtë këmbëve të veta do të na shohë. Ai tha: *“Si mendon ti, o Ebu Bekër, për dy, i treti¹⁹ i të cilëve është Allahu”*.²⁰

Çdokush që mbështetet tek Allahu,

patjetër që do të arrijë të përfitojë prej mirësive dhe fryteve të tij -në vartësi të realizimit të tij-, atë që nuk ia pret mendja dhe që nuk mund të përshkruhet. I këtilli do të jetë njeriu më i qetë dhe me jetën më të mirë, ashtu sikurse ka thënë edhe Allahu: *“Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai”*.²¹

Në mbyllje dhe në përfundim të këtij shkrimi, nuk mund të anashkalojmë mënyrën se si duhet të sillen muslimanët në raste të tilla, si ai që po kalon sot e gjithë bota me virusin e gripit të derrit A (H1N1), ajo që kërkohet prej muslimanëve është mbështetja e vërtetë dhe e fuqishme tek Allahu për t'i ruajtur nga kjo epidemi dhe të tjera si këto. Gjithashtu ata duhet ta dinë, se asgjë nuk ndodh pa caktimin e Allahut dhe se fenomene të tilla janë dënim për jobesimtarët dhe sprovë për besimtarët. Megjithatë besimtari duhet ta kuptojë se kjo është jetë e sprovës dhe nëse preket nga diçka e tillë nuk duhet të alarmohet, por të mbështetet tek Allahu dhe të shpresojë shërimin prej Tij. Së fundmi, e lusim Allahun të na ruajë neve dhe të gjithë muslimanët nga çdo e keqe, e cila përhapet si shkak i gjynaheve të robërve dhe të na bëjë prej atyre që mbështeten vetëm tek Ai dhe shpresojnë vetëm prej Tij. ■

¹⁸ Fet'hul Mexhid, 426. Mbështetja e të Lavdishmit në shpjegimin e librit të Teuhidit, 376.

¹⁹ I treti me mbrojtje e përkujdesje dhe jo me qenien e Tij. I lartësuar është Allahu nga ajo që mund të shpifin për të gënjeshtarët.

²⁰ Buhari dhe Muslimi.

²¹ Talak: 3.



“Pastërtia është gjysma e besimit...” Fjalët e këtij hadithi të cilat, sipas një dijetari, hyjnë në zemrën e njeriut pa kërkuar leje dhe janë nxitëse për vepra të mira, në vetvete përmbajnë disa dispozita për të cilat ka nevojë çdo besimtar.

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Epidemi të llojeve të ndryshme po e përmbysin botën. Krahas epidemive të degjenerimit moral dhe shpirtëror, që mbesin pa jehonë mediale, ne sot jemi dëshmitarë edhe të pandemisë së gripit të shkaktuar nga virusi A (H1 N1) i njohur ndryshe si gripi i derrave (fillimisht i etiketuar si “gripi i derrit”, por që shumë shpejt me ndikimin e industrive ushqimore u etiketua me emrin shkencor “A (H1 N1)” nga studiuesit). E tërë makineria informative është angazhuar në ballafaqimin me këtë grip. Higjiena personale, pastërtia dhe shmangia e tubimeve masive janë këshillat, të cilat dëgjohen e lexohen më shpesh...

Dilemat e ndryshme rreth këtij gripit, rreth vaksinave, të dëmshme apo jo të dëmshme, rreth përfitimit, rreth

laboratorëve që kanë ringjallur virusin të zhdukur qysh në vitet e njëzeta të shekullit të kaluar nuk janë tema e këtij shkrimi. Megjithatë vlen të përmendet, se sipas statistikave botërore pandemitë “e reja” si zakonisht “paraqiten” në kohë të recesionit. Pandemia e parë e gripit spanjoll (të cilin e shkaktoi virusi i tipit H1 N1) u paraqit në vitin 1918. SIDA u paraqit në vitin 1982, kur në SHBA kishte recesion, edhe tani pandemia e gripit të derrave e arriti kulmin në kohën kur e tërë ekonomia botërore vuan nga kriza financiare. Rastësisht ose jo sëmundje të përmasave të këtylla nuk paraqiten në gjendje mirëqenieje. Nga ana tjetër vendet e varfra me vite të tëra nuk kanë qasje tek ilaçe për sëmundjet e varfërisë, si tuberkulozi, malaria etj. Si duket myshterijë e synuar janë vendet e pasura, të cilët e blejnë ilaçin e jo ato vende, të cilët duhen t’i marrin këto

ilaçe si dhurata. Profiti prej 8-18 miliardë dollarë për kompanitë farmaceutike në kohë krize nuk është aspak i “vogël”. Sidoqoftë pastërtia dhe higjiena që trumbetohen, si mënyrat më efikase për parandalim janë pjesë e pandarë e modelit Islam të jetesës.

Pastërtia si normë Islame

Koncepti islam për pastërtinë paraqet një sistem mahnitës rregullash që inkorporohet në të gjitha aspektet e jetës, është emergjencë e jetës islame në nivelin individual dhe atë shoqëror. Në shumë nga tekstet e Shpalljes Hyjnore pastërtia trupore dhe shpirtërore vihet në spikamë. Islami është një shembull unik për theksimin e pastërtisë dhe për mënyrën e trajtimit të saj. Përderisa tek të tjerët pastërtia është vetëm një prej attributeve të preferuara, Islami këmbëngul në domosdoshmërinë e saj dhe lidhshmërinë me besimin/imanin. Pastërtia është pjesë esenciale e jetës islame dhe kuptimi i saj shkon përtej limiteve të koncepteve sipërfaqësore të pastërtisë konvencionale.

Nuk ka dyshim se parimet islame të pastërtisë janë në korrelacion të plotë me normat më precize të mjekësisë preventive dhe asaj terapeutike. Sheriati islam me rregullat e pastërtisë është shumë para sistemeve të ndryshme të shëndetësisë në të kaluarën dhe në të tashmen. Allahu, subhanehu ue te’ala, në Kuran thotë:

“Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.” (Bekare, 222). Kurtubiu në komentin e këtij ajeti thotë: Të penduarit në këtë ajet janë ata që pendohen prej mëkateve dhe shirkut, ndërsa **“...ata që pastrohen”** janë ata që pastronin me ujë trupin e tyre (gusli dhe abdesi) dhe që largohen nga mëkatet, siç janë edhe marrëdhëniet me gratë gjatë ciklit menstrual.

Në një ajet tjetër Allahu thotë: **“Ndërsa**

“...Në një testim mikrobiologjik është vërtetuar ulja e përqindjes së bakteve në hundën e atyre që përsërisin shpesh ritin e marrjes së avdesit...””

xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) **që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.”** (Teube, 108)

Kurtubiu thotë: Allahu i lavdëron ata që e duan pastërtinë dhe që i japin rëndësinë e duhur asaj. Pastërtia është shenjë fisnikërie dhe detyrë fetare. Për rëndësinë e pastërtisë në Islam argument i mjaftueshëm është edhe ajeti me të cilin abdesi ligjësohet, si parakusht i namazit: **“O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, kurse kokën fshijeni me dorë të lagët; lani edhe këmbët deri në nyje.”** (Maide, 6) Për pastërtinë fizike madje edhe të asaj më intime flasin edhe shumë hadithe të Pejgamberit, **alejhi salatu ue selam**. Kur një provokues iu drejtua sahabiut të ndershëm **Selmanit** me këto fjalë provokuese: “A edhe mënyrën se si kryhet nevoja ua ka mësuar i Dërguari juaj, ai pa ngurrar i tha: Po, ai na ndaloi të drejtohem i kah Kibleja gjatë kryerjes së nevojës së madhe dhe asaj të vogël, na ndaloi të pastrohemi me dorën e djathtë dhe të pastrohemi me më pak se tre gurë...” (Muslimi).

I Dërguari i Allahut, **sal-lallahu alejhi ue selem**, në hadithin që e përcjell Muslimi thotë: **“Pastërtia është gjysma e besimit...”** Fjalët e këtij hadithi të cilat, sipas një dijetari, hyjnë në zemrën e njeriut pa kërkuar leje dhe janë nxitëse për vepra të mira, në vetvete përmbajnë disa dispozita për të cilat ka

nevojë çdo besimtar.

Pastërtia e përmendur në këtë hadith në të vërtetë është angazhimi i vazhdueshëm për ta ruajtur pastërtinë trupore dhe shpirtërore. Për pastërtinë e përmendur në këtë hadith ka dy mendime. Sipas të parit, bëhet fjalë për pastrimin e papastërtive jo të dukshme, që njollosin shpirtin dhe gjymtyrët, si shirku dhe shtirja (rijaja), veprimi i ndalesave dhe moszbatimi i urdhëresave fetare. Këtë kuptim dijetarët e mbështesin në njërin nga dy komentet e ajetit: *“...petkat e tua pastroji”*, sipas të cilit në ajet bëhet fjalë për pastrimin prej shirkut dhe papastërtive jo të dukshme. Komentuesit e Kuranit ajetin: *“Dëbojeni familjen e Lutit prej qytetit tuaj, sepse ata janë njerëz që pastrohen”* (Nemël, 56) për pastërtinë e përmendur në ajet thonë se këtu flitet për largimin nga veprat e shëmtuara, siç janë edhe marrëdhëniet homoseksuale, që ishin shumë të përhapura tek populli i Lutit, alejhi selam. Duke u mbështetur në këtë koment dijetarët thonë, se pastërtia e përmendur në hadithin e sipërpërmendur është pastërtia e zemrës, gjymtyrëve dhe gjuhës nga haramet në mesin e të cilëve pjesë bën edhe moskryerja e obligimeve. Sipas mendimit të dytë pastërtia e përmendur në hadith është pastërtia trupore me anë të abdesit dhe guslit.

Koncepti Islam i pastërtisë dhe të vërtetat shkencore

Sipas studimeve mjekësore avdesi ndikon në relaksim e nervave dhe muskujve, ul shtypjen e gjakut, ndikon në largimin e stresit dhe të dhimbjeve të ndryshme. Këtë e vërteton studimi i mjekut **Ahmed Sheuki Ibrahim**, specialisti i mjekësisë interne dhe anëtar i Shoqatës Mbretërore të Mjekëve në Londër.

Në një testim mikrobiologjik është vërtetuar ulja e përqindjes së baktereve në

“Në librat e historisë islame gjendet shembulli i parë i mbikëqyrjes ekologjike, siç ishte posti i mbikëqyrësit të furrave dhe rregullorja e rreptë, që kishte të bëjë me pastërtinë gjatë përgatitjes së bukës...”

hundën e atyre që përsërisin shpesh ritin e marrjes së avdesit. Pastrimi i gojës me anë të gargarës parandalon infektimin e gojës dhe është e dobishme për parandalimin e kariesit. Larja e duarve, fytyrës dhe këmbëve largon prej lëkurës pluhurin dhe yndyrat, që janë mjedis ideal për shumëfishimin e baktereve. Avdesi është i dobishëm për stimulimin e qarkullimit të gjakut në pjesët periferike të trupit në të cilat qarkullimi është paksa i ngadalshëm. Një qarkullim i rregullt i gjakut i jep gjallëri trupit dhe e rrit efektivitetin në punë. Gjitha lëngjet dhe sekrecionet (urina, gjaku menstrual, fecesi, sekrecioni i hundës etj.), të cilat Islami ka urdhëruar të pastrohen janë strofoll i mundshëm i zhvillimit dhe riprodhimit të baktereve dhe viruseve.

Pastrimi i dhëmbëve me misvak, si sunet i vërtetuar, prej më tepër se katërmbëdhjetë shekujsh, tregon se sa përparimtar ka qenë/është Islami në aspektin e higjienës orale. Me prerjen e thonjve, higjienën e organeve gjenitale dhe me rruajtjen e qimeve gjenitale dhe të nënsqetullave parandalohen sëmundjet e shumta të lëkurës.

Krahas pastërtisë individuale nuk mundet e të mos përmendet pastërtia e mjedisit. Në disa hadithe ndalohet ndotja e mjedisit. Shembull janë hadithet që ndalon urinimin në ujin që nuk rrjedh, kryerjen e nevojës në

vendet ku kalojnë njerëzit, ose i marrin si vendpushim dhe hadithi i cili largimin e asaj që i pengon njerëzve nga rruga e ka quajtur lëmoshë. Në librat e historisë islame gjendet shembulli i parë i mbikëqyrjes ekologjike, siç ishte posti i mbikëqyrësit të furrave dhe rregullorja e rreptë, që kishte të bëjë me pastërtinë gjatë përgatitjes së bukës, si dhe gjatë pjekjes. Për shembull ishte kusht, që çdo furrë të ketë oxhaqe të gjëra për nxjerrjen e tymit, si dhe ndalohej brumi të zihet me këmbë ose gjunjë... e gjithë kjo vinte si pasojë e vetëdijes së lartë për rëndësinë e pastërtisë kolektive dhe mjedisore.

Disa rregulla fetare lidhur me epidemitë

- Sëmundjet, fatkeqësitë natyrore, aksidentet janë caktim i Allahut prandaj besimtari i vërtetë pajtohet me caktimin e Allahut dhe me durim shpreson të arrijë në shpërblimin e pakufizuar, të cilin Allahu e ka përgatitur për durimtarët. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Për t’u habitur është çështja e besimtarit, çdo gjë që i ndodh është hair për të. Nëse i ndodh ndonjë e mirë e falënderon Allahun dhe bëhet mirë për të dhe nëse e godet ndonjë vështirësi duron dhe bëhet mirë për të. Këtë nuk e ka askush pos besimtarit.”*

- Sëmundjet me të cilat ballafaqohemi dhe me të cilat sprovohen njerëzit janë raste që besimtarëve duhet t’ua kujtojnë begatitë e shumta të Allahut dhe domosdoshmërinë e shprehjes së falënderimit ndaj Allahut. Këto raste na kujtojnë edhe nevojën e mbështetjes së plotë tek Allahu.

- Për të sëmurin parapëlqehet mjekimi me ilaçet, që nuk janë të ndaluara fetarisht dhe kjo assesi nuk është në kundërshtim me tevekulin.

- Vaksinimi si metodë parandaluese është i lejuar, por me kusht që vaksina të jetë efikase, të jetë me përbërje të lejuar fetarisht (hallall) dhe jo e dëmshme për shëndetin e

njeriut. Për rrethanat tona (kur muslimanët janë pakicë dhe kur mundësia për keqpërdorime është e madhe) konsultimi me mjekun që është ekspert në këtë lëmi, e që në të njëjtën kohë është musliman dhe besnik është i domosdoshëm.

- Islami nuk e mohon mundësinë e infektimit pas kontaktit me të sëmurin. Ajo që Islami e mohon është bindja se vetëm kontakti me të infektuarin me ndonjë sëmundje ngjitëse mjafton për infektim të sigurt. Besimtari është i bindur, se asgjë nuk ndodh pa caktimin e Allahut. Megjithatë është parim fetar t’i shmangësh kontaktet me ndonjë të infektuar me sëmundje ngjitëse. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Ik prej të gërbulëtit si prej luanit.”*

- Parimet e higjienës në Islam përpos shpërblimeve të Allahut janë edhe veprime, që parandalojnë shumë sëmundje të llojeve të ndryshme.

- Nëse në ndonjë vend paraqitet ndonjë epidemi besimtarit i ndalohet të shkojë në atë vend. Nëse epidemia përhapet kur ai është brenda atij vendi atij i ndalohet të largohet nga vendi i goditur nga epidemia. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Nëse dëgjoni se në një vend është përhapur murtaja mos hyni në të, nëse ajo përhapet kur ju jeni atje mos dilni prej atij (vendi).”*

- Forcimi i lidhjeve ndër-njerëzore shfaqet në situata të këtilla. Besimtarët duhet që këto raste t’i shfrytëzojnë duke u ofruar ndihmë dhe informacione të sakta fetare për kësi situatash.

Allahun e lus t’i mbrojë muslimanët nga sprovat e rënda, t’i mëshirojë dhe t’i udhëzojë në rrugën e drejtë islame, që u garanton atyre jetë të lumtur në dynja dhe lumturi të përherëshme në ahiret. Amin. ■

FUQIA E VULLNETIT

kriza reale prej së cilës vuajnë muslimanët sot në shumë fusha të ndryshme civilizuese, si në aspektin e mbrojtjes nga komplotet e armiqve, të çlirimit të vendeve të pushtuara etj., është mungesë e vullnetit e jo e mundësive

PËRMBLODHI: AGRON TERZIQI

Ne zakonisht gjërat (materiale) që na rrethojnë jemi mësuar që me pak angazhim t'i llogarisim, t'i vërtetojmë dhe po ashtu t'i varim mbi to shpresat tona. Në anën tjetër zotërojmë energji dhe aftësi të brendshme për të pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në këto gjëra, mirëpo fatkeqësisht ne nuk i shfrytëzojmë këto mundësi dhe kështu që nuk përfitojmë prej tyre, për shkak se nuk jemi të ndërgjegjshëm për to dhe nuk i perceptojmë siç duhet.

Vullneti konsiderohet si forcë e jashtëzakonshme, të cilën Allahu ia dhuroi racës njerëzore. Ai që është mirënjohës për këtë dhunti, punon për ta rrënjosur dhe për ta forcuar atë, si dhe duke e ngritur nivelin e vendosmërisë në planifikim dhe angazhim. Është e mirënjohur nga të gjithë, se nuk ka mundësi të realizohet asnjë punë veçse me plotësimin e dy elementeve: vullnetit dhe potencialit. Kur dikush pyet cila prej tyre është më e rëndësishme, atëherë pa dyshim që vullneti është më vendimtar dhe më me peshë, ngase njeriu kur vendos për të arritur sinqerisht dhe me ngulm diçka, ai nxiton që t'i sigurojë mekanizmat e duhur për të finalizuar atë. Vullneti i çeliktë zbulon aftësitë e fshehura, i konsolidon ato, si dhe arrin që t'i zgjojë forcat e përgjumura dhe të heshtura që gjenden brenda nesh.

Nëse meditojmë rreth arritjeve të civilizimeve të mëdha përgjatë historisë ne do të kuptojmë se tërë ato arritje janë meritë e

vullnetit dhe e këmbënguljes. Pa to nuk do të mund të arrinin pothuajse asgjë, pavarësisht diturisë apo inteligjencies, sepse bota është e mbushur plot me njerëz gjenialë, por dështakë në veprimtaritë e tyre; të shkolluar, por të papunë. Që ta kuptojmë këtë më mirë do të shërbehemi me një shembull. Nëse një njeri vuan nga një sëmundje e rënde dhe afër shtëpisë së tij ekziston një qendër mjekësore moderne, e cila ofron shërbime falas, dhe atë zakonisht e frekuentojnë ata që lëngojnë prej të njëjtës sëmundje, dhe ai e refuzon këtë përkujdesje shëndetësore me apo pa arsye, atëherë si do të jetë rezultati? Të gjitha mundësitë mjekësore që mund të shfrytëzohen, do të konsiderohen të padobishme për të, pra, sikur të mos ekzistonin fare. Mirëpo, nëse kemi një të sëmurë tjetër, i cili vuan prej ndonjë sëmundjeje të rëndë dhe zotëron vullnet të hekurt për t'u shëruar, mirëpo nuk i ka kushtet, ai do të drejtohet në të katër anët, do të trokasë në të gjitha dyert dhe në fund me ndihmën e Zotit do të gjejë përkrahje dhe mbështetje për të arritur atë trajtim që e kishte si qëllim.

Nëse kemi parasysh diferencën ndërmjet njerëzve në çështjen e suksesit dhe arritjes në të gjitha lëmit do të vërejmë se kjo diferencë ndodh pikërisht në saje të vullnetit të njerëzve, e jo për arsye të diferencës së mundësive dhe potencialit të tyre. Sidoqoftë ky përkufizim i përket aspektit të përgjithshëm dhe shumicës së rasteve. Ekziston një numër jashtëzakonisht i madh të

rinjsh dhe të rejash, që nuk kanë kurrfarë problemi në leximin e një libri në muaj, ashtu siç ka edhe të atillë që mund t'i lexojnë nga 10 faqe të Kuranit në ditë, mirëpo fatkeqësisht të paktë janë në numër ata që bëjnë gjëra tilla. Këta lloj njerëzish që arrijnë t'i bëjnë këto zotërojnë vullnet të lartë për të vepruar.

Nisur nga kjo mund të konkludojmë se kriza reale prej së cilës vuajnë muslimanët sot në shumë fusha të ndryshme civilizuese, si në aspektin e mbrojtjes nga komplotet e armiqve, të çlirimit të vendeve të pushtuara etj., është mungesë e vullnetit e jo e mundësive. Mirëpo njerëzve nuk u pëlqen ta pranojnë, se nuk dëshirojnë të lexojnë ose t'i zmrapsin kurthet dhe komplotet e kundërshtarëve, por shërbejnë me arsyetimin se nuk zotërojnë forcë dhe mundësi. Ata veprojnë kështu se e dinë që deklarimi "nuk dëshirojnë" përbën një farë nënçmimi për ta dhe nënkupton pranimin e kapitullimit. Në anën tjetër, shprehja "nuk mundemi" është më e pranuar, sepse vë në pah opsionin e pamundësisë, ose të ndërhyrjes së elementeve të jashtme, të cilat në të shumtën e rasteve është e pamundur që t'u bëhet ballë. Një kamuflim të tillë e bënë edhe hipokritët, të cilët nuk morën pjesë në betejën e Tebukut me të Dërguarin, paqja dhe lavdërimi i Zotit qoftë për të, duke u arsyetuar se nuk kishin fuqi dhe mundësi: **"Dhe ata do të betohen në Allahun: 'Sikur të kishim mundur, me siguri do të dilnim bashkë me ju'; dhe kështu ata e shkatërrojnë vetveten; Allahu e di se ata janë gënjeshtarë."** (Teube; 42) dhe **"Sikur ata të kishin dashur të dilnin me ty, do të ishin përgatitur."** (Teube; 46)

Njëra prej mënyrave të shprehjes së mëshirës së Allahut është mundësia e njeriut për ta ngritur dhe fuqizuar vullnetin. Kjo mundësi është shumë më e madhe se aftësia për t'i ndezur potencialet e tjera që ka, e po ashtu edhe më e madhe se sa fuqia për të përmirësuar ambientin, kushtet dhe

rrethanat në të cilat gjendet. Është shumë e qartë gjithashtu se forcimi i vullnetit do të thotë futja në luftë të brendshme me vetveten, kur njeriu duhet të ndalet para joshjeve dhe pasioneve të ndryshme, duhet t'u bëjë ballë disa veseve, shprehive dhe epsheve të ulëta. Kjo është e lehtë vetëm për atë që ia lehtëson Allahu. Prandaj çdo shoqëri përcakton për pjesëtarët e saj një interes të përbashkët të ngritur mbi një vullnet të caktuar, derisa ai është i dobishëm për të. Shoqëria këtë nivel të vullnetit e ndërton duke u motivuar me besim, bindje, parime dhe aspirata të saj.

Bazuar në këtë konkluzion vërejmë se një shoqëri, e cila i kushton rëndësi namazit me xhemat, kërkimit të diturisë, pamjes së jashtme dhe dekorit ose ushqimit dhe pirjes e ndërton interesin dhe vullnetin e pjesëtarëve të saj rreth këtyre gjërave, në harmoni me standardet dhe kriteret që lidhen me to. Këto i bëjnë pjesëtarët e tyre, që të punojnë për realizimin e tyre, pa ndonjë barrë dhe pengesë të theksuar. Kjo nënkupton se fuqia e vullnetit është prodhim i shoqërisë dhe i ngjason kontributit, që ajo u dhuron bijve të saj varësisht prej pjesëmarrjes së tyre në të.

Kjo na vetëdijeson për diçka shumë të rëndësishme, që të shprehim interesim të jashtëzakonshëm në përzgjedhjen e një ambienti të shëndoshë dhe të arsimuar për të jetuar në të, sepse jeta në kësi lloj ambienti i jep njeriut fuqi shtesë në orientimin e suksesit në këtë botë dhe shpëtimit në botën tjetër. Neve na bëhet më i qartë ky koncept sa herë që meditojmë për shpërblimin e madh që Allahu e ka rezervuar për besimtarët, të cilët migruan nga Meka në Medinë (para çlirimit të saj) dhe paralajmërimeve që ekzistojnë në thënie të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, për jetesën në vendet e kufrit, përveç në raste përjashtuese që kanë përmendur dijetarët e Islamit. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“FORMA E NAMAZIT E TË DËRGUARIT

sal-lallahu alejhi ue selem
E PËRSHKRUAR PREJ FILLIMIT DERI NË MBARIM
SIKURSE TË ISHIT DUKE E PARË”



Nuk është e mundur ta kryejmë namazin si duhet, e as t'i afrohem atij, përderisa nuk e dimë formën e hollësishme të namazit të të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem, duke i përfshirë gjërat thelbësore, mënyrat, format, lutjet (duatë) dhe përkujtimet (dhikret) e tij

SHKRUAN: SEDAT SHABANI

Kam nderin që në këtë numër të revistës të paraqes librin e mirënjohur të alimit të madh dhe të shquar, muhadithit shqiptar shejh **Muhamed Nasirudin el Albani**, Zoti e mëshiroftë. Shtëpia botuese “Nun” kësaj radhe boton për herë të tretë librin “**Forma e namazit**”, ku botimi i parë ka qenë një version i shkurtuar i librit, e më vonë edhe versionin e plotë të librit, së bashku me hyrjen e shejh Albanit.

Muhamed Nasirudin Albani u lind në Shkodër në vitin **1914** (apo 1333 h), kurse vdiq me **02.10.1999** në moshën tetëdhjetë e gjashtë vjeçare në Aman, Jordani ku edhe u varros. Ky dijetar ka lënë pas vetes mbi 200 vepra, disa në vëllime e disa në fleta, prej tyre janë botuar 70 sosh. Prej më të njohurave dhe më të rëndësishmeve janë: 1- “Silsiletu ehadithi sahiha” (Vargu i haditheve të sakta) në shtatë vëllime, 2- “Silsiletu ehadithi zaife” (Vargu i haditheve të dobëta) në katërmëdhjetë vëllime, 3- “Irvaul galil” (Freski për të eturin)

në tetë vëllime, 4- “Muhtesaru Sahihul Buhari” (Version i shkurtuar i Sahihul Buhari) në katër vëllime, 5- “Përmbledhja e fetvave dhe ligjëratave të tij” në më shumë se tridhjetë vëllime, dhe shumë të tjera. Një prej punëve të mëdha që ka përfunduar ky dijetar është përpunimi i tij i veçantë me “Katër Përmbledhjet e mëdha të Suneneve”, të cilat konsiderohen prej librave bazë më të rëndësishëm të Islamit, si Suneni i Nesaiut, i Ebu Davudit, i Tirmidhiut dhe i Ibën Maxhes; të cilat i ka klasifikuar në hadithe autentike dhe jo autentike. Prej veprave të tija të përshtatura në gjuhën shqipe janë: “Forma e Namazit”, “Mbulesa”, “Namazi i teravive”, “Dexhalli”, “Xhenazja, ritet dhe bidatet”, “Bidatet e Xhumasë”, “Rregullat e fejesës dhe martesës”, “Paralajmërimi i Falësit” dhe të tjera.

Çfarë kanë thënë dijetarët e tjerë për shejh Albanin:

1- **Ibën Bazi**, Allahu e mëshiroftë (ish-myftiu i Arabisë Saudite) ka thënë: “Në këtë kohë, nuk kam parë nën këtë qiell dijetar të hadithit sikurse eruditi Muhamed Nasirudin

Albani”. Po ashtu ka thënë: “Nuk njoh njeri në kupolën e orbitës më të dijshtëm se Shejh Nasiri”. Kur është pyetur Ibën Bazi për hadithin pejgamberik: *“Me të vërtetë Allahu këtij umeti në krye të çdo njëqind vjetëve i dërgon dikë që ia ripërtërin atij fenë”*.¹ Kush është ripërtëritësi i këtij shekulli? Ibën Bazi u përgjigj: “Sipas mendimit tim, hoxhë Muhamed Nasirudin Albani është ripërtëritësi i këtij shekulli, Allahu e di më së miri”.

2- Kurse fekihi i madh, **Ibën Uthejmini**, rahimehullah, ka thënë: “Albani rahimehullah, është një prej dijetarëve të Sunetit, mbrojtës i tij, prijës në hadith, dhe për kohën tonë nuk dimë që dikush t’ia dalë atij, mirëpo disa njerëz –Allahu na ruajt-, që në zemrat e tyre kanë zili, kur shohin dikë se pranohet nga të gjithë, nga zilia flasin keq për të, ashtu siç veprojnë mynafikët, të cilët tallen me besimtarët që japin lëmoshë vullnetarisht...”. Dhe ka thënë: “Njeri me horizont të gjerë, studiues i madh, bindës i madh në debate”. Dhe ka thënë: “Shumë i kujdesshëm në praktikimin e Sunetit dhe luftimin e bidatit, qoftë në besim apo në vepra”.

3- Kurse Ministri për çështjet islame dhe vakëfet i Arabisë Saudite, **Salih Alu Shejh** ka thënë: “Nuk ka dyshim se vdekja e dijetarit të madh, Shejh Nasirudin Albanit, është një fatkeqësi, sepse ai është një prej kolosëve të umetit dhe muhadithi i tij. Allahu i Lartmadhëruar me ta e ka ruajtur këtë fe, dhe me ta e ka përhapur Sunetin”.

Libri: **Forma e namazit e të Dërguarit**, sal-lallahu alejhi ue selem, **e përshkruar prej fillimit deri në mbarim sikurse të ishit duke e parë**

Të nderuar lexues në prezantimin e këtij libri të begatshëm dua që të citoj sa më shumë vetë autorin e librit shejhun tonë, pasi njëra nga veçoritë e selefit në shkrimin e librave

“...Ibën Bazi u përgjigj: “Sipas mendimit tim, hoxhë Muhamed Nasirudin Albani është ripërtëritësi i këtij shekulli, Allahu e di më së miri” ...”

ka qenë, se ata pikërisht qysh në hyrje kanë shtjelluar metodologjinë dhe përmes hyrjes së librit ata kanë dhënë porosinë e tyre umetit, rrugën dhe mënyrën e tyre në shkrimin e veprës. Shejhu jonë ka qenë në këtë i përpiktë dhe këtë e ka praktikuar kështu që shpesh shohim se hyrjet në librat e tij janë me më shumë faqe, e cila gjë përsëritet edhe me “Formën e namazit”, ku hyrja ka 34 faqe gjegjësisht një e pesta e librit. Vlen të përmendet se shejhu librin “Forma e namazit” e shkroi në vitin **1946** menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në kohën kur komunizmi fillon të okupojë tokat muslimane të Ballkanit dhe botës në përgjithësi. Në atë kohë shejhu ishte rreth **33** vjeç.

Çfarë e shtyu shejhun në shkrimin e këtij libri?

Shejhu shkruan: “Kur e kreu leximin e “Kapitullit të Namazit” në “Et Tergib uet Terhib”¹ nga Hafëz Mundhiriu, rahimehullah, dhe shpjegimin e tij vëllezërve tanë para katër vitesh na u bë e qartë të gjithëve pozita e rëndësishme e namazit në Islam; dhe shpërblimi, mëshira e respekti që i pret ata të cilët zbatojnë dhe e kryejnë siç duhet; dhe se tërë kjo ndryshon varësisht nga afërsia me namazin e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem. Është kjo për të cilën ai na e bën me dije në thënien e tij: *“Me të vërtetë, robi fal një namaz nga i cili nuk i shkruhet asgjë, përveçse një e dhjeta, e nënta, e teta, e shtata, e gjashta, e pesta, e katërta, e treta, ose*

¹ Në shqip mund ta gesh me titullin “Inkurajimi dhe kërcënimi” botuar nga Gjurma, Prishtinë.

gjysma e tij". Prandaj ua tërhoqa vërejtjen vëllezërve, se nuk është e mundur ta kryejmë namazin si duhet, e as t'i afrohemi atij, përderisa nuk e dimë formën e hollësishme të namazit të të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem, duke i përfshirë gjërat thelbësore, mënyrat, format, lutjet (duatë) dhe përkujtimet (dhikret) e tij, dhe kur të mundohemi atëherë që këtë dije ta zbatojmë në praktikë me kujdes, vetëm atëherë mund të shpresojmë që namazi ynë do të na ndalojë nga veprat e turpshme e të këqija, dhe se shpërblimi dhe bekimi i përmendur në transmetime do të shkruhet për ne."

Metodologjia e këtij libri

Shejhu në shkrimin e librit i është përmbajtur vetëm haditheve të vërteta dhe medhhebit të muhadithinëve, ku edhe përmend: "Kam dhënë vetëm atë që në mënyrë autentike është dëshmuar prej tij, sal-lallahu alejhi ue selem, siç edhe ka qenë gjithmonë drejtimi i dijetarëve të hadithit, si i të mëparshmëve ashtu edhe i të mëvonshmëve, siç flet kjo thënie e bukur:

"Njerëzit e hadithit janë Njerëzit e të Dërguarit,

*edhe pse nuk e shoqërojnë atë,
në çdo moment janë me të."*

Kështu, ky libër me Dëshirën e Allahut do të përmbledhë tërë atë që është e shpërndarë në librat e hadithit dhe të fikhut, pa marrë parasysh dallimet mes medhhebeve, mirëpo që ka të bëjë me temën tonë, kështu që përfundimet e sakta në këtë libër nuk do të mund të gjendeshin ashtu të plota në asnjë libër dhe në asnjë medhheb. Mirëpo ky menhexh, rrugë apo metodologji shejhun e bëri të urryer dhe temë polemikash të shumta në shumë vende arabe dhe joarabe, shumë hoxhallarë dhe universitete e kundërshtuan me ashpërsi metodologjinë e tij, duke e etiketuar me lloj-lloj "izmach" pasi bash në

“Ky menhexh, rrugë apo metodologji shejhun e bëri të urryer dhe temë polemikash të shumta në shumë vende arabe dhe joarabe, shumë hoxhallarë dhe universitete e kundërshtuan me ashpërsi metodologjinë e tij, duke e etiketuar me lloj-lloj “izmach...”

vitin 1946 të ngjallësh Sunetin e Resulullahut sal-lallahu alejhi ue selem, në popujt e rraskapitur nga kolonistët e ndryshëm dhe fillimin e komunizmit të ashpër ishte shumë e rëndë të kuptonin dhe t'i hapnin dyert frymës së Sunetit të pastër. Djaloshi shkodran asokohe tridhjetëvjeçar nuk u përul, por me një vendosmëri të rrallë u zhyt në fletët e zverdhura të librave të pluhurosura të bibliotekave dhe me saktësinë e profesionit të tij të mëparshëm (orëndreqësit) u hyri një nga një misionit të zbardhjes së të vërtetave dhe të rrejtshmeve të shumë transmetimeve shekull pas shekulli, që ishin të palosura nëpër raftet e shumta të muslimanëve. Këtë mision me ndihmën e Allahut shejhu e kreu me besnikëri, asgjë nuk e tundi dhe nuk e theu në shtegtimin e tij drejt dëlirjes dhe edukimit (tesfijeh ue terbijeh), që ishte edhe motoja e tij e preferuar dhe rruga e tij në davet.

Shejhu tregon: "Kur i përvetësova këto parime, d.m.th., t'i përmbahem Sunetit autentik dhe t'i zbatoj në këtë libër, si dhe në të tjerët, e dita se me siguri kjo nuk do të kënaqte çdo grup njerëzish apo sekt, në të vërtetë do të rezultonte që disa, në mos shumica e tyre, të më fyejnë me gjuhën e tyre,

ose të më kritikojnë me lapsat e tyre. Kjo nuk më brengos, sepse unë gjithashtu e di se t'i kënaqësh të gjithë është nocion i paarritshëm, dhe *“Ai që e hidhëron Allahu duke i kënaqur të tjerët, Allahu do ta lërë atë në mëshirën e njerëzve”*, siç ka thënë i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ue selem. Allahu e shpërbleftë autorin e vargjeve që pasojnë:

*Kurrë nuk do të mund t'u shpëtoj fyerjeve,
Edhe sikur të isha brenda në shpellë, në
malet shkëmbore;*

*Ngase askush nuk mund të shpëtojë nga
njerëzit i palënduar,*

*Edhe po qe se fshihet pas krahëve të
shqiponjës?*

Më mjafton mua, se unë besoj që kjo është rruga më e drejtë, në të cilën Allahu i ka urdhëruar besimtarët ta ndjekin; dhe që i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, Zotëria i të Dërguarve e ka shpjeguar. Kjo është rruga që kanë hapur Paraardhësit e Devotshëm (selefus salih): sahabët, trashëgimtarët e tyre dhe ata pas tyre, duke përfshirë edhe katër imamët e medhhebeve, të cilëve shumica e muslimanëve sot iu përkasin. Të gjithë ata janë pajtuar për domosdoshmërinë e pasimit të Sunetit dhe të referimit në të; për mospërfilljen e çdo mendimi që është në kundërshtim me të, pa marrë parasysh pozitën e lartë të proklamuesit të atij mendimi, sepse statusi i Lajmëtarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ue selem, është shumë më i madh dhe rruga e udhëzimit të tij më e drejtë. Prandaj kam ecur hapave të tyre dhe kam zbatuar urdhrat e tyre për t'u kapur pas haditheve, edhe nëse kjo kundërshton pikëpamjet e tyre.

Libri “Forma e namazit” dhe ndikimi i tij te shqiptarët

Me librin **“Forma e namazit”** të shejh Albanit jemi njohur qysh në mesin e viteve tetëdhjetë, kur ende lexonim fshehurazi literaturën islame nga droja e pushtetit

komunist të atëhershëm. Në Kosovë gjeësisht në Pejë ishte një hoxhë që i kishte kryer studimet në Kajro dhe në derset e tij shpjegonte **“Formën e namazit”**, unë dhe të tjerët, që nuk kishim mundësi të merrnim pjesë në derset e tij me padurim pritnim vëllezërit tanë më të mëdhenj, kur vinin prej atje dhe sikurse pikat e ujit në nxehtësinë e shkretëtirës na vinin hadithet dhe mësimet e shejh Albanit, se si ishte falur i Dërguari jonë sal-lallahu alejhi ue selem, si duhet të praktikojmë Sunetin e Resulullahut sal-lallahu alejhi ue selem në namaz dhe në ibadetet e tjera. Kjo ishte në atë kohë shumë pak në krahësim me atë që kemi sot, por ishte shumë e madhe pasi me këto pika filloi daveti dhe thirrja islame tek ne dhe dita-ditës vetëm vinin dhe shtoheshin safat nëpër xhami me rini të etshme për praktikimin e Sunetit dhe dashurinë ndaj Fesë. Allahu e shpërbleftë shejhun tonë për mundin që ka dhënë në këtë libër dhe të tjerët në përgjithësi, posaçërisht në edukimin dhe udhëzimin e studentëve të shumtë shqiptarë në njohjen e Sunetit, prandaj Shtëpia jone botuese me krenari të veçantë boton librat e tij dhe me këtë dëshirojmë afrimin tone tek Allahu i Madhërishëm. E njoftojmë lexuesin, se botimi i radhës së këtij libri përveç ndërrimit të dizajnit të kopertinës, do të bëjë transliterimin e lutjeve te namazit për t'ia lehtësuar lexuesit shqiptar që t'i mësojë sa më lehtë ato nga libri dhe t'i praktikojë në namazin e tij. Falënderojmë Allahun që na e mundësoi ribotimin e librit, po ashtu Allahu e shpërbleftë përkthyesin e vyer dhe redaktorët e zellshëm, të cilët kontribuan në daljen sa më cilësor të këtij libri të bekuar. ■

“ÇËSHTJA E GRUAS” PROBLEM QË NUK EKZISTON

Nuk njihet në historinë e muslimanëve gjatë gjithë historisë së këtij umeti problemi me emrin “çështja e gruas”, qoftë kjo në kohët e lavdisë dhe krenarisë së tij, apo dobësisë dhe thyerjes. Por kur Perëndimi dhe zëdhënësit e tyre i përcollën sëmundjet dhe dhimbjet e tyre tek të gjithë popujt, -bashkë me ta dhe muslimanët-, u shfaq ajo që njihet me emrin “çështja e gruas” duke trumbetuar për emancipimin (lirimin) e saj në shumicën e bashkësive islame me kuptimin laik dhe perëndimor të emancipimit.

DR. IBRAHIM NASIR

Ndaj në lidhje me këtë do të sqarojmë këtu disa baza të Sheriatit, të cilat janë gjykuese në lidhje me këtë çështje:

Gruaja është njëra pjesë e racës njerëzore. Allahu thotë: **“Dhe Ai (Allahu) është që krijon palët: mashkullin dhe femrën,...”**¹ Dhe ajo është njëra pjesë e vetvetes. Allahu thotë: **“O njerëz! Jini të bindur (dhe mbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi ju prej një vete (Ademit) dhe nga ajo Ai krijoi palën (bashkëshorten) e saj,...”**² Kështu ajo është shoku i burrit në origjinë, zanafillë dhe përfundim. Ajo është ortak me të në ndërtimin e gjithësisë, -çdokush në sferën që i përshtatet- pa dallim mes tyre në aspektin e përgjithshëm të fesë, në njësimit dhe besimit, shpërblim dhe dënim, si dhe në aspektin e përgjithshëm të legjislacioneve rreth të drejtave dhe detyrave. Allahu thotë: **“Kushdo që punon të drejtën e të mirën, burrë a grua qoftë, duke qenë besimtar i vërtetë, sigurisht që Ne do t’i dhurojmë atij jetë të mirë (në këtë**

botë duke qenë i respektuar e i kënaqur dhe furnizim e jetesë sipas Ligjit të Allahut) **dhe (në Botën Tjetër) Ne do t’ua paguajmë padyshim atyre shpërblimin sipas veprave të tyre më të mira që ata i kanë punuar.”**³ Ndërsa Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Gratë janë partnerët e burrave.”**⁴ Duke u nisur nga kjo, Allahu vendosi që peshorja e nderimit tek Ai të jetë devotshmëria. I Lartësuari thotë: **“Padyshim**



¹ Nexhm, 45.

² Nisa, 1.

³ Nahl, 97.

⁴ Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.

“Si shkak i këtij ndryshimi në krijimin mes dy gjinive janë të varura një sërë dispozitash dhe ky ndryshim ka shkaktuar –me urtësinë e plotë të Allahut, të Gjithëditurit, të Gjithëinformuarit-, dallueshmëri mes tyre në disa dispozita të Sheriatit...”

*se tek Allahu më i nderuari prej jush është ai që është më i devotshmi.”*⁵ Nuk mund të gjesh diçka më me vend dhe më të saktë për të shprehur diçka të tillë se shprehja **“Ju jeni** (pjesëtarë të barabartë) **prej njëri-tjetrit.”** Në fjalën e Allahut: **“Në këtë mënyrë Zoti i tyre e pranoi prej tyre** (duanë e tyre dhe iu

përgjigj atyre): **“Unë kurrë nuk do të lejoj që të humbasë vepra e kujtdo prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni** (pjesëtarë të barabartë) **prej njëri-tjetrit.”**⁶ Kështu ata janë të njëjtë në aspektin e përgjithshëm të fesë dhe të Sheriatit, si dhe në peshoren e Allahut.

Ka dashur Krijuesi me Urtësinë e Tij që burri të mos jetë si gruaja në cilësinë e krijimit, cilësi dhe ndërtim, kështu që si pasojë e këtij ndryshimi në krijim, ndodh edhe ndryshimi në forcën dhe aftësitë trupore, ndjeshmëri dhe dëshira. Allahu i Madhëruar thotë për burrin: **“...dhe djali nuk është si vajza”**⁷. Ndërsa për gruan ka thënë: **“(A duan ata për Allahun) një krijesë e cila rritet në zbukurime** (duke veshur mëndafsh e stoli ari, d.m.th. femra) **dhe e cila në ndonjë mosmarrëveshje nuk mund ta mbulojë vetveten, edhe po të jetë e pastër?”**⁸

Në këtë mënyrë si shkak i këtij ndryshimi në krijimin mes dy gjinive janë të varura një sërë dispozitash dhe ky ndryshim ka shkaktuar –me urtësinë e plotë të Allahut, të Gjithëditurit, të Gjithëinformuarit-, dallueshmëri mes tyre në disa dispozita të Sheriatit, si dhe në funksionet dhe detyrat, të cilat i përshtaten cilësive të çdonjërit prej tyre. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Padyshim që i Tij është Krijimi dhe Komandimi. I Shenjtëruar dhe i Lartësuar qoftë Allahu, Zoti i të gjithë botëve.”**⁹ Kështu që ajo është dëshira ekzistuese dhe përcaktuese e Allahut në krijim dhe ekzistencë dhe kjo është dëshira e Tij legislative dhe ligjvënëse në çështjen e dispozitave dhe të drejtimit. Ndaj mund të themi se janë takuar dy dëshirat në çështjet e burrit dhe gruas, në lidhje me dobitë

⁵ Huxhurat, 13.

⁶ Ali Imran, 195.

⁷ Ali Imran, 36.

⁸ Zuhruf, 18.

⁹ Araf, 54.



krijuese, ndërtimin e universit dhe rregullsinë e jetës së individit dhe shoqërisë.

Janë vendosur si pasojë e këtij realiteti, dispozita tërësore të Sheriatit, të cilat janë po aq të pandryshueshme sa pandryshueshmëria e këtij realiteti, prej tyre janë: dispozitat e familjes. Në Islam, familja është bashkimi i ndërtimit të shoqërisë, mbi forcën dhe bashkimin e saj është i ndërtuar siguri dhe mirëqenia e shoqërisë.

Familja në Islam synon plotësimin e qëllimeve të saj duke shkëmbyer qetësinë, mëshirën dhe dashurinë mes pjesëtarëve të saj. I Lartësuarit thotë: ***“Dhe nga Treguesit e Tij është se Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) në mesin tuaj, që ju të mund të gjeni prehje tek ato dhe Ai vendosi mes jush dhembshuri e mëshirë.”***¹⁰

Kështu gruaja ka rolin kryesor në forcimin e familjes dhe lidhjen e saj, ndaj çdo çrregullim që vjen nga gruaja në kryerjen e rolit të saj ndaj familjes, reflektohet një gjë e tillë negativisht tek pjesëtarët e tjerë të familjes. Shoqëria e shëndoshë qëndron e palëkundur në përplasjen me marrëzitë e injorancës bashkëkohore, të cilat e nënvleftësojnë rolin e gruas në familje, apo rëndësinë e përgjegjësisë që ajo ka kundrejt saj, e cila është puna më e vlefshme që mund të kryejë gruaja në shërbim të interesit të familjes dhe të shoqërisë.

Sikurse në të kundërt, burrit i kërkohet që të përballojë vështirësitë e kujdestarisë, detyrë kjo të cilën ia ka ngarkuar Sheriati i nderuar. I Lartësuarit thotë: ***“Burrat janë mbrojtësit dhe mbajtësit e grave, sepse Allahu e ka krijuar njërin palë prej tyre të shquhet mbi tjetrën, e edhe sepse ata shpenzojnë*** (për t'i mbajtur ato) ***nga mjetet***

“...Nëse të dy gjinitë ndryshojnë në cilësitë organike, energjike dhe psikologjike, atëherë patjetër që do të kenë dallime në funksionet shoqërore ...”

e tyre të jetesës.”Nisa, 34. Ndërsa në një ajet tjetër thotë: ***“Dhe ato kanë të drejta (mbi burrat e tyre për shpenzimet, për jetesën, për pasurinë) të barabarta (me të drejtat e burrave) mbi ta në atë shkallë që është e arsyeshme, por burrat kanë një shkallë më tepër mbi to.”***¹¹

Kujdestaria në këtë kontekst, d.m.th: drejtimi i një shoqërie të vogël –familja-, me të cilën është nderuar burri duke mos qenë i komanduar apo i shtypur për diçka të tillë, sikurse një gjë e tillë është edhe në dobinë e gruas, shtëpisë dhe familjes, sepse përgjegjësia e shpenzimit për të, kërkimi i furnizimit dhe ruajtja e kujdesi janë detyrë për burrin, ndaj dhe ai meriton bindjen, e cila është nga veçoritë e drejtuesit, duke e ditur se kjo bindje është në të mira dhe nuk është e përgjithshme, sikurse ka thënë Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem): ***“Vërtet bindja është në të mira.”***¹²

Burri është i detyruar të shpenzojë për gruan dhe ky shpenzim është e drejtë e gruas dhe pjesë e përcaktuar në pasurinë e tij. Kështu që nuk lejohet anashkalimi dhe lënia e saj, kur njeriu është i mundshëm ta bëjë diçka të tillë. Allahu thotë: ***“I pasuri le të shpenzojë sipas pasurisë së tij dhe ai, burimet e të cilit janë të kufizuara, le të shpenzojë sipas asaj që atij i ka dhënë***

¹⁰ Rrum, 21..

¹¹ Bekare, 228.

¹² Buhariu dhe Muslimi.

Allahu. Allahu nuk rëndon kënd përmbi atë që Ai i ka dhënë atij. Allahu do të sigurojë pas vështirësisë, lehtësi.”¹³ Kjo e drejtë nuk ka lidhje me të drejtën e saj për të zotëruar pasuri dhe përdorimin e tij për interesa të saj, përmes dëshirës dhe kujdesit të saj të pavarur sikurse burri. Kjo e drejtë është e pazëvendësueshme -dhe e prerë-, në Sheriatin e pastër. Kështu që nëse injoranca bashkëkohore e konsideron gruan të mangët në aftësinë e saj për përvetësimin e pasurisë dhe përdorimin e saj, deri pothuajse në gjysmën e dytë të shekullit njëzetë -sikurse gjendet në ligjet latine-, në të kundërtën, gruaja në Islam konsiderohet person me aftësi dhe juridiksion të plotë në këtë fushë, duke mos pasur ndryshim nga burri.

Marrëdhëniet midis burrit dhe gruas në shoqërinë islame dhe brenda familjes ndërtohen në bazën e plotësimit mes funksioneve të tyre -ose siç quhet ndryshe plotësimi funksional-, nga qëllimet e të cilit është: gjetja e qetësisë dhe e prehjes për burrin dhe dashurisë e mëshirës mes tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe nga Treguesit e Tij është se Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) në mesin tuaj, që ju të mund të gjeni prehje tek ato dhe Ai vendosi mes jush dhembshuri e mëshirë.”**¹⁴ Në gjuhën arabe nuk ka shprehje më të saktë se “prehje” dhe ndoshta e njëjta gjë është dhe për gjuhët e tjera, ku ajo përmban një sërë kuptimesh, prej tyre: qetësi, mëshirë, siguri dhe miqësi, gjë e cila jep pasoja pozitive tek fëmijët e më pas edhe tek e gjithë shoqëria. Kështu që nëse të dy gjinitë ndryshojnë në cilësitë organike, energjike dhe psikologjike, atëherë patjetër që do të kenë dallime në funksionet shoqërore dhe integrimin mes dy gjinive në përgjegjësitë

dhe të drejtat e tyre, dhe nuk ka dyshim se ky është fryti i drejtësisë në të cilin janë ndërtuar lidhjet dhe marrëdhëniet në Islam.

Duke u nisur nga ky aspekt Sheriati e ka caktuar sferën e veprimtarisë së burrit në këtë jetë dhe karakteret e saj, sikurse e ka caktuar dhe sferën e veprimtarisë së gruas, bazën dhe karakteret e saj, kështu që e gjen atë të përshtatshëm në atë mënyrë që e pranojnë mendjet e shëndosha dhe natyrshmëria e pastër, gjë me të cilën ndodh plotësimi, ekuilibri dhe siguria shoqërore duke mos bartur askush prej tyre më tepër se sa i takon, gjë kjo që përkon me natyrën dhe zakonet.

Ndaj dhe konsiderohet padrejtësi dhe krim që gruaja të bartë barrën e burrit duke mos pasur nevoja personale apo shoqërore, sepse një gjë e tillë pasqyron agresion ndaj drejtësisë në të drejtat dhe detyrat e tyre, sikurse në të njëjtën kohë pasqyron dhe agresionin ndaj dinjitetit të gruas dhe femërores së saj.

Qartësia në caktimin e rolit të gruas në jetë, sigurisht që të orienton për arsimimin e saj, ndaj dhe theksojmë këtu, se arsimimi është detyrë e caktuar nga Sheriati, në ato çështje me të cilat nuk mund të plotësohet adhurimi i Allahut përveçse me to, si njohja e bazave të besimit, llojet e adhurimeve etj. Kjo është një sferë ku gruaja dhe burri janë të njëjtë. Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: **“Kërkimi i dijes është detyrë për çdo musliman.”**¹⁵ Kështu menjëherë mbas kësaj bëhen detyrë me radhë të gjitha njohuritë në saje të funksionit dhe të përgjegjësisë që ajo ka, dhe çdo njohuri tjetër shtesë është diçka vullnetare, dhe të cilat nuk duhet që të konkurrojnë me kërkesat dhe veprat jetësore dhe ato të ahiretit.

¹³ Talak, 7.

¹⁴ Rrum, 21.

¹⁵ Ibnu Maxhe.

Sheriati Islam –duke u përshtatur me natyrshmërinë dhe duke ruajtur drejtësinë- ka ruajtur për gruan disa të drejta shoqërore, rëndësia e të cilave ka epërsi shumë më të madhe, se të drejtat që përmban “karta e të drejtave të njeriut” e caktuar nga Kombet e Bashkuara, e cila është e ndërtuar mbi barazinë dhe ngjashmërinë. Por injoranca bashkëkohore tregohet indiferente nga këto të drejta dhe nuk i vë rëndësi atyre. Prej këtyre mund të përmendim:

E drejta e gruas në martesë sipas Sheriatit Islam, e drejta e saj për të qenë nënë dhe e drejta e saj që të ketë një shtëpi ku të jetë edukatore, e cila është mbretëria e vogël e saj, në atë mënyrë që i mundëson asaj kryerjen e detyrave, të cilat janë normale dhe që i përshtaten natyrshmërisë së saj. Ndaj çdo ligj, i cili shmang mundësitë e gruas për martesë, konsiderohet shkelje e të drejtave të saj dhe padrejtësi për të.

Gruaja -në Sheriatin Islam- ka të drejtë në zgjedhjen e bashkëshortit të saj, brenda kufijve të thënies së Profetit, sal-lallahu alejhi ue selem: “Nëse ju vjen dikush që jeni të kënaqur për fenë dhe moralin e tij, atëherë martojeni...”¹⁶ Sikurse në të njëjtën kohë ajo gëzon të drejtën që të mos qëndrojë me të –nëse jeta bashkëshortore nuk ecën ashtu siç duhet-. Tekstet që përcaktojnë një gjë të tillë janë të shumtë, të qartë dhe është detyrë kthimi tek ato në raste mosmarrëveshje dhe në dhënien e gjykimit rreth dispozitave të tilla.

Ndershmëria dhe ruajtja e saj është nga bazat tërësore të Sheriatit, e cila ka ardhur për ruajtjen e pesë gjërave të domosdoshme, në konsiderimin e të cilave ka një pajtueshmëri të plotë dhe tek të cilat kthehen të gjitha dispozitat e Sheriatit, dhe

“Çdo cenim që i bëhet principit të nderit, sigurisht që është luftë ndaj Sheriatit dhe bazave të tij, njëkohësisht dhe shkelje e të drejtave të gruas, të burrit, familjes dhe të gjithë shoqërisë...”

këto janë: ruajtja e fesë, jetës, nderit, logjikës (mendjes) dhe ruajtja e pasurisë. Çdo cenim që i bëhet principit të nderit, sigurisht që është luftë ndaj Sheriatit dhe bazave të tij, njëkohësisht dhe shkelje e të drejtave të gruas, të burrit, familjes dhe të gjithë shoqërisë, sikurse në të njëjtën kohë është dhe përhapje e poshtërsive mes besimtarëve. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Sigurisht ata që duan që marrëdhëniet e paligjshme imorale të përhapen mes besimtarëve, do të kenë dënim të dhimbshëm në këtë botë dhe në Botën e Pastajme dhe Allahu di atë që ju nuk e dini.”**¹⁷

Duke u nisur nga kjo, I Urti dhe I Gjithëinformuari vendosi dispozita për ruajtjen e këtij principi, kështu që urdhëroi për martesën dhe i dha rëndësi të madhe asaj, sikurse e konsideroi aktin e saj një besë të fortë, ku thotë në fjalën e Tij: **“...dhe në të njëjtën kohë ato kanë marrë prej jush besë të fortë e të shenjtë?”**¹⁸

Po ashtu për të ruajtur nëpërkëmbjen dhe shkeljen e këtij principi, ndaloi imoralitetin për të dyja gjinitë –si për burrat dhe gratë njësoj- dhe e konsideroi një gjë të tillë, si ligësi dhe poshtërsi: **“Dhe mos iu**

¹⁶ Ibnu Maxhe.

¹⁷ Nur, 19.

¹⁸ Nisa, 21.

afroni marrëdhënieve të paligjshme (zinasë). ***Padyschim që ajo është ligësi*** (kalim i kufijve, poshtërsi) ***dhe rrugë e keqe.***"¹⁹ Gjithashtu i mbylli rrugët, të cilat të afrojnë drejt saj, si vetmia mes dy gjinive, përzierjen e burrave me gratë, lajkatin në fjalë nga ana e gruas, si dhe u përqendrua në ndalimin rreth dëshirave për përhapjen e paturpësive në mesin e muslimanëve, duke urdhëruar kështu dispozitat e mbulesës për gruan dhe uljen e shikimit. Për po të njëjtin shkak, gjithashtu vendosi sanksione për ata që e cenon këtë princip, duke vendosur dënimin për imoralitetin, dënimin mbi shpifjen, etj., e gjithë kjo për të ruajtur virtytet dhe për rritur kujdesin ndaj nderit.

Mbulesa e gruas konsiderohet një prej mbrojtësve bazë, të cilat e ruajnë virtytin, nderin dhe turpin, po ashtu pengon dhe përhapjen e poshtërsive, dhe nga ana tjetër ajo është shenjë e krenarisë me dispozitat e Sheriatit, si dhe realizim i nderit të gruas, burrit dhe i të gjithë shoqërisë. Mbulesa nuk është diçka vullnetare, për të mos menduar se ajo është thjesht një simbol në të cilën gruaja mund të zgjedhë mes vendosjes apo jo të saj, por ajo është detyrë që Allahu ka vendosur për gratë; në mënyrë që t'i mbrojë ato dhe si shenjë për ndershmërinë e tyre, njësoj si shembujt e tyre prej nënave të besimtarëve, duke mos u lënë kështu vend dhe shans të prishurve dhe të pamoralshmëve, që të prekin nderin e tyre, sikurse ka thënë Allahu i Madhëruar: ***"O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua dhe bijave të tua edhe bashkëshorteve të besimtarëve të lëshojnë vellon*** (mbulesën) ***e tyre mbi gjithë trupin e tyre. Kjo do të ishte më e mirë, që ato të mund të dallohen*** (si gra të ndershme), ***që të mos i shqetësojë*** (e ngacmojë) ***askush. Dhe Allahu është gjithnjë Falës i Madh, gjithnjë Mëshirëplotë.***"²⁰

¹⁹ Isra, 32

²⁰ Ahzab, 59.

Në kohët tona ka filluar një luftë e qartë kundër mbulesës, nga armiqtë e kësaj Feje, si dhe nga ata që janë imoralë dhe duan që të bëjnë pazarllëqe e tregti me to -qofshin këta edhe prej muslimanëve të dobët-. Ndoshta kjo luftë ndonjëherë fshihet duke e pranuar mbulesën si të drejtë, duke shëmtuar realitetin e saj dhe konsiderimin e saj thjesht si një traditë, por trashëgimia (tradita) mund të evoluojë dhe reduktohet, gjë e cila më pas çon edhe në anulimin e qëllimeve të saj.

Ne kur të jemi në gjendje të kuptojmë rëndësinë e mbulesës dhe vlerat e saj, sigurisht që do të na largohet habia e kësaj lufte të ashpër ndaj mbulesës. Perëndimi -p.sh.- ka filluar që ta ngushtojë dhe ta kufizojë shumë konceptin e mbulesës, gjë të cilën nuk e bën me asnjë lloj veshje tjetër, e çdo lloj feje apo sekti tjetër, qoftë dhe pamjet e shembujt e mos dhënies së të drejtave të grave të mbuluara, qofshin këto kushtetuese apo në praktikën e përditshme, janë të qarta për të gjithë ata që e ndjekin këtë çështje, qoftë kjo në Perëndim -i cili pretendon se nga bazat e tij është mbrojtja dhe ruajtja e të drejtave individuale-, apo në disa shtete të botës islame, të cilat kanë adoptuar laicizmin si kushtetutë të tyre.

Islami me këto dispozita ka parë dobinë e të gjithë shoqërisë në përgjithësi, por në veçanti të gruas për ta vendosur atë në vendin që i takon. ■

(Shkëputur nga libri i autorit me titull: *"Karta e të drejtave të gruas dhe detyrat e saj në Islam"*)

Përktheu dhe përshtati: Bledar Haxhiu

PËRSE E ZGJODHA MBULESËN?!...

IVONE REDLAY, GAZETARE BRITANIKE

Shumë udhëheqës e gazetarë i kanë zbuluar shkrimet e tyre ndaj keqtrajtimit të gruas në Islam, duke mos biseduar, qoftë edhe një herë me gratë, të cilat mbajnë mbulesën... Thjeshtë ata nuk dinë fare për nderimin dhe përkrahjen me të cilat është begatuar femra në Fenë Islame qysh para 14 shekujve... gjithashtu ata shkruajnë për tema që nuk kanë lidhje me kulturën e shoqërisë, si p.sh.: martesë e hershme, vrasja për shkak të nderit, martesë me dhunë etj., çdo herë duke u shprehur në mënyrë arrogante, ku pretendojnë se Islami është përgjegjës për këto veprime, në një kohë kur dihet shumë mirë nga të gjithë, se këto gjëra nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me Islamin. U themi atyre: **Më falni**, ndaluni e mos i përziëni kulturën, traditat me udhëzimet e Islamit.

Më është kërkuar që të shkruaj për temën, se si ua lejon Islami burrave rrahjen e bashkëshorteve të tyre? Gjë që nuk është e vërtetë... Kritikuesit e Islamit e argumentojnë këtë gjë me ajete nga Kurani dhe hadithe, duke i marrë argumentet në mënyrë sipërfaqësore... nëse një burrë detyrohet të ngrejë dorë mbi gruan e tij, Islami ia ka ndaluar atij që të lërë gjurmë në trupin e saj, d.m.th.: Islami i thotë muslimanit në mënyrë indirekte të mos e rrah gruan e vet. Më lejoni t'ju paraqes disa statistika sipas të dhënave në SHBA në lidhje me dhunën në familje:

vetëm në periudhën kohore prej 12 muajsh, 4 milion femra amerikane janë keqtrajtuar me dhunë nga bashkëshortët e

Shpesh në të kaluarën i kam konsideruar gratë mbuluara me hixhab-mbulesë si krijesa të shtypura dhe të prapambetura, ndërsa tani i shikoj ato si femra me aftësi të larta dhe të respektuara. Lidhja mes femrave perëndimore është shumë e zbehtë në krahasim me lidhjen e fortë të femrave muslimane



tyre.

Më shumë se 3 femra vriten për çdo ditë nga bashkëshortët dhe dashnorët e tyre.

Rreth 5,500 femra janë keqtrajtuar deri në vdekje brenda 5 viteve 2001- 2006.

Ndoshta dikush mund të thotë se këto janë akuza të rënda, që po i adresoni ndaj një shoqërie të civilizuar siç është shoqëria amerikane, mirëpo unë ju them: Me të vërtetë dhuna ndaj femrave është dukuri ndërkombëtare, ata që e manifestojnë dhunën nuk do të thotë se i takojnë vetëm ndonjë feje apo kulture të caktuar...

Është e vërtetë e pamohueshme, se çdo tre femra në botë i nënshtrohen rrahjes, dhunës apo keqtrajtimit në formë të ndryshme gjatë jetës së tyre. Dhuna ndaj femrave është një çështje që nuk karakterizohet vetëm me një fe, shtresë shoqërore, racë apo kulturë. Femrat para ardhjes së Islamit trajtoheshin si krijesa të ulëta pa vlerë, ndërsa sot në botën perëndimore femrat akoma përballen me probleme të ndryshme; ku burrat mendojnë se janë më të privilegjuar, se sa gratë duke u vërejtur qartë në sistemin e jetesës si

“Dhuna ndaj femrave është dukuri ndërkombëtare, ata që e manifestojnë dhunën nuk do të thotë se i takojnë vetëm ndonjë feje apo kulture të caktuar...”

punësimit, rrogat në të gjitha sektorët, duke filluar nga pastrueset e deri tek ato që synojnë poste të larta nën ombrellën e “barazisë gjinore”.

Ende femra perëndimore vazhdon të trajtohet sikur të jetë prodhim tregtie, ku trupi dhe bukuria e saj përdoret si produkt kryesor në tregjet e shumë shteteve, në të cilat dhuna ndaj femrave është në masë të madhe, ndërsa barazia gjinore është vetëm një iluzion. Shpesh në të kaluarën i kam konsideruar gratë e mbuluara me hixhab-mbulesë si krijesa të shtypura dhe të prapambetura, ndërsa tani i shikoj ato si femra me aftësi të larta dhe të respektuara. Lidhja mes femrave perëndimore është shumë e zbehtë në krahasim me lidhjen e fortë të femrave muslimane. E sidomos i kam ndryshuar pikëpamjet e mia pas një eksperience të hidhur në kohën kur kisha rënë në duart e Talibanëve nën akuzën e spiunazhit në Afganistan gjatë vitit 2001 dhe kisha veshur ferexhe. Ndërsa isha e arrestuar vendosa, që nëse më lirojnë do të filloj leximin e Kuranit dhe mësimin e Islamit dhe pikërisht e plotësova premtimin tim, mirëpo meqë isha gazetares dhe raportoja për lajmet e Lindjes së Mesme ndjeva nevojën për zgjerimin e njohurive rreth fesë, e cila është sistem jete. Më herët mendoja se të lexuarit e Kuranit është vetëm studim akademik, mirëpo më pas mësova se me të vërtetë Kurani tregon në mënyrë të qartë se femrat trajtohen si të barabarta me meshkujt në

shumë aspekte, si ai shpirtëror, arsimor, si dhe në shpërblim. Begatia që i është dhuruar femrës në lindjen dhe edukimin e fëmijëve, muslimanët e shikojnë si një vlerë dhe pozitë të lartë, femra muslimane krenohet me atë që është amvisë dhe mirëmbajtëse e shtëpisë.

E kanë pyetur të Dërguarin e Allahut, se kush nga njerëzit e meriton më shumë mirësjelljen? Iu përgjigj: *nëna jote* duke e përsëritur tri herë ndërsa në herën e katërt tha *babai yt*. Të gjitha synimet e shoqatave të grave gjatë viteve 70-të (të shekullit të kaluar), kanë qenë në dispozicion të gruas muslimane më shumë se 14 shekuj më parë. Femra muslimane ka pasur mundësi të zgjedhë punën e saj dhe ç’ka fituar ka mbetur pronë e saj në kohën kur burri ishte përgjegjës për familjen.

Ekziston gjithashtu një përkushtim i madh për temën e veshjes së gruas muslimane e sidomos nga disa burra muslimanë, si dhe jobesimtarë... Po, është detyrim që gruaja muslimane të veshë rroba modeste, mirëpo ka tema të shumta që ka nevojë të diskutohen për gruan muslimane në kohën e sotme. Shumica e njerëzve përqendrohen në çështjen e mbulesës... dhe unë u them atyre: kujdes, mbulesa është pjesë e punës sime, ajo ju tregon se unë jam muslimane dhe shpresoj që të silleni ndaj meje me një respekt të veçantë. Paramendo sikur t’i kërkohet një personi në një ndërmarrje të madhe, si p.sh.: në një bankë, që të shkojë në punë me pantallona e këmbishë? Nëse ndodh kjo do t’i thuhet pa pikë dyshimi, se uniforma tregon për personalitetin e tij gjatë orarit të punës dhe se kërkohet që të jetë serioz në raport me palën tjetër. Bazë e vlerësimit në Islam është devotshmëria e nuk është bukuria, forca, pasuria apo gjinia... Islami më thotë mua: Me të vërtetë unë zotëroj të drejtën e mësimdhënies, studimit, pavarësisht a jam e martuar apo jo... ■

Përshtati: Bashkim BAJRAMI

ME TË VËRTETË, PAS VËSHTIRËSISË — VJEN LEHTËSIMI!¹

PROF. DR. NASIR OMER

Falënderimi i qoftë Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Paqja dhe Lavdërimi, qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, familjen dhe shokët e tij. Në këtë shkrim do të qëndrojmë me fjalën e Allahut të Madhëruar: ***“Dhe ua ktheu shpinën e tha: “O dëshpërimi i im për Jusufin dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, po i përmbajtur (nga pikëllimi).”²***

Ky ajët kuranor e portretizon me saktësi gjendjen e këtij babai, Jakubit alejhi selam, që ka jetuar me vite në pritje të të birit të tij të dashur, Jusufit alejhi selam, ku papritmas i vjen lajmi edhe për të birin tjetër, i cili gjithashtu ishte një pjesë e veçantë e dashurisë së tij që kishte për te. Allahu i Madhëruar e tregon këtë, ku thotë: ***“Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur tek babai ynë se sa ne.”³***

Nuk mbeti rrugë tjetër para tij, pos të qëndrojë larg tyre, ashtu i brengosur, i pikëlluar, nuk dëshironte ta tregonte pikëllimin dhe dhimbjen para askujt, nga frika se do të mendojnë se ai është i dobët. Por pavarësisht vetëpërmbajtjes para bijve të tij, sytë iu verbuan nga mërzia për birin e

“Dhe ua ktheu shpinën e tha: “O dëshpërimi i im për Jusufin dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, po i përmbajtur (nga pikëllimi).”

tij, sepse kjo është natyra e qenieve njerëzore. Pejgamberët e Zotit ndikohen në qoftë se ata i godet ndonjë fatkeqësi, por ata nuk e shfaqin, as që e kundërshtojnë caktimin e Allahut. Të ndikuarit nga fatkeqësia nuk e mohon durimin .

Ai ishte Pejgamberi ynë - paqja e Zotit qoftë mbi të – që derdhi lot pikëllimi për Ibrahimin djaln e tij, dhe kur disa nga shokët e tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta u habitën nga kjo që panë, Profeti - paqja qoftë mbi të - u tha atyre: ***“Syri le të lotojë, zemra le të pikëllohet, ne nuk themi përveç***

¹ Inshirah , 6

² Jusuf , 84

³ Jusuf, 8



**“...I pikëlluar, i
brengosur për
shkak të
sprovave që
përjetoi, së
pari humbi
Jusufin,
pastaj dy
vëllezërit e tij
dhe në fund
dy sytë, por
sa herë që
sprovat i
shtoheshin
afrohej edhe
ndihma. ...”**

atë që dëshiron Zoti ynë Fuqplotë.”

Në fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Dhe, ua ktheu shpinën e tha: “O dëshpërimi i im për Jusufin.”**⁴

Pse vetëm për Jusufin të dëshpërohej? Thuhet se ai donte të përqendrohet në më të rëndësishmen, e kjo nuk do të thotë se tregohej i pakujdesshëm ndaj të tjerëve, me argument se ai kishte thënë para kësaj në ajetin 83: **“...është shpresë se Allahu do të m'i sjellë të gjithë...”**⁵ Por ai nuk e dinte se ku ishte Jusufi, ndërsa Beniamini dhe vëllai i madh i tyre ai e dinte se ishin në Egjipt.

⁴ Jusuf, 84

⁵ Jusuf, 83

⁶ Jusuf, 84

Dëshpërimi më i madh është për atë që nuk i dihet vendi, dhe koha që është larguar.

Në fjalën e Allahut të Madhëruar: **“O dëshpërimi i im për Jusufin, dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, po i përmbajtur (nga pikëllimi).”**⁶

Kur iu zbardhën të dy sytë Jakubit alejhi selam? Disa mendojnë se ata iu zbardhën pasi i tha këto fjalë, ky është mendimi i disa komentuesve. E vërteta është se në këtë kontekst nuk aludon për një gjë të tillë. Unë jam menduar për këto fjalë dhe kam arritur të kuptoj – dija i takon Allahut të madhëruar – kjo mund t'i ketë ndodhur edhe më parë, se shkronja “uau” në ajetin 84 të lartpërmendur nuk tregon, se pas dëshpërimit atij iu zbardhën sytë, megjithatë mendimi i parë ka epërsi.

Në fjalën e Allahut të Madhëruar **“...po i përmbajtur (nga pikëllimi).”**, i pikëlluar, i brengosur për shkak të sprovave që përjetoi, së pari humbi Jusufin, pastaj dy vëllezërit e tij dhe në fund dy sytë, por sa herë që sprovat i shtoheshin afrohej edhe ndihma. Kështu Jakubi alejhi selam nuk e humbi shpresën nga mëshira e Allahut, ai fitoi në të dy botët. Allahu i Madhëruar ia solli të gjithë, ashtu edhe siç ishte lutur, fitoi me shpërblimin e durimtarëve dhe Zoti e la të përjetshëm rrëfimin mbi te në Kuran, duke e bërë shëmbëlltyrë deri në Ditën e Gjykimit. Fjala e Allahut është më e vërteta kur na thotë **“Me të vërtetë, pas vështirësisë –vjen lehtësimi!”**. Zoti ynë, na bëj prej atyre, që i pasojmë gjurmët e Pejgamberëve dhe të shijojmë kënaqësinë me shoqërimin e tyre në Ditën e Gjykimit. ■

Përshtati: Rashit ZYLFIU

KUR TË FLASIN MENDJELEHTËT PËR ÇËSHTJE MADHORE PRITE KIAMETIN

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Hadithi i sipërshënuar përcillet nga Ebu Hurejre, Enesi dhe Auf ibën Maliku, radijallahu anhum. Ndërsa atë e shënojnë në librat e tyre: imam Ahmedi, (2/291, 338. 3/220) nr. 1887, 8440, Ibën Maxhe, nr. 4042, Hakimi, (4/465, 512) nr. 8571, 8708, Abdurrezak Sanani në: “Musanef” (11/382), nr. 20803, Taberani në: “Muxhemul kebir” nr.14550, 14551 dhe në librin tjetër: “Muxhemul eusat” nr. 3386, Haratiu në librin e tij: “Mekarimul ahlak”, fq. 30, Ebu Bekër Shafiu në librin: “El Gajlanijat” 331, Ebu Nuajm ibën Hamadi në “El Fiten” nr. 1470, Ibën Adiu në: “El Kamil” 6/105.

Hadithi shënohet në librat e lartpërmendur me disa ndryshime të vogla në tekst. Ndryshime këto të cilat nuk qojnë peshë në ndërrimin e kuptimit të tij. Teksti më i saktë i mundshëm është ai të cilin e kemi përmendur më lart deri tek fjala: “ruvejbidah”. Ndërsa pjesa e hadithit e futur në kllapa ka disa transmetime të ndryshme. Rreth saktësisë së saj, se a është nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, apo mund të jetë koment i transmetuesve pas tij dijetarët kanë dy mendime. Për këtë shkak e veçuam prej hadithit si dhe e futëm brenda kllapave.

Hadithi edhe pse shënohet në shumë libra dijetarësh, ai prapë sillet rreth disa transmetuesve, të cilët nuk kanë shpëtuar nga vërejtjet e dijetarëve, ku si shkak edhe hadithet e tyre zakonisht kategorizohen në

Ebu Hurejre na përcjell, se e ka dëgjuar të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë:
*“Para kiametit do të vijnë vite tradhtie (mashtuese, të vështira). Në atë kohë do t’i besohet gënjeshtarit, kurse do të përgënjeshtrohet i sinqerti, do t’i jepet pozita tradhtarit dhe do të akuzohet besniku, gjithashtu atëherë do të flasë “ruvejbidah”. (Shokët e pyetën të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kush është “ruvejbidah”? Ai tha: “Njeriu injorant, i cili flet për çështje të mëdha –të njerëzve-”)*

radhët e haditheve të dobët. Megjithatë hadithi në përgjithësi, pra, edhe me pjesën në të cilën komentohet domethënia e fjalës: “ruvejbidah” dijetarët duke ia bashkuar të gjitha rrugët e transmetimit e konsiderojnë hadith “Hasen” (I Mirë), prej tyre, pra, që e konsiderojnë të mirë janë Hakimi, Dhehebiu (këta dy e konsiderojnë hadith të saktë), Ibën Haxheri në: “Fet’h” 13/84, Albani në: “Silsile sahiha” 4/508, si dhe Shuajb Arnauti në redaktimin bërë Musnedit të Ahmedit e ndan po të njëjtin mendim me dijetarët e lartpërmendur. Ka disa studiues bashkëkohorë, të cilët pjesën e fundit të hadithit, pra, atë në të cilën komentohet fjala: “ruvejbidah” nuk e konsiderojnë pjesë të hadithit, por sipas tyre ajo është fjale e disa transmetuesve, të cilët e komentuan domethënien e kësaj fjale. Argumentet në të cilat u bazuan janë:

-Në transmetimin më të saktë, i cili sipas tyre është i vetmi transmetim “hasen”, nuk përmendet kjo shtojcë.

-Rreth komentimit të fjalës “ruvejbidah” ka ardhur më shumë se një transmetim gjegjësisht janë shtatë sosh, ku sipas tyre sikur të ishte nga Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, do të ishte një komentim e jo shtatë.

-Të gjithë transmetimet në të cilat është



përmendur ky koment janë transmetime të dobëta, të cilat nuk mund ta forcojnë njëra-tjetrën, për shkak të jo përputhshmërisë në fjalët e transmetimeve.

Por bazuar në atë që kam lexuar mendoj se edhe këtë pjesë nuk do të ishte e arsyeshme ta ndanim nga hadithi për disa arsye:

-Dijetarët e dëshmuar të hadithit nuk e ndajnë nga hadithi i lartpërmendur.

-Mos përmendja në një transmetim, edhe pse ky mund të jetë më i miri transmetim në këtë rast, nuk nënkupton mohimin nga transmetimet e tjera, po ashtu nuk nënkupton domosdoshmërisht dobësinë e asaj pjese duke e ditur se të gjithë shkruesit e librave të hadithit nga imam Ahmedi e pas e futën si pjesë të pandarë të hadithit. Sikur të ishte koment i dijetarëve, apo të mos ishte fare pjesë e cekur në këtë temë, ndonjëri prej tyre do ta vërente e jo ta neglizhonte që të gjithë.

-Ardhja e më shumë se një komentit për fjalën: “ruvejbidah” nuk nënkupton se ato janë në kundërshtim patjetër njëra me tjetrën. Po t’i analizojmë që të gjitha ndërlidhen njëra me tjetrën dhe janë thuajse të gjitha të përafërta mes vete.

-Nëse në përgjithësi ekziston dhe është i vlefshëm rregulli, se transmetimet e shumta, nëse nuk kanë dobësi të madhe në vetvete,

atëherë e forcojnë njëra-tjetrën e nuk e dobësojnë, atëherë pse të mos vlejë ky rregull edhe në këtë rast me këtë pjesë të hadithit, ashtu siç vlejti për Ibën Haxerin, Albanin... po ashtu siç vlen për pjesën e parë të hadithit, e cila siç përmendëm më lartë edhe në të ka ndryshime në fjalët e tij, por kjo nuk ishte prej shkaqeve të dobësimit të hadithit, atëherë përse të jetë shkak për dobësimin e tij në këtë pjesë të fundit të tij përderisa mundësia për t’i bashkuar mes vete është e mundshme?!

-Po ashtu ndryshimi në shprehjet e komentit të kësaj fjale na jep të kuptojmë, se hadithi është transmetuar me kuptim, e transmetimi me kuptim sipas mendimit më të saktë është i lejuar derisa ai nuk ia humb domethënien origjinale të hadithit. Kështu që mendoj se hadithi i tëri është “hasen” (i mirë), si pjesa e parë ashtu edhe ajo e fundit. Allahu e di më së miri!

Komenti i hadithit:

“Para kiametit do të vijin vitet e tradhtisë (mashtrore, të vështira).

Në këtë fjali përmenden disa çështje, apo thënë më saktësisht; tri kryesore:

-E para: Kiameti, i cili ndryshe njihet si kataklizmi dhe do të ndodhë me lejen e Allahut, atëherë kur Ai të dojë dhe të japë urdhër. Fjala: “kiamet” nënkupton shkatërrimin e tërë gjithësisë dhe vdekjen e çdo gjallese, ku i fundit që do të vdesë është meleku, i cili quhet ndryshe Meleku i Vdekjes dhe ka për detyrë t’ua marrë shpirtin të gjitha krijesave e në fund Allahu atij do t’ia marrë shpirtin.

Data e ndodhjes së kiametit nuk dihet nga askush, datë kjo të cilën Allahu e ka veçuar me dije vetëm për Vetën e Tij. Allahu thotë në Kuran: **“Të pyesin ty për Orën (e Kiametit), se kur do të ndodhë. Çfarë rëndësie ka për ty që ta përmendësh atë? Tek Zoti yt është fundi i (dijenisë rreth) saj.”** (Naziat, 42, 43, 44).

Kur jemi duke folur për këtë çështje nuk

dua të lë pa përmendur faktin, se ka njerëz që e përziejnë mes vete ndodhinë e Kiametit me atë të Ditës së Gjykimit. Pra, mendojnë se këto dy Ditë janë një ditë e vetme. Jo, kjo nuk është e vërtetë, Dita e Kiametit është ditë tjetër, kurse ajo e Gjykimit tjetër, në fillim ka për të ndodhur Kiameti e pastaj Dita e Gjykimit. Në të parën ndodh shkatërrimi i çdo gjëje, ndërsa në të dytën dalin për t'u llogaritur para Allahut, për të marrë shpërblimin apo dënimin e merituar, sipas veprave të tyre. Këto të dyja jo vetëm që nuk janë një ditë e vetme, por në mes tyre do të ketë kohë apo distancë kohore.

-Çështja e dytë: Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në këtë hadith, si në shumë hadithe të tjera na flet për çështje, të cilat kanë të bëjnë me kohën e ardhme. Kjo gjë nuk duhet të na japi të kuptojmë se ai, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte njeri, i cili e dinte gajbin (të fshehtë), apo gjëra të cilat do të ndodhin në të ardhmen.

-Çështja e tretë: fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, “*vite tradhtie* (mashtuese, të vështira).” Kuptohet qartë nga pjesa e hadithit në vazhdim pra, në ato vite njerëzve të besuar do t'u shpifën fjalë nga më të ndryshmet, detyrat do t'u besohen njerëzve jo besnikë. Edhe Ibën Ethiri, Allahu e mëshiroftë, për këtë fjalë thotë se me të kihet si qëllim koha në të cilën do të shfaqen gjërat jo sipas realitetit të tyre të jashtëm, pra, në atë kohë njerëzit tradhtarë do të paraqiten si besnikë, njerëzit jo të fjalës marrin pozitë e popullit. Në disa transmetime përmendet se në ato kohë do të bjerë shumë shi, por toka nuk do të lëshojë bereqet. (shiko: “En-Nihaje, tek fjala: “hadea” fjala, 991 me radhë. Vëll. 1, fq. 474. Botimi, “Dar marife).

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

“Në atë kohë do t'i besohet gënjeshtarit, kurse do të përgënjeshtrohet i singerti, do t'i jepet pozita të pabesit (tradhtarit) dhe do të akuzohet besniku”.

“...E mira dhe e keqja nuk do të analizohen sipas konceptit të sheriatit e as të arsyes, por sipas sistemeve njerëzore të ngritura mbi epshe dhe dëshira, ku pastaj normale është që pasojat të mos kuptohen ...”

Kjo pjesë e hadithit e shpjegon qartë atë që përmendëm pak më lart, pra, ajo kohë është kur gjërave do t'u ndërrohen vendet, njerëzve u ndërrohen pozitat, kohë në të cilën do të bëhet padrejtësi. Në atë kohë njerëzve të drejtë do t'u vishen epitete nga më të ndryshmet. Atij që mundohet ta urdhërojë popullin në rrugë të drejtë dhe ta ndalojë nga e keqja do t'i thuhet se po e tepron, apo njeri i prapambetur, i cili lufton “civilizimin”. Njerëzve që praktikojnë fenë e Zotit dhe parimet e pastra të saj do të fillojnë të ofendohen e jo vetëm kaq, por edhe të akuzohen për punë të tilla që nuk u përkasin aspak atyre. Të këqijtë do të bëhen shkaktarë për t'ua prishur imazhin të mirëve, për t'i bindur të tjerët, se të mirët nuk janë të tillë, por të mirë janë këta të këqijtë.

Njerëzit që kanë sakrifikuar për popullin çdo gjë, pasurinë, kohën, familjen dhe vetveten, kanë kapur pushkën në krah në kohën kur ka qenë koha e pushkës, vetëm për të mirën e vendit të tyre dhe për ardhjen e ditëve më të mira, këta njerëz pas disa kohe do të konsiderohen si jo të besueshëm, si prishës të rendit vendor, bile si tradhtarë dhe destabilizues. Pse kështu? A thua se kanë fakte apo jo, apo për shkak se ata që janë në pozitë e keqpërdorin pozitën e tyre, duke i bindur të tjerët, se kjo që vepron unë është e drejta e jo ajo që vepron tjetri. E përdorin

mundësinë dhe pozitën e tyre për t'i bindur të tjerët, se besnik jam unë dhe vetëm unë, ndërsa besniku nuk do të jetë veçse tradhtar. Trim nuk është ai që e ka vendosur veten para plumbit, atëherë kur ishte koha e trimave dhe e armës, dhe ka luftuar kundër armikut të vërtetë, e pastaj për hir të stabilitetit i ka dhënë lamtumirën armës së tij, por trim është ai që sot e ka kapur pushkën dhe lufton për interesat e tij private. Kur? Atëherë kur ka shkuar koha e luftës dhe e trimërisë, ndërsa ky i fundit e ka filluar luftën për një kafshatë buke, për një grusht parash, apo një karrige. Pse njerëzit jo të besueshëm dhe ata që s'e mbajnë fjalën kanë aq shumë alergji ndaj besnikëve, pse kjo urretje e njëanshme, kaq shumë e madhe? Mendoj për asgjë tjetër veçse për shkak se sikur të kuptohej nga masa e thjeshtë, se kush është besniku i vërtetë dhe ai që e mban fjalën, kush është ai që ua do të mirën me të vërtetë të tjerëve, atëherë destabilizuesve dhe thyesve të fjalës së dhënë dhe besës së marrë nga të tjerët nuk do t'u mbetej vend në mesin e popullit. Kështu, për të mbetur aty ku janë duhet fajn e tyre t'ua hedhin të tjerëve, gabimet e tyre duhet t'i arsyetojë tjetër kush, dhe patjetër masa e gjerë duhet të mos e kuptojë kurrë, se kush është besniku e kush është mashtruesi, kush i miri e kush i keqi, kush stabilizuesi e kush destabilizuesi. Kështu masës së gjerë u "lyhet koka me akull", siç thotë populli dhe me pak mund, çdo gjë merr fund.

Pse në atë kohë do të ndodhë kështu? A thua se të drejtët dhe besnikët do të jenë në mëshirë të fatit dhe nuk kanë kurrfarë mundësie ndryshimi? Jo, aspak nuk është kështu, por për shkak se peshojat janë ndërruar, me kandarin e peshave të rënda matet ari dhe argjendi me miligram, ndërsa me peshojat e vogla matet hekuri dhe betoni, makina e kamioni. Pra peshojat e perceptimit dhe kuptimit të gjërave do të ndërrohen tek shumica e njerëzve dhe kështu e keqja do t'i

prijë të mirës, e shtrembra të drejtës dhe i pabesi besnikut. Atëherë e mira dhe e keqja nuk do të analizohen sipas konceptit të sheriatit e as të arsyes, por sipas sistemeve njerëzore të ngritura mbi epshe dhe dëshira, ku pastaj normale është që pasojat të mos kuptohen, të mos parandalohen, por vetëm të ndodhin e të mos dihet pse. Sipas kësaj të fundit kuptohet, se i tërë populli nuk do të thotë se do të jenë të këqij, të cilët nuk e duan të mirën dhe të cilët i urrejnë aq shumë besnikët dhe të sinqertët, por nga kjo që përmendëm kuptojmë se sistemet dhe rrethanat në të cilat jeton në ato kohë bota asisoj e bien gjendjen, si ideologjike ashtu edhe politike e ekonomike etj., që pa qëllime të këqija apo edhe të detyruar nga gjendjet e caktuara që të gjykojnë pa menduar shumë apo edhe duke mos guxuar të shprehen ndryshe, sepse do të akuzoheshin mizorisht.

Fjala në hadith:

"gjithashtu atëherë do të flasë "ruvejbidah". Shokët e pyetën të Dërguarin, sal-lallahu alejhi ue selem, kush është "ruvejbidah"? Ai tha: "Njeriu injorant, i cili flet për çështje të mëdha-të njerëzve-"

Do të vijë koha në të cilën flet "ruvejbidah", kjo edhe sikur të mos komentohej nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, apo nga dijetarët pas tij mjafton si fjalë arabe nga vetë theksi i saj të shërbejë si nënçmim për këta njerëz, të cilët do të fillojnë të flasin për çështje madhore, apo për çështje që kanë të bëjnë me popullin në përgjithësi. Pra, fjala "ruvejbidah" tregon nënçmim në vetvete. Sa i përket komentit të kësaj fjale në disa transmetime të ndryshme është përmendur domethënia e saj, prej këtyre komenteve janë:

1- Njeriu injorant, i cili flet për çështje të mëdha të njerëzve.

2- Mendjelehti që flet në emër të të tjerëve.

3- Njeriu i ulët (në mendje, pozitë, vlera,

autoritet)

4- Dyftytyrëshi që flet për çështjet e të tjerëve.

5- Në një transmetim përmendet gjithashtu dyftytyrëshi, por këtu i shtohet edhe shtesa “dyftytyrëshi i vogël”, pra, me fjalën “i vogël” kihet si qëllim nënçmim pas nënçmimi.

6- Ai për të cilin nuk u bëhet vonë të tjerëve. Pra, ai që nuk qon peshë tek njerëzit, kur rastësisht e sheh se fillon të flasë për çështje të mëdha, kinse interesohet për të tjerët vetëm që ta përkrahin të tjerët dhe ashtu në atë kohë do të ndodhë pasi t'i besohet, atëherë nuk i intereson askush, por vetëm vetja e tij.

7- Njeriu i pavlerë. Edhe pse kjo domethënie futet në disa prej të lartpërmendurave e veçuam me pikë të veçantë pasi është përmendur në një transmetim të veçantë me një shprehje të tillë. Komenti i parë për këtë fjalë është ndër më të saktit në transmetime, si dhe thuajse shumica e dijetarëve dhe e gjuhëtarëve, të cilët e komentojnë këtë fjalë sjellin të njëjtin përkufizim. Por e shikuar në përgjithësi të gjitha këto komente të kësaj fjale thuajse janë të përafërta mes vete dhe përputhen.

Fjala injorant nuk nënkupton, se njerëzit e atyre kohëve nuk do të kenë dituri shkencore. Jo, ata mund të jenë nga më të shkolluarit, t'i kenë titujt më të lartë që do të ekzistojnë në ato kohë, por prapë do të jenë injorantë. Kjo për arsye se dituria e njeriut nuk matet me titujt shkencorë, por me njohjen e Allahut dhe të detyrimeve ndaj Tij. Kështu që lexuesi nuk duhet ta keqkuptojë apo t'i përzihet termi “injorant”, sepse me të kihet si qëllim injoranti ndaj Zotit të tij.

Kjo shprehje në hadith na jep të kuptojmë, se para Kiametit do të vijë një kohë në të cilën njerëzit më mëkatarë, njerëzit më injorantë dhe ata më të ulët në pozitë do të fillojnë të flasin për çështje madhore, të interesohen

për të tjerët, por njerëzit do t'ua dinë historinë dhe të kaluarën e tyre dhe shtatë shprehjet në komentimin e fjalës “ruvejbidah” sikur na jep të kuptojmë se njerëzit jo vetëm që do t'ua dinë historinë, por do t'i njohin shtatë fish apo nga shtatë anë, do t'i njohin nga shtatë breza, gjysh pas gjyshi e baba pas babai. Për fat të keq prapë do t'u besojnë, do t'i marrin për të parë (udhëheqës) të tyre dhe do t'u besojnë postet e veta. Edhe pse sot premtojnë e nesër nuk i mbajnë premtimet, flasin shumë e nuk punojnë ashtu si thonë, kur prapë pas pak vitesh fillon lufta e bindjes së popullit që t'iu besojnë duke ua mbushur së dyti mendjen e populli i shkretë prapë ju beson. Në ato kohë, para kiametit është vështirë që njerëzit të marrin mësim dhe të mbledhin mend, që njeriut i cili nuk e mban fjalën, njeriut i cili është mendjelehtë, jo i fjalës, jo i Zotit, të mos e përkrahin, të mos i besojnë, por prapë e njëjta histori vazhdon dhe përsëritet. Në ato kohë me vite të tëra populli do të ankohen nga udhëheqësit e tyre dhe vetëm presin kohën kur do t'u jepet mundësia për t'i ndryshuar, por kur t'iu vijë kjo mundësi ata prapë do të mashtrohen dhe nuk do të ndryshojnë asgjë, pse kështu për shkak se vetë nuk janë të mirë. Si do të jetë populli, ashtu do t'i kenë edhe të parët e tyre, prandaj askush në atë kohë nuk duhet të ankohet për udhëheqësit e vet, por duhet të fillojë punën për ndryshim, ku fillimi i ndryshimit është përmirësimi i vetes. Lind pyetja: a thua ka ardhur ajo kohë për të cilën Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka folur në këtë hadith, apo do të vijë në të ardhmen? Pa dyshim kjo kohë ka ardhur, por në të ardhmen ajo mund të vështirësohet apo edhe të lehtësohet, ngase vetëm Allahu e di të ardhmen. Por sido që të jetë sado të shtohen këto çudi, ato prapë e kanë një fund e ***pas çdo vështirësie vjen lehtësimi.*** ■

KREMTET E FUNDVITIT

ZGJODHI DHE PËRKTHEU: AGIM BEKIRI

Pyetja e parë. Cili është vendimi i sheriatit për pjesëmarrjen në kremtet e mosbesimtarëve, që janë të veçanta për ata apo përurimin e tyre?

Përgjigje: Pjesëmarrja në festat e veçanta të mosbesimtarëve apo përurimi i tyre mund të ndodh në disa forma:

Pjesëmarrja mund të jetë thjeshtë një pasim i dokeve të tyre pa pasur në mendje madhërimin e simboleve të tyre fetare dhe pa i besuar ato. Kjo formë mund të paramendohet më shumë gjatë përurimit, se sa në pjesëmarrjet në ato festa. Sheriati këtë vepër e vlerëson të ndaluar, ngase pjesëmarrja në këtë rast çon në madhërimin e besimit dhe simboleve të tyre fetare. Shumë prej dijetarëve të hershëm ajetin kuranor: **“edhe ata që nuk dëshmojnë në mënyrë të gënjeshtërt e kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet.”** (Furkan: 72), gjegjësisht

shprehjen **“...nuk dëshmojnë në mënyrë të gënjeshtërt”** e kanë komentuar si prani në kremtet e idhujtarëve. Këtë e përforcon edhe më shumë hadithi i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: **“...çdo popull ka festën e tij”**.

Pjesëmarrja mund të jetë për të përjetuar ndonjë kënaqësi, siç veprojnë disa njerëz për të pirë verëra, për të kërcyer apo për shkak të përzierjes mes grave dhe burrave e të ngjashme. Kjo pjesëmarrje është haram edhe më i ashpër në këndvështrimin e sheriatit, ngase përveç pjesëmarrjes në kotësi shtohen edhe veprat e sipërpërmendura që janë të ndaluara.

Nëse bëhet fjalë për kërsëndellat dhe dikush merr pjesë në këtë festë të të krishterëve, me qëllim që t'i afrohet Allahut, duke shprehur respekt ndaj Isait, alejhi selam, duke përkujtuar lindjen e tij njësoj siç bëjnë disa muslimanë kur festojnë lindjen e Muhamedit (mevludin), atëherë sheriatu këtë vepër e gjykon si bidat (risi), e cila në fakt konsiderohet lajthitje. Ndalimi i kësaj vepre

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

është shumë më i ashpër, se sa ndalimi i festimit të mevludit, ngase në rastin e parë ai shoqëron njerëzit, të cilët mendojnë se Isai është bir i Zotit, qoftë i madhëruar Allahu. Këtë besim të kotë ata e shpikën, nuk e zbriti Allahu, nuk e veproi, as Isai, as pejgamberët e tjerë. Respektimi i pejgamberëve bëhet duke i dashur ata dhe duke pasuar fenë e tyre e jo me këto festime.

Pjesëmarrja apo përrurimi mund të jetë duke besuar vërtetësinë e fesë së tyre, duke u pajtuar me simbolet dhe adhurimet e tyre fetare, ashtu siç kanë thënë më herët: “I adhuruari është një, edhe pse nëpërmjet rrugëve të ndryshme”, ose siç shprehen në kohën tonë “për bashkimin e feve” një parullë masone kjo. Këtë pjesëmarrje sheriati e gjykon si mosbesim (kufër), i cili të nxjerr nga feja. Allahu i Madhëruar thotë: **“E kush kërkon fe tjetër përveç Fesë Islame, atij kursesit nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.”** (Ali Imran: 85)

SEFER HAVALI

Pyetja e dytë: A lejohet t’i përgjigjem ftesës të krishtlindjes dhe a lejohet të hamë nga ushqimi që është përgatitur për këtë festë?

Përgjigje: Nuk lejohet festimi i kremteve të ndryshme të shpikura, siç janë krishtlindjet, Nevruzi, Mevludi, Israja dhe Miraxhi, as që lejohet ngrënia nga ushqimet e përgatitura për këto festa. Nuk lejohet t’u përgjigjemi ftesave të tyre në këto festa, ngase përgjigja e ftesës i inkurajon ata dhe shpreh një lloj pëlqimi ndaj risive të tyre, e pastaj kjo bëhet shkak për mashtrimin e injorantëve me këtë gjë dhe çon deri të mendimi se besimi i tyre është i vërtetë. Allahu e di më së miri.

ABDULLAH IBËN XHIBRIN.

Pyetja e tretë: Jam revizor në një kompani tregtare. Nëse bashkëpunëtori im më sjell

kartolina në të cilat ka fjalë idhujtarie si fjala vjen “Isai është zoti” apo “Isai të do” dhe unë pasi t’i sqaroj atij dhe ta këshilloj, bëj llogarinë dhe i vendoj paratë në kasë. A më bën kjo vepër mosbesimtar duke ditur se unë e urrej idhujtarinë?

Përgjigje: Përderisa je besimtar që urren idhujtarinë mbetesh musliman, përderisa nuk vepron ndonjë vepër, e cila të nxjerr nga Islami. Mirëpo gjithsesi duhet ta dish, se nuk i lejohet një besimtari t’i ndihmojë një mosbesimtar në çfarëdo lloj mënyre për realizimin e kremteve të tyre. Pra, nuk lejohet, as t’u shesësh atyre gjëra që kanë të bëjnë me ato festa. Shejhul Islam Ibën Tejmije në librin e tij të famshëm “Iktidau siratil mustekim” thotë: “Nëse një musliman u shet (mosbesimtarëve) gjëra me të cilat ata ndihmohen në festat e tyre, siç është ushqimi, veshja, parfume e të ngjashme, apo edhe nëse ua dhuron ato gjëra ai në njëfarë mënyre i ka ndihmuar ata për realizimin e festave të tyre të ndaluara. Kjo çështje është identike me rregullin: nuk lejohet t’u shesësh mosbesimtarëve rrush apo lëngun e rrushit për ta bërë verë. Po ashtu nuk lejohet t’u shitet armë për t’i vrarë muslimanët. – pastaj përmendi fjalën e Abdulmelik ibën Habibit - një dijetar maliki: “A nuk u lejohet muslimanëve, që t’u shesin verën të krishterëve, gjëra që u bëjnë dobi për festat e tyre? As mish, as gjellë, as rrobe, nuk ua huazojnë atin, as që u ndihmojnë në diçka që ka të bëjë me festat e tyre, sepse një gjë e tillë legjitimon idhujtarinë dhe mosbesimin.” (fq. 229)

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

Pyetja e katërt: Nja vashë e krishtere pyet: A kanë muslimanët festa që s’janë te të krishterët dhe cilat janë ato. Cili është simboli i Islamit, për shembull te ne është kryqi, më intereson a ka ndonjë simbol të caktuar?

Përgjigje: Muslimanët kanë vetëm dy ditë,

të cilat i festojnë, ato janë: Fitër Bajrami, që vjen pas muajit të Ramazanit dhe Kurban Bajrami, që është në ditët e haxhillëkut. Kurban Bajramin muslimanët e festojnë duke therur një kurban në shenjë pasimi të pejgamberit Ibrahim, i cili u urdhërua nga Allahu, që të flijonte djalit e tij të vogël Ismailin. Kur i tregoi djalit të tij për urdhrin e Zotit ai iu bind menjëherë, kurse babanë e tij e siguroi se do të jetë durimtar. Kur Ibrahim desh i ta therë Ismailin Allahu i çoi një zëvendësim nga qielli, një kafshë të madhe, të cilën do ta therte në vend të të birit. Prej këtij momenti ka mbetur therja e Kurbanit, një përkujtim i këtyre dy pejgamberëve, alejhima selam. Në të njëjtën kohë therja e Kurbanit është traditë e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Muslimanët pra, festojnë vetëm këto dy festa e jo edhe festat e të krishterëve.

Sa i përket simbolit të Islamit themi që muslimanët adhurojnë Allahun dhe refuzojnë çfarëdo lloj idhujtarie. Ne besojmë se të krishterët e marrin kryqin si simbol të zotit të tyre apo djalit të zotit të tyre siç pretendojnë. Ata kërkojnë bekimin dhe mbrojtjen nga kryqi, kurse muslimanët bekimin dhe mbrojtjen e kërkojnë vetëm nga Allahu. Për këtë arsye muslimanët nuk kanë ndonjë simbol si kryqi. Disa muslimanë shpikën Hënë si një simbol përballë kryqit, mirëpo një gjë e tillë nuk është e vërtetë madje konsiderohet si risi e papranuar.

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID.

Pyetja e pestë: Kam nisur një biznes të vogël dhe gjatë festave të ndryshme shes mallra që janë specifike për krishtlindje, për 8 Mars e të tjerë. A është haram një gjë e tillë? Unë më parë kisha një supermarket, mirëpo e kam shitur, ngase mes të tjerash shitja birra dhe mish derri dhe nuk dëshiroj më t'i kthehem asaj pune. Më lejoni që t'ju pyes edhe për disa mallra të tjera, të cilat unë i shes, si prezervativë, disa fotografi qeramike,

cigare, bileta lotarie, disa barëra që përmbajnë alkool, ëmbëlsira, të cilat mund të përmbajnë materie që janë të ndaluara për ne muslimanët, por mund edhe të mos përmbajnë, pra, a më lejohet që këto mallra t'ua shes klientëve të mi mosbesimtarë?

Përgjigje: Ke vepruar shumë mirë që ke lënë shitjen e birrave dhe mishit të derrit. Lusim Allahun të të bekojë ty, furnizimin tënd dhe të të japi një zëvendësim më të mirë. Sa i takon pyetjeve të tua i përgjigjemi, si vijon:

Nuk i lejohet besimtarit të marrë pjesë në festat e jobesimtarëve, siç janë krishtlindjet. Nuk lejohet as t'ju shesim atyre gjëra që i ndihmojnë për festat e tyre, ngase Allahu i Madhëruar thotë: ***“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e jo në mëkate e armiqësi”*** (Maide: 2). Të ngjashme janë edhe festat e tjera të shpikura, siç është festa e nënës, pra, nuk lejohet të shesësh gjëra që do të ndihmonin këtë festë.

Në esencë lejohet përdorimi i prezervativëve dhe shitja e tyre përpos nëse shitësi e di ose ka supozim të fortë se do të përdoret në haram, në atë rast nuk lejohet shitja. Rregulli që shërben si bazament për këto çështje – siç thotë Shejhul Islam Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë – është: ***“Çdo petk për të cilin ekziston një supozim i fuqishëm, se do të përdoret në haram nuk lejohet të shitet apo t'i qepet atij që do ta përdorë për mëkate apo zullum.”*** (Sherhul Umde 4/386). Ky rregull është i përgjithshëm për çdo mall që shitet apo blihet.

Ndalohet shitja e duhanit dhe e biletave të lotarisë dhe çdo mall që dihet se do të përdoret në haram. Komisioni i Përhershëm për Fetva 13/55 ka dhënë këtë fetva: ***“Nuk lejohet tregtia me duhan, nargjile dhe harame të tjera, ngase ato janë të fëlliqura dhe shkaktojnë dëme trupore, shpirtërore dhe materiale.”*** Sa i takon biletave të lotarisë mu ato janë bixhozi i ndaluar. Shejh Uthejmini, Allahu e mëshiroftë thotë:

“Pasqyrimin që bëri pyetësi, pra, blerja e një bilete pastaj mund të fitojë një shumë të madhe parash, kjo bën pjesë në bixhozin për të cilin Allahu i Madhëruar ka thënë: **“O ju, që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund** (alkoolit e bixhozit)? **Binduni Allahut dhe binduni të dërguarit e kini kujdes** (mos kundërshtoni). **E nëse refuzoni, atëherë pra, dijeni se detyrim i të dërguarit Tonë është vetëm kumtimi i qartë.”** (Maide: 90-92), ky është bixhozi që nënkupton çdo allishverish në të cilin pjesëmarrësi nuk e di do të fitojë apo do të humbë, të gjitha janë të ndaluara, madje prej mëkateve të mëdha dhe shëmtia e tyre nuk është e panjohur për secilin që shikon se Allahu e përmendi atë në një rang me adhurimin e idhujve, alkoolin dhe fallin.” (Fetava islamiye 4/414)

Nuk lejohet formimi i pamjeve të qenieve të gjalla qoftë njeri, shpend apo gjallesë tjetër. Nëse ato janë me vëllim, atëherë ndalesa është edhe më e madhe. Nisur nga kjo nuk lejohet shitja e këtyre fotografive prej qeramike apo të tjera, nëse janë sipas shpjegimit që u përmend më lart, në të kundërtën nëse janë peizazhe, atëherë nuk janë të ndaluara. Komisioni i Përhershëm për Fetva 13/73 shkruan: “Shitblerja e fotografive të gjallesave është e ndaluar duke u mbështetur në thënien e të Dërguarit të Allahut: **“Allahu dhe i Dërguari i Tij ndalojnë shitblerjen e alkoolit, ngordhësirës, derrit dhe idhujve”** (Buhariu dhe Muslimi)... dhe në shumë tekste të tjera që flasin për ndalimin e formimit të pamjeve.”

Barërat që përmbajnë alkool me përqindje të madhe, aq sa konsumimi i bollshëm i tij do

të shkaktonte dehje, ato në fakt janë alkool dhe si të tilla ndalohet përdorimi apo shitblerja e tyre. Nëse përqindja e alkoolit është e vogël, aq sa nuk shkakton dehjen e atij që pi një sasi të madhe prej atij bari, atëherë lejohet përdorimi dhe shitja. Komisioni i Përhershëm për Fetva, në lidhje me parfumet që përmbajnë alkool ka dhënë këtë fetva: “Nëse përqindja e alkoolit në parfum është aq sa pirja e një sasi të madhe prej tij do të shkaktonte dehje, pirja e tyre është e ndaluar dhe tregtia me to, si dhe të gjitha përfitimet e tjera, ngase ai parfum konsiderohet alkool, qoftë pak ose shumë. Nëse përqindja e alkoolit në ato parfume nuk shkakton dehje lejohet përdorimi i tyre dhe shitblerja, duke u mbështetur në thënien e Muhamedit, **sal-lallahu alejhi ue selem: “Ajo shumica e së cilës deh, pakica e saj është haram.”** 13/54

Gjërat që i ndalohen një besimtari nuk lejohet t’ia shesë, as muslimanit, as jomuslimanit, ngase jomuslimanët janë të ngarkuar me të gjitha detyrat e sheriatit sipas pjesës dërrmuese të dijetarëve. Për ta ndalohet ajo që ndalohet për besimtarët, prandaj nuk lejohet t’u shitet atyre alkooli, mishi i derrit e as gjërat e tjera të ndaluara sipas fesë tonë, edhe po qe se të njëjtat mund të jenë të lejuara në fetë e tyre, sepse legjislacioni islam i ka shfuqizuar legjislacionet e feve para tij. Në lidhje me këtë Komisioni i Përhershëm për Fetva ka dhënë këtë fetva: “Nuk lejohet tregtia me gjëra që Allahu i ka bërë haram, qofshin ushqime apo gjëra të tjera si vera, mishi i derrit madje edhe me jobesimtarët duke u mbështetur në thënien e Muhamedit, **sal-lallahu alejhi ue selem: “Allahu kur ndalon një gjë ndalon edhe përfitimin nga e njëjta...”**.” ■

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

REBI IBËN HUTHEJMI — NJË BURRË QË PESHON SA MALET (I)

Jeta e tij, edhe pse ai nuk u takua me Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue selem ishte aq shumë e koordinuar me traditën e tij, saqë vetëm emri “sahabi” i mungonte atij.

SEDAT ISLAMI

Hyrje

Hadithi i Pejgamberit, alejhi selam: *Njerëzit më të mirë janë këta të kohës sime, pastaj ata që vijnë, pastaj ata që vijnë...*¹

...nuk ka si të mos jetë i vërtetë kur vetëm me një vështrim, qoftë edhe sipërfaqësor, në biografite e njerëzve të atyre gjeneratave të arta të bind për këtë fakt. Sinqeriteti i njëmendtë në lidhje me fenë e Allahut të Madhëruar i kishte bërë të pathyeshëm dhe të pamposhtur para çdo sfide. Ata ishin trajnuar për veprimet e duhura në çfarëdo situatë, kështu, nëse bëhej fjalë për marrëdhënie ndërmjet vete, i shihje të ishin modestë, të përmbytur, falnin, mëshironin, ndihmonin, udhëzonin e këshillonin njëri tjetrin. Por nëse rrethanat e diktonin nevojën për mbrojtjen e fesë dhe të nderit, atëherë i shihje ata tek garonin, se kush do të nderohej me pjesëmarrje në betejë. Me një fjalë vizioni i tyre si nxënës të shkollës profetike i kishte bërë që balancimin ndërmjet dynjasë dhe fesë ta kenë në nivelin e duhur.

I tillë ishte edhe Rebi ibën Huthejmi, një figurë e cila shndrit në horizontet e devotshmërisë dhe hapi shtigje drejt realizimit

të idealit të çdo muslimani, kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Jeta e tij, edhe pse ai nuk u takua me Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue selem ishte aq shumë e koordinuar me traditën e tij, saqë vetëm emri “sahabi” i mungonte atij. Sjelljet e tij të shkëlqyera dhe edukata e pashembullt e bënë atë, me të gjithë kuptimin e fjalës, një kolos devotshmërie, një erudit urtësie, një njeri që mësimet dhe këshillat e tij edhe pas më shumë se njëmijë vjet vazhdojnë të jenë të freskëta po aq sa ishin në atë kohë kur u thanë.

Kush është Rebi ibën Huthejmi?

Rebia nuk e pati fatin ta takonte Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue selem ndaj edhe nuk e mban epitelin “sahabi”, por muhadrem² (). Familja e tij shquhej për devotshmëri³. Ishte nga Kufa dhe për lindjen e tij datat nuk dihen saktësisht në asnjë burim që kam konsultuar. Për emrin e tij është diskutuar, se a është Rebi ibën Hajthem⁴, Hujthem apo Huthejm, mendime të cilat i përmend Taberiu në Tefsirin e vet dhe zgjedh si më të saktë versionin **Huthejm**⁶, madje përmend Ibni Durejdin ta ketë vokalizuar kështu këtë emër në El Ishtikak⁷. Ka qenë prej tabiinëve të mëdhenj, madje prej ajkës së tyre. Llagapin e kishte Ebu Jezid⁸.

Ka vdekur pas vrasjes së Husejnit, në vitin

¹ E përcjell Tirmidhiu në Sunenin e tij nga Imran ibën Husajni, kurse Albani në “Sahihu ve Daifu Suneni” Tirmidhi, 2221”, e ka cilësuar autentik.

² Takribu’t Tehdhib, Hafidhi, fq. 206.

³ Sahabij quhet muslimani, i cili e ka parë Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue selem dhe ka vdekur si musliman. Kurse Muhadrem është muslimani, i cili ka jetuar si jomusliman në kohën e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue selem, pastaj është bërë musliman, por nuk ka arritur, as

ta shohë dhe as ta shoqërojë Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ue selem. Shih: Kamusu mustalahatil hadithi nebevij, Muhammed Siddik El Minshavi, Darul Fedileh, Kajro, 1996, fq. 72 dhe fq.106-107.

⁴ Et Tabekatu’l Kubra, <http://www.al-eman.com/islamlib/viewchp.asp?BID=185&CID=77>.

⁵ Sijeru a’lami’n nubela, Imam Dhehebiu.

⁶ Tefsiru’t Taberijj, pj. 2, fq. 284.

63 h¹⁰. Imam Dhehebiu përmend vitin 61 h. si vit të vdekjes së tij¹¹.

Dijetarët për Rebian

Rebia gëzonte respekt të madh tek sahabet. Imam Dhehebiu përmend në biografinë e tij, se kur Rebja ishte për vizitë tek Ibën Mesudi, atëherë konaku mbyllej për të tjerët. Nga simpatia që kishte për të dhe i mahnitur me sinqeritetin e tij deklaronte: *“O babai i Jezidit! Po të shihje i Dërguari i Allahut do të donte dhe sa herë që të shoh, më përkujton të përlulur”*¹².

Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Dëshmoj se ky është njeriu më me frikë ndaj Allahut në kohën tuaj¹³.” Këtë respekt siç duket e kishte fituar në sajë të shoqërimit dhe mësim-nxënies nga Ibën Mesudi dhe jo vetëm ai, por edhe nxënësit e tjerë. Shabi ka thënë: Nuk kam parë njerëz më të ditur, më të butë dhe më asket se sa nxënësit e Ibën Mesudit. Po të mos ishin sahabet si kohë përpara, nuk do t’u jepnim përparësi ndaj tyre. Por Rebja dallonte prej të gjithë nxënësve për zellin e tij të madh¹⁴ dhe devotshmërinë që kishte¹⁵.

Alkame ibën Merthedi ka thënë: Devotshmëria (zuhdi) përkufizohet tek tetë tabiinë, prej tyre është edhe Rebja ibën Huthejmi¹⁶.

Ibën Hibani mendonte se për një personalitet si Rebja nuk ka nevojë të flitet fare¹⁷. Tek dijetarët cilësohej si: tabiin, besnik, i dalluar (për moral e dije), i devotshëm, i edukuar, merrej si argument. Madje Imam Taberiu thoshte, se për një njeri si Rebja nuk pyetet fare, gjë që e kishte shtyrë ta llogariste atë ndër tabiinët më të mëdhenj¹⁸. Aq shumë i kishte mbuluar zemrat e tyre respekti, sa që edhe në gjërat më të thjeshta

i jepnin përparësi atij. Ebu Vaili kur qe pyetur: “A je më i madh ti apo Rebja?”, kishte thënë: “Unë jam më i madh se ai me vjet, ndërsa ai është më i madh se unë me mend (dituri)”¹⁹.

Edhe Muhamed Nasirudin Albani, hadithologu më i shquar i shekullit të kaluar pati thënë fjalë miradije për të. Më konkretisht, në shtjellimin e haditheve dhe rangjeve adekuate, përkritazi me Rebjan pati thënë: Ai është besnik, muhadrem²⁰. Ai ishte i njohur edhe tek masa e gjerë (xhumhuri). Shekiku rrëfen se ai së bashku me ca nxënës të Abdullah ibën Mesudit kishin shkuar ta vizitonin Rebjan. Gjatë rrugës kishin kaluar pranë një burri, i cili i kishte pyetur:

–Për ku jeni nisur kështu?

–Po shkojmë ta vizitojmë Rebjan- u përgjigjem.

–Jo, po shkoni tek një burrë, që nëse flet nuk gënjen, nëse premtion nuk e thyen premtimin, nëse i lini diçka në besë nuk tradhton- tha njeriu²¹.

Dituria e tij

Po të mos ishte i ditur, sigurisht se nuk do ta kishte fituar një respekt të tillë për çfarë thamë më lart. Siç duket, ai në jetën e tij ishte fokusuar më shumë në veprim, se sa në transmetim. Ndaj ai siç e përmend Imam Dhehebiu, kishte transmetuar jo shumë hadithe²². Ai transmetoi nga:

Abdullah ibën Mesudi,

Ebu Ejub Ensariu, dhe

Amr ibën Mejmun,

Hudhejfe ibën Jemani²³, dhe

Nga gra, siç ishte rasti me një grua nga Ensarët (medinase)²⁴.

Kurse prej tij transmetuan:

⁷ Kështu e kanë përmendur edhe Imam Buhariu në Sahihul Buhari, kapitulli: Ma xhae fi kavililahi teala: Ve huvel ledhi jebdeul halka..., pj. 10, fq. 462, Sahihu Muslim, kapitulli: Fadlut tehlil vet tesbih ved dua, pj. 13, fq. 203, Dr. AbduRrahman Refet el Basha në “Suver min hajatit tabiin”, b.15, Darul Edebil Islamiyy, Kajro, 1997, fq. 52.

⁸ Tefsiru Taberijj, pj.2, fq. 284.

⁹ <http://www.almenhaj.net/TextSubject.php?linkid=7487>

¹⁰ Ibid.

¹¹ Sijeru alami nubela, Imam Dhehebiu.

¹² Sijeru alami nubela, Imam Dhehebiu.

¹³ Tefsiri i Kurtubiut, pj. 4, fq. 283.

¹⁴ Tabekatul Huffadh, kapitulli: Et tabek-atu thanijeh min kibarit tabiin, pj.1, fq. 1.

¹⁵ <http://www.almenhaj.net/TextSubject.php?linkid=7487>

¹⁶ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

¹⁷ <http://www.almenhaj.net/TextSubject.php?linkid=7487>

¹⁸ Tefsirul Taberij, pj.2, fq. 284

¹⁹ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

²⁰ Es Silsiletu sahihah, kapitulli: 953, pj.3, fq. 27

²¹ Et Tabekatul Kubra, cituar sipas:

<http://www.al-eman.com/IslamLib/viewchp.asp?BID=185&CID=77>

²² Sijeru alami nubela, Imam Dhehebiu.

²³ El Muxhem el Evsat, Taberaniu, pj.8, fq. 493

²⁴ El Muxhem el Kebir, Taberaniu, pj.4, fq. 228

Shabiu,
Ibrahim Nahiu,
Hilal ibën Jesafi,
Mundhir Theuriu,
Hubejre ibën Huzejme, e transmetues të tjerë.

Kurse në koleksionet e hadithit, prej tij kanë regjistruar Buhariu²⁵, Muslimi²⁶, Tirmidhiu²⁷, Nesaiu²⁸, Ibën Maxhe²⁹, Imam Ahmedi³⁰, Taberaniu³¹ e të tjerë.

Rebia ishte shumë i përpiktë në dituri. Këtë e ka dëshmuar edhe me rastin, kur pati transmetuar hadithin:

“Kush thotë: “La ilahe il-lallah uahdehu la sherike lehu, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul-li shejin kadir” 10 herë është sikur të ketë liru nga robëria katër persona nga bijtë Ismailit”.

...për çka u pyet: Prej kujt e ke dëgjuar këtë?
E kam dëgjuar nga Amër ibën Mejmoni.

Atëherë shkova tek Amri – rrëfen Shabiu (pyetësi) dhe i thashë: Prej kujt e ke dëgjuar?

E kam dëgjuar nga Ebu Lejla- më tha.

Shkova tek Ebu Lejla dhe i thashë: Prej kujt e ke dëgjuar ti?

E kam dëgjuar nga Ebu Ejubi, i cili thotë ta ketë dëgjuar Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem* duke e thënë një gjë të tillë³².

Sinqeritetin e tij në dituri e dëshmon edhe fakti tjetër, që kur i vinte ndokush ta pyeste për diçka, atëherë ai paraprakisht e këshillonte: O rob i Allahut! Respektoje Allahun për atë që di, kurse atë që nuk e di mbështetja Dijetarit të saj!³³

Metodologjia e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem* përkritazi me mentalitetin e njerëzve refle-

ktohej edhe në programin e tij, ndaj kur dikush i vinte ta pyeste për diçka, ai kërkonte gjënë që ia vliente t'i thuhej, edhe nëse pyetësit i dukej pakëz e çuditshme. Kështu kur i shkoi dikush të kërkonte këshillë, ai i lexoi ajetin kuranor:

Thuaj: “Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloj Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapura apo të fshehta, mos e mbytni njeriun, sepse mbytjen e tij e ndaloj Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu të mendoni thellë”³⁴.

-Unë kam ardhur për këshillë!- i tha njeriu.

-Mbahu për kësaj që thashë, të mjafton- iu përgjigj Rebia³⁵.

Rebia urrente që dituria e tij të përcillej me vargje poetike. Ai dëshironte që gjuha e tij të thoshte: “Allahu i Madhëruar ka thënë, Muhamedi, alejhi selam ka thënë”, ndaj në një rast kur qe’ pyetur: “Përse nuk thua ndonjë varg poetik, kur shokët e tu e bëjnë një gjë të tillë?”, Rebia u përgjigj: “Nuk ka fjalë që thuhet e që nuk shënohet në librin e veprave tona. Unë urrej që në librin e veprave të mia të figurojnë edhe vargjet poetike”³⁶.

Dituria e tij ishte e përgjithshme. Nuk kishte fushë fetare ku nuk shquhej. Nëse flet për *Fikhun*, atëherë atë e gjen tek përfill parime që dëshmojnë për diturinë e tij³⁷. Nëse kërkon në Tefsir³⁸, atëherë do ta gjesht atë si një dijetar, që s’i hidhet fjala poshtë. Madje çka është me rëndësi, se për komentet e ajeteve kuranore

²⁵ Sahihul Buhari, kapitulli: Fil emeli ue tulihi, pj. 20, fq. 41

²⁶ Sahihu Muslim, kapitulli: Fadlut tehlil uet tesbih ued dua, pj. 13, fq. 203.

²⁷ Sunen Timidhi, kapitulli: ma xhae fi suretil ihlas, pj.10, fq. 134.

²⁸ Sunen En Nesaij, bab: El fadlu fi kiraeti Kul HuveAllahu had, pj. 4, fq. 98.

²⁹ Sunen Ibni Maxheh, bab: El emel uel exhel, pj.12, fq. 279.

³⁰ Musnedi i Imam Ahmedit, Musned Abdilah Ibni Mesudi, pj.8, fq. 5.

³¹ El Muxhem el evsat, Taberaniu, pj.8, f. 493, El Muxhem el kebir, Taberaniu, pj. 4, fq. 228

³² Sahihu Muslim, kap. Fadlut tehlil ue tesbih ue dua, pj. 13, f. 203,

Shuabul iman, Bejhekiu, pj. 2, fq. 160.

³³ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

³⁴ Enam, 151.

³⁵ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

³⁶ Ibid.

³⁷ Mugire thotë se kur bënte mot

me vapë të madhe, Rebia falej në shtëpi. (Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj. 1, fq. 310) Kjo është ngjashëm me rastin e Ibën Abasit, që kur binte shi i madh i urdhëronte njerëzit të falen në shtëpitë e tyre. Kur njerëzit e kishin urryer një gjë të tillë, atëherë ai iu tha: “Këtë e ka bërë ai që ka qenë edhe më i mirë se ju (Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue selem)”. Hadithin e përcjell Buhariu.

sillte, jo rrallë, edhe këshillat e duhura. P.sh. në komentin e ajetit:

Ditën kur do të gjurmohen të fshehtat³⁹.

...ka thënë: “Të fshehtat janë ato që i fshihni nga njerëzit, ndërsa Allahut të Madhëruar nuk i fshihet asgjë. Shërojeni (këtë problem) me ilaçin e vet.- E çfarë ilaçi ka për të?- e pyetën. Tha: Të pendoheni dhe mos t'i ktheheni më atyre mëkateve.”⁴⁰

Ndonjëherë bazuar në ajete kuranore jepte edhe këshilla që me të vërtetë ishin të efektshme. Kështu bazuar në ajetin kuranor:

E ti shkunde trupin e hurmës se do të bien ty hurma të freskëta⁴¹.

...kishte propozuar hurmën për gratë lehona.⁴²

Devotshmëria e tij dhe reflektimet e saj

Devotshmëria ishte elementi më i theksuar në personalitetin e tij, ndaj ajo me botëkuptimet më reale të mundshme që rrënjëzuar thellë në shpirtin e tij, kështu që ngado që e vështroje shihje vetëm atë. Kjo gjë e kishte shtyrë Abdullah ibën Mesudin ta cilësonte atë si një njeri që reflektonte besim, dashuri, sinqeritet, një njëri që ua shtonte të tjerëve besimin vetëm me pamjen fizike e lëre më me veprat e tij. Ibën Mesudi i pati thënë: O babai i Jezidit! Po të shihte i Dërguari i Allahut sigurisht se do të donte. Mua, sa herë që të shoh, më përkujton robërit e dëgjueshëm⁴³.

Asnjëherë nuk që mashtrohet të mendonte, se kjo që kam bërë unë është punë e madhe, përkundrazi e akuzonte vetveten për lëshime dhe mangësi. Nesir ibën Dhaluku rrëfen se Rebia qante aq shumë, sa që edhe mjekra i lagej. Thoshte: Kemi takuar njerëz (sahabe) që pranë tyre ne nuk jemi gjë tjetër vetëm se vjedhës. Në

një rast tjetër kur që pyetur: Mirëmëngjesi! Si u zgjove sot?- ai u përgjigj: U zgjuam mëkatarë; hamë riskun (furnizimin) tonë dhe presim exhelet tona.⁴⁴

Rebia, ngaqë e ulte shumë vështtrimin, tek ata që nuk e njihnin dukej si i verbër.⁴⁵ Kur shkante tek Abdullah ibën Mesudi trokiste në derë, por nuk ngrinte kokën lart për të parë, se kush po ia hap derën. Një shërbëto e re mendonte se ai ishte i verbër, kështu që sa herë që shkante Rebia dhe Abdullahu pyeste për mysafirin, ajo i përgjigjej: Ai plaku i verbër.⁴⁶

Por kjo nuk i kishte penguar disa zemërkëqij që ta provokonin atë. Ata kishin harruar se një njeri që për xhenetin ka shitur çdo gjë të kësaj dynjaje, nuk i ka mbetur më mall për të. Ai ishte përqendruar vetëm te Xheneti. U morën vesh me një grua të pandershme, e cila me bukurinë e saj mahniste shumë njerëz. Vetëm mashtroje atë dhe do të kesh 1000 dërrhem- i premtuan asaj. Ajo veshi rrobat më të mira që kishte, u parfumua me parfumin më të mirë dhe në kohën kur Rebia doli nga xhamia ajo iu paraqit përpara duke e hequr shaminë e kokës. Rebia iu drejtua me këto fjalë:

-Si do të jetë puna jote, nëse këtij trupi i shkaktohen ethe dhe ia humbin bukurinë?

-Si do të jetë puna jote, nëse tashti zbret meleku i vdekjes dhe ta merr shpirtin?

-Si do të përgjigjesh, nëse tashti të marrin në pyetje Munkeri dhe Nekiri?

Gruaja lëshoi një klithmë trishtimi dhe ra përtokë e alivanosur. Kur u kthjell u pendua dhe u bë prej grave të devotshme, sa që kur vdiq mbeti vetëm si një cung i sosur (nga adhurimi i shumtë dhe brengat për mëkatet e bëra). ■

(vijon)

³⁸ Komente prej tij kanë përmendur: Sahihul Buhari, kapitulli: Ma xhae fi kaulilahi teal: Ue huvel ledhi jebdeul halka..., pj. 10, fq. 462; Tefsirut Taberij, kaptina Et Tekvir, ajetet 1-4; Tefsiri i Kurtubiut, pj. 11, fq. 96. Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj. 8,

fq. 210; Tefsir Ibni Ebi Hatim, pj.

46, fq. 286 etj.

³⁹ Tarik, 9.

⁴⁰ Ed Durrul Menthur, Sujuti, pj. 10, fq. 236.

⁴¹ Merjem, 25.

⁴² Musannef Ibni Ebi Shejbe, pj. 5, fq. 461.

⁴³ El Muxhem el eusat, Taberaniu, pj. 8, fq. 492.

⁴⁴ <http://al7ewar.net/forum/showthread.php?p=78397>

⁴⁵ Ihjau ulumiddin, pj. 1, fq. 181.

⁴⁶ <http://www.sahab.net/forums/showthread.php?t=290248>

⁴⁷ Et Tevvabine, pj. 1, fq. 72.